

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 26.01.2007

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 26.01.2007.GODINE

JANAR – JANUAR 2007

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 11 janarit 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Miratimi i tekstit përfundimtar të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastrën,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arbitrazhin,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e varieteteve të bimëve,
8. Debat për gjendjen e sigurisë në Kosovë,
9. Shqyrtimi i kërkesës së GP të AAK-së për miratimin e Rezolutës për organizimin e diasporës kosovare,
10. Shqyrtimi i kërkesës së grupit të deputetëve për të debatuar për tre qytetarë të Kosovës, të akuzuar në Gjyqin e Hagës,
11. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar ORA për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevnog reda,
2. Usvajanje zapisnika Plenarne sednice, od 11. Januara 2007 god.,
3. Vreme za parlamentarna pitanja
4. Usvajanje konačnog teksta Zakona o bezbednosti u drumskom saobraćaju
5. Drugo razmatranje Nacrta Zakona o izmeni i dopuni Zakona o katastru,
6. Drugo razmatranje Nacrta Zakona o arbitraži,
7. Drugo razmatranje Zakona o zaštiti vrsta biljaka,
8. Rasprava o bezbednosnoj situaciji na Kosovu
9. Razmatranje zahteva P/G. ABK za usvajanje Rezolucije o organizovanju Kosovske diaspore
10. Razmatranje zahteva Grupe poslanika za raspravu o tri građana Kosova, Haških optuženika
11. Razmatranje predloga parlamentarene grupe ORA za zamenu članova komisije.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Lus deputetët t’i zënë vendet e tyre dhe t’ia fillojmë punës. Parapikishtë ata që i kanë vënë kartelat përpara, le t’i **prekin** edhe një herë dhe t’i vendosin prapë.

Të nderuar kolegë deputetë, i nderuar kryeministër dhe ministra të kabinetit qeveritar. Mirë se keni ardhur në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftojmë se në sallë janë 75 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë të mëtutjeshme. Andaj propozoj që të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Urdhëroni z. Agani

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës, të nderuar deputetë, grupi i deputetëve kërkon që në bazë të rregullës 29 pika 2 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës si pikë e veçantë e rendit të ditës të seancës plenare të 26 janarit 2007 dhe të seancës së sotme të vihet votimi për shpërndarjen e dokumentit të presidentit Ahtisari për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës menjëherë pas dorëzimit të tij të Ekipit të Unitetit.

Si arsyetim:

Duke pasur parasysh përvojën e mëhershme të mos informimit me kohë të Kuvendit të Kosovës nga ana e Ekipit të Unitetit, në mënyrë të përsëritur ka rezultuar me detyrim të deputetëve që ekskluzivisht të informohen nga mediat, në veçanti duke pasur parasysh, më vjen keq që duhet ta përdor këtë fjalë, por në një mënyrë edhe injorimim që Ekipi i Unitetit ia bëri Kuvendit të Kosovës në seancën e 21 dhjetorit 2006, kur përkundër pikës së rregullt të rendit të ditës ata nuk u paraqitën para deputetëve, prandaj kërkojmë që Kuvendi i Kosovës në kuadër të pikës së veçantë të rendit të ditës të vendosë, që dokumenti i presidentit Ahtisari për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës, si njëri prej dokumenteve më të rëndësishme në historinë e re të Kosovës, t’u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit , menjëherë pas dorëzimit të tij Ekipit të Unitetit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit!, fjalën e ka deputeti Alush Gashi

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Plani lidhur me pikën e 4 të rendit të ditës. Në seancën e kaluar ne kemi votuar nen për neni dhe në grupe për amendamente për Ligjin për komunikacion rrugor dhe ka qenë vendim unanim i Kuvendit të Kosovës që pas pastrimit të tekstit, ky tekst të hidhet në votim final. Ne para dy ditësh e kemi marrë këtë tekst, ky tekst duket që është në punim e sipër. Pra, në këto materiale ende nuk janë të inkuadruar amendamentet, teksti nuk është i spastruar, teksti nuk është i lekturuar dhe ju lus që administrata ta zbatojë vendimin e seancës plenare dhe në seancën e ardhshme ta sjellë këtë ligj për votim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit!, Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari. Teuta Sahatqija me kartelën e Nazimit.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA - I nderuari kryetar i Kuvendit. Dua të propozoj një pikë të rendit të ditës për seancën e ardhme. Duke pasur parasysh se me vonesë ka ardhur, faktikisht është përfunduar raporti i auditit për pasqyrat e shpenzimeve buxhetore të vitit 2005, që e ka ardhur me vonesë prej 6 muajsh ne e dimë që pasqyrat e shpenzimeve buxhetore çdo vit duhet të dorëzohen me 31 mars, ndërsa ato të audituara më 30 qershor. Propozojmë që raporti i auditimit të buxhetit të vitit 2005 të vihet në rend dite në seancën e ardhme. Shpresojmë që për vitet e tjera nuk do të presim nga 6 muaj, por për vitin 2006 do t'i kemi me kohë këto raporte . Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Fehmi Mujota.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA – Ju faleminderit z. kryetar, z. kryeministër, të nderuar ministra ,të nderuar deputetë. Unë do të bëjë një propozim në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, që ka të bëjë me rritjen e efektivitetit të punës të Kuvendit dhe të kontrollit më të mirë të punës së Qeverisë. Tashmë një kohë të gjatë po ballafaqohemi me një praktikë jo të mirë në Parlamentin e Kosovës, kur ngriten çështje ad - hoc dhe ne e kuptojmë edhe nevojën për ngritur edhe çështje të ngutshme, por propozimi më i mirë dhe rritja e efikasitetit të Kuvendit do të ishte që Grupi Parlamentar, përkatësisht edhe grupet parlamentare në këtë rast të propozojnë tema bosht për gjithë vitin dhe paraprakisht Qeveria të jetë e njoftuar për temat që diskutohen për secilin muaj në mënyrë që ministrat dhe kabineti qeveritar të ketë mundësinë për përgatitje të raporteve, por edhe të përgjigjet në interpelanca dhe në pyetjet parlamentare që bëjnë deputetët në Parlament të Kosovës. Prandaj, mendoj që është e nevojshme të hidhet një propozim për t'iu shmangur praktikave të deritashme që të humbet efektiviteti ose ma mirë me thanë të humbet interesimi për temat që ngriten për debat me ato vonohen shpeshherë t'i kemi këto çështje të rregulluara njëherë e mirë me plan dhe program. Pra, për çështjet e ngutshme mund të vendosë Kuvendi sipas rregullave në fuqi, prandaj është e udhës ta marrim këtë vendim që ta arrijmë këtë efektivitet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Kërkesa e doktor Aganit mund të realizohet ashtu si është kërkuar menjëherë pas dorëzimit të materialit që i dorëzohet Ekipit të Unitetit, domethënë sa të ketë mundësi ta fusim si çështje urgjente. Z. Agani nuk e dimë datën se kur do të vijë ai... do të shpërndahet materiali posa ta marrim nga Ahtisari. Propozimi i Alush Gashit që ligji të tërhiqet momentalisht për shkak se ka paqartësi ende në rregullimin e amendamenteve, e vë në votim propozimin e deputetit Alush Gashi.

Kush është kundër: nuk ka
Abstenim: nuk ka.

Ju faleminderit. Konstatohet se me shumicë votash tërhiqet Ligji, të jetë i spastruar të vijë në seancën tjetër, ku duhet të votojmë në tërësi ligjin. Urdhëroni z. Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar. Unë asgjë tjetër nuk po kërkoj, vetëm të respektohet Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës. Rregulla 29 pika 2. Ju lutem që ta qitni në votim propozimin e grupit të deputetëve dhe që Kuvendi në mënyrë unanime të votojë që një gjë e tillë të ndodhë. Dëshirojmë të jemi të sigurt se me këtë do ta sigurojmë transparencën e plotë të procesit . Mendoj që lidhur me këtë nuk duhet të kemi kurrfarë mospajtimi. Pse të mos votojë Kuvendi për një propozim të tillë? Prandaj ju lutem ta respektoni Rregulloren e punës dhe Kuvendi le të deklarohet lidhur me këtë propozim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit!, urdhëro, deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Zotëri kryetar i Kuvendit, zotëri kryeministër, deputetë të respektuar. Nuk është mirë të interpretojmë Rregulloren si një gjë që lëviz prej momentit në moment. Deputeti Agani ka dhënë një propozim. Problemi është a propozon ai që të hyjë në rendin e ditës kjo materie, se ne jemi duke diskutuar për rendin e ditës, tjetër është a do të hyjë në rendin e ditës sot ky problem, e tjetër është si do të bisedohet për këtë problem. Unë kërkoj sqarim dhe ne si deputetë kërkojmë sqarim në këtë pikë ku jemi duke diskutuar. Pasi të vendoset të hyjë apo jo në rend dite ne do të japim mendimet tona. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni z. Agani.

DEPUTETI FERID AGANI- Ju faleminderit z. kryetar, falënderoj edhe deputetin Hamiti që ma dha këtë mundësi që ta qartësoj edhe pak. Bëhet fjalë për kërkesë që të hyjë në rend të ditës si pikë urgjente deklarimi i Kuvendit të Kosovës që në momentin kur dokumenti i presidentit Ahtisari t'i dorëzohet Ekipit të Unitetit ai të jetë në dispozicion edhe të deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Pra, është kërkesë që të hyjë në rend të ditës dhe të votohet për të.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Mendoj se trajtimi i çështjeve urgjente në seanca plenare është i rregulluar me Rregulloren e punës. Projektioni i çështjeve të cilat duhet të diskutohen këtu po ashtu është i rregulluar me Rregullore të punës, por nëse zotërinjtë dëshirojnë që ne sot të bisedojmë për atë çështje, ne mund të bisedojmë ,por unë nuk e di për çka mund të votojmë në një mënyrë të jashtëzakonshme për një çështje për të cilën pritet të jetë e zakonshme.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Thashë se ende nuk është marrë materiali, posa të merret dhe të shkojë në procedurë të përkthimit që t'ju shpërndahet deputetëve, por nuk është çështje urgjente që duhet sot me e shqyrtuar këtë, prandaj vazhdojmë më tutje. Koha e paraparë për rendin e ditës është 2 minuta për të gjithë. Ne kemi kaluar shumë më tepër, urdhëroni z. Mujota.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA- z. kryetar, mendoj se propozimi që e dhamë pak më parë rregullon këtë çështje mirë, të kemi mundësi të marrim një vendim që shefat e grupeve parlamentare të ofrojnë rendet dhe temat që mendojnë se janë aktuale dhe ato që duhet trajtuar gjatë gjithë kohës. Prandaj këtë punë mund ta rregullojmë shumë lehtë në qoftë se shefat e grupeve parlamentare përcaktojnë agjendën e takimeve dhe ju paraqesin juve si kryetarë dhe Kryesi e Kuvendit. Mendoj se mund ta rregullojmë këtë çështje. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Dhe e kanë pas këtë shans, Gani Koci urdhëroni.

DEPUTETI GANI KOCI – Z. kryetar, po më duket se po ngatërrohem nga pak në Rregullore të punës të gjithë dhe unë dua të them vetëm një gjë. Z. Agani kërkoj që kjo seancë e Kuvendit të marrë një vendim tash që në moment të dorëzimit të dokumentit të Ahtisarit t’ju dorëzohet edhe deputetëve të Kuvendit, prandaj nuk është jashtë punës së Kuvendit dhe jashtë Rregullores që ky Kuvend të marrë këtë vendim. Unë dua të arsyetoj me faktin, kur kemi biseduar ndonjëherë për punën e Grupit të Unitetit ka pas deputetë këtu që kanë thënë s’ kemi pasur materialin kurrë dhe ka pasur të atillë që ka thënë se unë i kam pasë këto materiale, prandaj është një pozitë jo e barabartë në mes të deputetëve këtu në qasje të dokumenteve të tilla. Prandaj, nuk është thyerje e rregullës në qoftë se ky Kuvend merr vendim që në moment të dorëzimit t’u dorëzohet edhe deputetëve.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Çdo material, çdo kërkesë për pikat e rendit të ditës, do të shqyrtohet në procedurë të rregullt, prandaj edhe kjo. Duhet materiali të përkthehet dhe ende s’e kemi marrë atë dhe në seancën tjetër do të vendosim për të ,pse jo. Gjergj Dedaj e ka fjalën.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar të gjithë këtu. Jo rastësisht se sondazhi i fundit, domethënë tregoi qartë autoritetin e Kuvendit të Kosovës dhe të Qeverisë së saj ,sepse tashmë është e rëndësishme për ju këtu, ma merr mendja është ta zëmë Ligji për bimët ,sesa kërkesa e deputetëve për një punë transparente të Ekipit të Unitetit që ne si deputetë dhe grupet parlamentare jemi njoftuar nga gazetatat. Ne sot kemi kërkuar dhe ngulim këmbë që kërkesa jonë, domethënë që pas dorëzimit të materialit të presidentit Ahtisari Grupit të Unitetit, menjëherë deputetët që janë të zgjedhurit e qytetarëve të Kosovës, ta kenë dokumentin dhe të mos japim deklaratë paushalle dhe të mos jemi të painformuar për çështjet jetike për qytetarët e Kosovës. Unë ju lus, z. kryetar dhe lus edhe Qeverinë e Kosovës të bëhemi pak më seriozë, sepse ju e keni marrë votën e qytetarëve të Kosovës që ta jetësoni dhe jo të bëni fizkultura me vullnetin politik të qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Propozimi i deputetes Teuta Sahatqija për dorëzimin e raportit të auditit duhet të shkojë në procedurë të rregullt, le të jetë temë e shqyrtimit në këtë Parlament. Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryetar, zotërinj deputetë, kisha pasur dëshirë të ndërlihem me çështjen e projektit të Ahtisarit. Unë kam mendimin që projekti i Ahtisarit

tashmë është i ditur nga të gjithë. Ata që kanë mbjellë misër nuk mund të presin të korrin grurë dhe e dinë shumë mirë këtë fakt, prandaj nuk është shumë me rëndësi se kur do ta kemi, se do ta marrim edhe nëpërmjet gazetave, por e rëndësishme është që ky Kuvend të deklarohet rreth këtij projekti me një deklaratë që t'i paraprijë këtij projekti që do të vijë dhe do ta kemi dhe e dimë të gjithë çfarë do ta kemi, vetëm pak keq mund të jetë ma mirë nuk mund të jetë sesa që ka bërë Grupi Negociator, konsesionet që ka bërë ky grup ndaj Serbisë janë të njohura botërisht, kështu që mos u lodhni shumë për këtë punë bile janë shumë fatale për Kosovën. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Miratimi procesverbalit të seancës plenare të 11 janarit 2007

Procesverbali i seancës plenare të 11 janarit 2007 u është shpërndarë deputetëve me kohë. A ka vërejtje në procesverbal dhe nëse ka duhet t'i drejtoheni sekretarisë. Nëse nuk ka konstatoj se nuk ka vërejtje në procesverbalin e mbledhjeve. Urdhëroni z. Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Kërkoj z. kryetar që vërtet këto procesverbale të shkruhen shqip, janë plotë gabime edhe teknike edhe gjuhësore të mos flasim më shumë, të shkruhen shqip,

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Pajtohem plotësisht me ju, edhe procesverbali edhe transkripti të shkruhen shqip.

Koha për pyetje, deputeti Xhevat Bislimi nga PDK-ja ka pyetje për kryeministrin Agim Çekun. Z. Bislimi dëshironi ta keni fjalën.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Ju faleminderit z. kryetar. Z. kryeministër, **referimi** i jua Qeverisë që ju e kryesoni dhe i UNMIK-ut për kthimin e serbëve të larguar nga Kosova, tashmë është i njohur dhe i përditshëm. Për këtë çështje Qeveria që ju e kryesoni ka bërë shumë projekte dhe ka dhënë shumë para nga buxheti i Kosovës.. Mbarë bota e di, dua të besoj që edhe ju edhe Qeveria e juaj duhet ta dini, se në Mitrovicën Veriore dhe në gjithë Kosovën Veriore është kryer spastrim i mirëfilltë etnik. Shqiptarët që jetonin në këtë pjesë të qytetit dhe të Kosovës janë dëbuar prej andej me dhunë nga formacionet e organizuara dhe të kontrolluara drejtëpërdrejt nga Beogradi. Ky dëbim dhe spastrim etnik kanë ndodhur në prani dhe para syve të forcave ndërkombëtare të sigurisë dhe nën “mbikëqyrjen e administratës ndërkombëtare”. Shtëpitë dhe pronat e këtyre shqiptarëve u dogjën dhe u shkatërruan dhe u uzurpuan nga formacionet e organizuara serbe, pyetja:

Pse ju dhe Qeveria që ju kryesoni z. kryeministër nuk ka ndërmarrë asnjë hap politik, diplomatik, administrativ dhe financiar për zgjidhjen e kësaj çështjeje të ndjeshme politike dhe kombëtare për Kosovën dhe për kthimin e këtyre njerëzve në shtëpitë dhe pronat e tyre? Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni z. Kryeministër.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – I nderuar z. kryetar, të nderuar deputetë, i nderuar Xhevat, faleminderit për pyetje.

Veriu i Kosovës gjithmonë ka qenë sfida më e madhe e çdo qeverie, kështu edhe i qeverisë së sotme që unë e drejtoj dhe mendoj se nuk qëndron konstatimi i juaj se nuk kemi marrë asnjë masë apo nuk kemi bërë asgjë për kthimin e qëndrueshëm të shqiptarëve apo për qëndrimin e tyre atje. Por, dua të them që nuk janë të mjaftueshme ato çka i kemi ndërmarrë deri më tash. Po flas vetëm për vitin 2006 çfarë kemi bërë.

Nga buxheti i Kosovës kemi financuar ndërtimin e 25 shtëpive në tri fshatra në komunën e Leposaviqit, fshatrat: Koshtovë, Cerajë dhe Bistricë, 25 shtëpi të reja janë ndërtuar, kurse 22 janë riparuar.

E kemi ndërtuar rrugën katër kilometra e gjysmë deri atje, kemi ndërtuar gjithashtu një qendër për grumbullimin e qumështit, kemi ndërtuar tri stacione të autobusit, i kemi furnizuar me minibusë qytetarët shqiptarë që të qarkullojnë deri nëpër Kosovë për nevojat e tyre. Kemi ndërtuar tri qendra të komuniteteve në tri komunat, në komunën e Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut, kemi ndërtuar ndërtesa, por edhe si kapacitete, kështu që qytetarët shqiptarë atje i kryejnë shërbimet e tyre me pamundësi apo me pengesa që i kanë t'i kryejnë në kuvendet komunale përkatëse.

Kemi ndërtuar nën-stacione policore gjithashtu dhe janë në funksion sidomos në fshatin Çabër, kemi forcuar rrjetin elektrik dhe kemi duke e forcuar tani, kemi ndërtuar një trafo të re në lagjen e boshnjakëve, personalisht si kryeministër kam qenë në këtë pjesë, i kam vizituar qytetarët atje dhe i kam inkurajuar që të qëndrojnë dhe ua kam shprehur gatishmërinë tonë për mbështetje të vazhdueshme. Në këtë vit ka edhe shumë projekte të cilat ne i kemi planifikuar që do t'i ndërmarrim për kthimin e qytetarëve shqiptarë atje por edhe qëndrimin e tyre aty ku janë sot. Kemi edhe shumë projekte të tjera që i kemi bërë, kemi bërë edhe kanalizimin në fshatin Suhodoll, ndriçimin e rrugëve në kodrën e minatorëve, e shumë e shumë të tjera, kështu që shumë projekte janë duke u ndërmarrë, nuk është që nuk po tregojmë kujdes, por mundësia, situata është e tillë besoj që shumë shpejt do të krijohen rrethana të reja ku do të jenë të mundshëm kthimi, qëndrimi dhe integrimi i kësaj pjese në sistemin kushtetues të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Z. kryeministër. Xhevat Bislimi e ka fjalën.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryeministër kemi të informuar për ato që the, por është mirë me na thënë sa shtëpi, sa banesa të uzurpuara në Mitrovicën Veriore në pjesën veriore të qytetit janë liruar nga Habitatit që në pjesën tjetër i ka liruar të gjitha banesat, shtëpitë, pronat e uzurpuara sa janë liruar në atë pjesë dhe sa shtëpi të djegur, të shkatërruara në atë pjesë të qytetit janë rindërtuar, nëse është ndërtuar ndonjëra.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Tash për tash nuk ka informata të tjera, po qe se ka informata ma vonë do të informoheni. Deputeti Xhevat Bislimi ka një pyetje për ministrin Agim Veliu. Me qenë se ministri i Arsimit Agim Veliu nuk është këtu, gjendet në udhëtim zyrtar, mbetet pyetja për seancën e ardhshme. Xhevat Bislimi pyetje për ministrin Ibrahim Selmanaj. Urdhëroni

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. ministër, në Kosovë është një numër i konsiderueshëm i qytetarëve tanë që kanë pensione nga shtetet e ndryshme të Perëndimit, por edhe nga vendet fqinjë, Serbia, Maqedonia etj. Puna është se këta qytetarë megjithëse kanë pensione nga ato vende marrin nga buxheti Kosovës ndihmë social prej 40 eurosh që shpërndarë Ministria juaj për qytetarët tanë që kanë mbushur 65 vjet. Ju zoti ministër e keni të qartë gjendjen e rëndë sociale shpeshherë të pashpresë të invalidëve të luftës anti -pushtuese çlirimtare të UÇK-së të shumë familjeve të dëshmorëve dhe të veteranëve të luftës të UÇK-së. Ju, zoti ministër, gjithashtu, jeni në dijeni se shumë qytetarë tanë invalidë të punës dhe invalidë të tjerë dhe familjet e shumta mezi sigurojnë një kafshatë bukë, pyetja:

Pse Ministria juaj nuk ua ndërpret këtë ndihmë sociale prej 40 eurosh këtyre qytetarëve që marrin pensione nga vendet e huaja dhe e njëjta ndihmë t'u shpërndahet familjeve dhe personave të tjerë më me nevojë. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ – Ju faleminderit z. kryetar, z. kryeministër kolegë,ministra të nderuar kolegë deputetë. Jeni në dijeni se në Kosovë është në fuqi Ligji bazik mbi metodologjinë e pensioneve, me ç'rast përfitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës që kanë mbushur moshën 65 vjeçare. Ditëve të fundit jemi përgatitur dhe kemi të gatshëm Projektligjin për sigurimin pensional invalidor që kemi thënë edhe një herë ma herët para deputetëve të Parlamentit . Ky ligj ka një kosto të lartë financiare, jemi në kalkulimin final me partnerë tanët që janë UNDIP-ja, Fondi Monetar dhe Banka Botërore.

Problemet në Kosovë nuk është vetëm ky problem i gjendjes sociale, por duke pasur parasysh edhe regjistrimin e qytetarëve të Kosovës që është një prej problemeve më të mëdha, nuk mund t'i identifikojmë qytetarët tanë dhe kanë depërtuar edhe raste të tjera, kur ka pasur edhe pensionistë që kanë vdekur dhe mungesa e kontaktit të drejtëpërdrejt në zyrat e regjistrimit civil dhe mosregjistrimi ose çregjistrimi i të vdekurve na ka kushtuar deri sa e kemi vërejtur këtë fenomen dhe janë marrë masat paraprake. Po flitet më shumë dhe po punohet më pak. Do ta bëjë me dije z. Bislimi që nga shkurti do të fillojë së implementuari Ligji për kujdesin e familjeve të dëshmorëve dhe të invalidëve të luftës dhe që nga muaji shkurt do të jemi të përgatitur pasi të marrim edhe mendimin e Fondit Monetar dhe Ndërkombëtar të Bankës Botërore ne do ta nxjerrim për diskutim edhe para Parlamentit edhe Projektligjin për sigurimin pensional invalidor.

Në raportet e tjera ndërkombëtare me shfrytëzimin e të drejtës së pensioneve kemi mbërritur që me shtetet fqinje të kemi marrëveshje dhe pensionet të sigurohen në linja të drejtëpërdrejta për pensionistët që kanë punuar qoftë në Maqedoni, në Zvicër ose në Kroaci. Po asgjë nuk është e lehtë me mandatin që e kemi dhe me Rezolutën 1244. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Z. Bislimi doni prapë fjalën, urdhëroni.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. ministër a keni të dhëna të përafërta sa është shuma e parave që përfiton kjo kategori që përmenda më lart për çdo muaj?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Përgjigjja do të jepet me shkrim, deputeti Genc Gorani ka pyetje për zëvendës -kryeministrin z. Lutfi Hazirin. Urdhëroni z. Gorani.

DEPUTETI GENC GORANI – Ju faleminderit z. kryetar, zotëri zëvendës- kryeministër dhe ministër i Pushtetit Lokal. Jemi dëshmitarë se qytetarëve tanë u kushtëzohet ofrimi i shërbimeve civile në nivel komunal dhe qendror, duke kërkuar dëshmi nga qytetarët se janë pagues të rregullt të detyrimeve tatimore dhe të obligimeve të tjera ndaj institucioneve publike. Në shembullin e Prizrenit qytetarëve u refuzohet lëshimi i dokumenteve kadastrale dhe vazhdimi i lejës së punës për zejtarët. Në shembullin e dytë dhe sigurisht se nuk është i fundit, në Vushtrri u refuzohen të gjitha shërbimet komunale qytetarëve deri sa ata të sjellin certifikatë se janë pagues të rregullt të detyrimeve tatimore dhe sidomos të tatimit komunal në pronë . Pyetja:

Në bazë të cilit ligj dhe akti nënligjor qeveritë dhe kuvendet komunale e kushtëzojnë ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, duke pasur parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor që komunat e kanë për ofrimin e shërbimeve ndaj të gjithë qytetarëve pa dallim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni z. Zëvendëskryeministër.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI LUTFI HAZIRI – Ju faleminderit z. kryetar i Kuvendit, z. kryeministër, deputetë të nderuar, i nderuar z. Gorani.

Ministria e administrimit të Pushtetit Lokal më 9 janar ka marrë pyetjen tuaj që tash në formë gojore e paraqitet lidhur me kushtëzimin e komunave në pagesën e tatimit në pronë për ofrimin e shërbimeve publike në nivelin lokal, duke u bazuar në përgjegjësitë që dalin nga Rregullorja 2005/15 mbi ndryshimet e Rregullores mbi degën e IPVQ-së shtojca 14. Ministria e administrimit të Pushtetit Lokal ka shqyrtuar shkresën tuaj lidhur me dy rastet e paraqitura dhe ju njoftojmë si më poshtë.

Nën 1. Komuna e Prizrenit qytetarëve ua refuzon lëshimin e dokumentit kadastral. Ky kushtëzim është bazuar në nenin 17.3 pika C të Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë si dhe me nenin 1, paragrafi 1 i shërbimit

kadastral citojmë nenin: „Të gjitha shërbimet kadastrale komunale janë parë si shërbime të pronës dhe nëse nuk duhet të ofrohen, nëse tatimi në pronë nuk është paguar,,. Neni 1 paragrafi 2. citojmë: „Për regjistrim të pronës nuk duhet të plotësohet, nëse nuk është paguar tatimi në pronë,, etj. Me Udhëzimin administrativ për tatimin në pronë nr. 3/2004 mbi urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë, të nxjerrë nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, në rastin e dytë komuna e Vushtrrisë qytetarëve po ua kushtëzon me pagesë tatimin në pronë lidhur me shërbimet komunale pronësore në pajtim me nenin 17.3 pika c e Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë, si dhe neni 1 paragrafi 1 i shërbimeve kadastrale ku thuhet citoj:

„Të gjitha shërbimet komunale kadastrale janë parë si shërbime të pronës dhe se nuk duhet të ofrohen nëse tatimi në pronë nuk është paguar.

Neni 1 paragrafi 2 citoj:” Kërkesa për regjistrim të pronës nuk duhet të plotësohet nëse nuk është paguar tatimi në pronë”, udhëzimi administrativ për tatimin në pronë nr. 3/2004 mbi urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë të nxjerra po ashtu nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Kjo përgjegjësi në komuna ushtrohet konform akteve qendrore të shënuara më lart nëse komunat nuk kanë nxjerrë rregullore të tjera lokale që mbulojnë këtë përgjegjësi.

Ministria e administrimit të Pushtetit Lokal mbikëqyr cilësinë e shërbimeve komunale, transparencën e organeve në ushtrim të përgjegjësive para qytetarëve dhe subjekteve të tjera në zbatimin e përgjegjësive të bartura në komuna. në kuadër të monitorimit të rregullt dhe të vazhdueshëm të komunave të Kosovës. Në vazhdimësi këshillon zyrtarët komunalë për të vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duke respektuar të drejtat e të gjithëve Po ashtu gjatë monitorimit të komunave ka vërejtur se në disa komuna të Kosovës me aktet e nivelit qendror dhe rekomandimet e tyre qytetarët janë kushtëzuar me pagesën e tatimit në pronë në ofrim të shërbimeve komunale, duke përfshirë edhe shërbimet civile në komunë. Pas identifikimit të këtyre rasteve në komuna. Ministria ka kërkuar nga hartuesit e këtyre akteve që qytetarët të mos kushtëzohen për pagesën e tatimit në pronë për ofrimin e shërbimeve civile, si dhe është kërkuar që zyrtarët nga ministria të jenë në mbikëqyrje të drejtpërdrejtë në hartimin e akteve nënligjore, apo të rregulloreve komunale. Takimet e mbajtura për këto çështje kanë rezultuar të suksesshme me rastin e nxjerrjes së udhëzimit administrativ nr. 3/2004 nga MEF-i ,ku zyrtarët kanë marrë pjesë aktive në hartimin e urdhëresës administrative ,si dhe kanë kërkuar të përcaktohen se në cilat shërbime publike të ofruar nga komuna mund të kushtëzohen qytetarët. Me këtë udhëzim administrativ janë përcaktuar se në cilat shërbime të tjera komunat kanë mundësi ligjore të vendosin pengesa ligjore për kushtëzimin e ofrimit të shërbimeve në rastin e detyrimit të pagesës së taksës së pronës. Jua përkujtoj se komunat e kanë vetëm këtë të hyrë të garantuar vetëm një taksë e kjo është taksa e pronës si mjete që gjenerojnë në interes të plotësimit të buxhetit komunal të hyrave komunale për zhvillim, të planeve në interes të komunave të tyre dhe krejt në fund ,duke falënderuar z. Gorani për interesimin tuaj si deputet në Parlament ju falënderoj, sepse interesimi i juaj ka zgjuar angazhimin më të madh të zyrave tona për të punuar në unifikimin, për t’u ndihmuar komunave në unifikimin e mundësive

kushtëzuese për shërbimet komunale që janë pjesë e aktiviteteve të përditshme. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Z. Gorani keni pyetje plotësuese? Nuk ka. Deputeti Xhevat Bislimi ka pyetje për ministrin Bujar Dugolli, meqenëse ministri është në udhëtim autorizon Kadri Kryeziun, nëse pajtoheni. Unë mendoj se nuk ka pengesa në atë, unë pajtohem plotësisht.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. ministër, mbrojtja dhe stimulimi i prodhuesve vendorë ka qenë premtim dhe i partive që sot qeverisin Kosovën. Në fakt Qeveria pra, edhe Ministria e Juaj, me privatizimin, me politikat doganore dhe me politikat tatimore po destimulon dhe po i shkatërron prodhimin dhe ekonominë vendore. Shembull ilustrues është edhe akciza në shumë prej 4.5 euro për litër të prodhuar nga prodhuesit vendor i pijeve jo alkoolike që përmbajnë më pak se 50% fruta, të njëjtën shumë e paguajnë edhe ata që këto pije i importojnë nga vendet e tjera. Pyetja:

Kur do t'i lironi prodhuesit vendor nga kjo akcizë e cila dëmton dhe destimulon prodhuesit vendor? Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni z. zëvendësministër.

ZËVENDËSMINISTRI KADRI KRYEZIU – I nderuar kryetar, i nderuar kryeministër, të nderuar deputetë, i nderuar z. Bislimi.

Në fillim duhet të cek se pyetja juaj hyn në sferën e politikave fiskale të cilat i miratojnë dhe vendosin Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe Këshilli Ekonomik Fiskal, anëtar i të cilit nuk është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, prandaj kjo pyetje më mirë është dashur t'i drejtohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave e cila do të përgjigjet me kompetencë në këtë sferë, megjithatë ne do të japim një përgjigje në këtë sferë pasi që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave janë ministri të cilat i kanë disa kompetenca të përbashkëta.

Tanimë duhet të njoftoj se taksa akcize në Kosovë ka filluar së aplikuari se ishte prej themelimit të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut dhe kjo taksë ka qenë e vendosur me Rregulloren 2000/1 dhe Rregulloren 2000/2.. Duhet theksuar se taksa akcize për këtë grup të mallrave që prodhohet në Kosovë ka filluar të aplikohet praktikisht tek në prill të vitit të kaluar dhe jo në lartësinë që ju keni cekur 4.5 euro por në normën specifike për njësi litër në lartësi prej 0.45 euro ose thënë ndryshe 4.5 cent për litër dhe kjo është përcaktuar me rregulloren 2006/8 e cila është si plotësim e Rregullores së UNMIK-ut 2005/32 mbi kodin e akcizës në Kosovë. Mirëpo, unë mund të sqaroj se aplikimi i njëanshëm i barrierave doganore vetëm për mallrat e importuara për momentin e tanishëm do të ishte një veprim tejet joracional kjo aq më tepër tani kur marrëveshjet e tregtisë së lirë në mes të shteteve të rajonit janë në zbatim e sipër e të cilat duhet parë jo vetëm nga një perspektivë e vetme. Deri më tash kemi nënshkruar 4 marrëveshje të

tregtisë së lirë sidomos me shtetet e Evropës Juglindore, respektivisht të Ballkanit Perëndimor.

Në bazë të informatave që kemi është vërejtur se prodhuesit vendorë participojnë në mbledhjen e TVSH-së për këto produkte me vetëm 18% dhe 72% është nga importi, kurse sipas deklaratave të prodhuesve të pijeve ata thonë se mbulojnë 70% të tregut në Kosovës. Sipas të dhënave zyrtare kjo nuk qëndron. Gjithsesi të vlerësohet sa duhet të thuhet apo jo. Gjithsesi ne jemi jashtëzakonisht të interesuar t'i përkrahim prodhuesit vendorë dhe t'i krijojmë atyre kushte sa më të volitshme për të ushtruar biznesin e tyre dhe në kuadër të kësaj gjatë vitit 2006 me propozim dhe udhëheqje të Ministrisë të Tregtisë dhe të Industrisë është krijuar një grup ndërqeveritar, i cili ka propozuar ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 2004/13 dhe të Rregullores 2006/4.

Në drejtim të përkrahjes së biznesit këtë vit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë gjithashtu janë duke përgatitur edhe një paketë të re të propozimeve për lehtësimin e taksave dhe tatimeve për bizneset e cilës do të vlerësonte zhvillimin ekonomik dhe tërheqjen e investimeve nga jashtë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Keni pyetje plotësuese, z. Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Ju faleminderit z. ministër. Është bërë një gabim aty te 04.5 po pyetja mendoj se është shumë e qartë edhe bie në kompetencat e **Ministrisë** .. meqë lidhet me prodhuesit dhe me prodhimin vendor, por unë kisha dashur me ditë dhe i di politikat e UNMIK-ut e vendosjen e akcizave, politikat doganore po ju si ministri çfarë keni bërë që të stimulohet prodhuesi vendor dhe kjo akcizë të hiqet për prodhimin vendor.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Xhevat Bislimi ka pyetje për ministrin Jonuz Salihaj. E keni fajlën z. Bislimi

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI- Nuk e kam pyetjen këtu.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Nuk e keni ju që ministri e ka është shumë e arsyeshme, sepse kanë qenë gati 10 pyetje tuajat.

MINISTRI JONUZ SALIHAJ – I nderuari z. kryetar, kryeministër, ministra të nderuar deputetë, pyetja e deputetit Xhevat Bislimit ka qenë kjo: Kemi informata se trajtimi i të burgosurve në burgun e Dubravës nuk është i kënaqshëm në përputhje me standardet dhe me konventat ndërkombëtare, korrupsioni dhe nepotizmi sipas disa burimeve janë mjaft të theksuara në këtë burg. Më shqetësuese është siguria e të burgosurve, trajtimi, rrahja dhe torturimi i tyre nga njësia speciale e njësisë së burgut, kam informata se ka raste kur i burgosuri ther me thikë një të burgosur tjetër:

Cilat janë masat që keni marrë për rritjen e sigurisë fizike të të burgosurve dhe për ndalimin e torturës ndaj tyre? Kjo është pyetja.

I nderuari Bislmi ju falënderoj për mundësitë që m’i dhatë në këtë pyetje, do të paraqes një përgjigje të shkurtër që nga bartja e kompetencave faktike nga Departamenti i Drejtësisë, i Ministrisë së Drejtësisë, ministria që i ka kushtuar një kujdes të posaçëm ruajtjes së disiplinës dhe rritjes së shkallës së sigurisë në burgje dhe në qendrat e paraburgimit në Kosovë. Ruajtja e rendit dhe e sigurisë në institucionet korrektuese është në funksion të drejtëpër- drejtë të procesit të risocializimit të suksesshëm të personave të dënuar. Për përmbushjen e këtyre objektivave kujdeset **Shërbimi Sprovues** i Kosovës, shërbim model i vetmi në regjion. Në shqiptimin dhe zbatimin e masave që kanë të bëjnë me ruajtjen e rendit dhe me sigurinë në institucionet korrektuese respektohen ligjet dhe konventat e njohura ndërkombëtare që i referohen kësaj fushe siç janë: ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale i Kosovës, Kodi i drejtësisë për të miturit i Kosovës, tërësia e rregullave minimale për trajtimin e të burgosurve në vitin 1955, rregullat evropiane të burgut Strazburg 1987, Konventa kundër torturës dhe dënimeve kundër trajtimeve të tjera mizore çnjerëzore ose degraduese e datës 10 dhjetor 1984, parimet themelore mbi trajtimin e të burgosurve datë 14 dhjetor 1990 rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjet të miturve dhe të privuarit nga liria e tjera.

Burgu i Dubravës, si e dini, është i vetmi burg i sigurisë së lartë me një numër të madh personash të dënuar. Ne u jemi mirënjohës të gjithë atyre që paraqesin dhe argumentojnë në rast të shkeljes të të drejtave të burgosurve. Për këtë qëllim ne kemi hapur dyert e burgut për mjetet e informacionit dhe për OJQ-të e ndryshme të cilat monitorojnë të drejtat e tyre. Dua të theksoj se gjatë vitit 2006 kemi pasur vetëm dy raste të ankesave të paraqitura nga të dënuarit për keqtrajtim nga personeli i këtij burgu, për të cilat janë zhvilluar hetimet dhe janë marrë masa adekuate nga drejtoria e burgut. Po ashtu janë hetuar edhe tri raste të tjera që ndërlidhen me mundësinë e keqpërdorimit të detyrës zyrtare për cilat është njoftuar edhe policia. Në burgun e Dubravës nuk ka njësi speciale të policisë së burgut, sepse ekzistimi i saj nuk ka bazë ligjore, por ekziston një njësi prej 20 vetave, detyrë e të cilit është aftësimi i stafit korrektues, kontrolli dhe mbikëqyrja e sigurisë në këtë burg e veçmas i kontrabandës eventuale.

Është e vërtetë se në këtë burg është shënuar edhe një rast i përdorimit të një mjeti të improvizuar si thikë që është përdorur nga një burgosur ndaj një i burgosuri tjetër për cilin rast janë marrë masat e duhura disiplinore ndaj kryesit të kësaj shkeljeje të rëndë disiplinore dhe rasti ka kaluar atje te policia e cila ka bërë hetimet duke përcjell lëndët e prokurori për hetime të mëtejme. Meqë personi i cili ka pësuar, por pa pasoja të rënda për jetë, ishte shumë agresiv për shkaqe të sigurisë dhe në interes të ruajtjes së rendit dhe qetësisë është transferuar në një institucion në këtë rast në qendrën korrektuese në Gjilan.

Ministria e Drejtësisë është duke punuar pa reshtur në nxjerrjen e akteve juridike nënligjore që kanë të bëjnë me shtimin e masave të sigurisë në institucionet korrektuese, me krijimin e njësitit për transportimin e të burgosurve, me pajisjen e këtij burgu me mjete dhe instalime moderne elektronike të sigurisë, me rritjen e efikasitetit të bashkëpunimit me Shërbimin Policor të Kosovës, me luftimin dhe parandalimin e korrupsionit eventual dhe keqpërdorimeve të mundshme si dhe me vlerësimin permanent

të personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës , me qëllim të marrjes së masave adekuate ndaj atyre që nuk zbatojnë rregullat dhe ligjet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Z. Bislimi keni pyetje plotësuese.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI- Meqë është fjala për burgjet dhe të burgosurit kam një pyetje shtesë: Çfarë po ndodh me të burgosurit në Mitrovicë, a ka lëvizje të tyre dhe ku po i çojnë?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Z. ministër e keni fjalën.

MINISTRI JONUZ SALIHAI – Nuk ka lëvizje të burgosurve në Mitrovicë, janë shifrat e sakta dhe kanë qenë publike dhe i kam dhënë për mjetet e informacionit publik. Normalisht që numri i të burgosurve në Mitrovicë është pak më i vogël se më parë, por në përgjithësi numri i të burgosurve në Kosovë tani vetëm ka arritur shifrën 1400. Unë dje kam qenë në burgun e Dubravës për fat të keq është shtim numrit të burgosurve, por lëvizja në Mitrovicë nuk është çështje shumë e balancuar atje aq sa shqiptarë sa serbë dhe nuk besoj që do të duhej të manipulohet me këtë shumë edhe pse e dimë që gjendja e sigurisë në Mitrovicë është problematike. Nga ana tjetër unë kam pasë kontakte me komesionerin e policisë dhe janë marrë masa shtesë sidomos në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës dhe në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë dhe çdo gjë është e qetë dhe në rregull në kontroll çdo gjë dhe nuk ka kurrfarë nevojë për shqetësim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Hajredin Hyseni ka pyetje për ministrin Ibrahim Selmanaj. Z. Hyseni e keni fjalën.

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI – Ju faleminderit z. kryetar, z. ministër, në komunën e Besianës që 7 vite 132 familje jetojnë në konteinerë të adaptuar për të banuar në qendrën e quajtur Lagja e Kuvajt. Shumica e këtyre banorëve jetojnë me ndihma sociale dhe ballafaqohen me kushte ma elementare për jetesën. Pushteti lokal nuk ka bërë asgjë për t’ua zgjidhur çështjen e banimit . Pyetja konkrete është:

A ka Ministria ndonjë plan konkret për t’ua zgjidhur çështjen e banimit dhe për t’u strehuar dhe për t’i trajtuar njësoj si qytetarët e tjerë këta banorë?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit!

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ – Ju faleminderit për pyetjen. Unë do ta bëj një pasqyrë se si është gjendja në lagjen Kuvajtiane në Bellovc të Podujevë? Nga **Komuniteti Botëror Islamik** në vitin 1999 janë ndërtuar 18 objekte banimi 16 prej tyre nga 8 banesa kurse 2 prej tyre me nga dy banesa të cilat janë lëshuar në përdorim në korrik të këtij viti.

Në këtë kompleks janë vendosur 132 familje me 623 anëtarë. Pranë objektit është ndërtuar një infrastrukturë rrugore me trotuare me shkolla ambulanca nga **ky komitet**

dhe këndi për lojëra të fëmijëve të lagjes, ku banorët e kësaj lagjeje janë të interesuar për të kultivuar perime në kopsht, është siguruar pronë e mjaftueshme. Struktura e statusit të familjeve, të familjeve të dëshmorëve janë 15 familje në asistencë sociale, 46 familje të viktimave civile të luftës, 5 familje invalidësh të luftës, 8 familje të të rënëve të UÇK-së, janë 5 gjithsej 107, kurse 25 familje që janë të vendosura në këtë lagje kanë nga një anëtar të punësuar. 54 fëmijë të pababë, pa njërin prind marrin nga 20 euro në muaj nga ky komitet. Duhet përmendur edhe një shifer se gratë kryefamiljare janë 31 dhe krejt fëmijë pa prind janë 83. Me datën 12 dhjetor është vizituar kjo lagje nga ministri Çeku që dua ta komentoj një lajm që ishte mbrëmë në lajmet kryesore se askush nga institucionet nuk i ka vizituar dhe që nga ajo kohë thjeshtë ishte një dezinformatë. Lagjja furnizohet me rrymë vetëm kur nuk ka në gjithë komunën është shumë e vërtetë, ka një linjë të veçantë të furnizimit dhe ngrohja përdoret nga ky sistem i furnizimit me këtë linjën e veçantë. Sa i përket ujit kjo lagje furnizohet rregullisht pa ndërprerje, përkundër asaj se banorët e kësaj lagjeje asnjëherë nuk i kanë kryer dhe nuk i kanë shlyer borxhet ndaj KEK-ut dhe obligimet e tjera. Lidhur me ndonjë projekt të ndërtimit të objekteve pas vizitës që është bërë nga ministri Çeku e kemi diskutuar në Qeveri dhe është një ndër prioritetet e para dhe Qeveria shumë shpejt. Gjithë herë duke u bazuar edhe në planet të cilat i kanë komuna, pushteti lokal i Besianës Ministria e Planifikimit Hapësinor. Mendoj se viti 2007 do të jetë një vit që do të rezultojë me një punë konkrete për banorët e kësaj lagjeje. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Z. Hyseni keni pyetje plotësuese.

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI – Ju faleminderit z. ministër. Unë mund të konstatoj se vërtet në atë lagje rrymë më shumë nuk ka se ka dhe nuk është e vërtetë se ata kanë rrymë çdo herë si konstatimi i juaj. Por pyetja ime shtesë është: A mund të na jepni një shifer sa ndërtesa banimi janë ndërtuar nga Qeveria e Kosovës për të kthyerit sot dhe janë shitur ato ndërtesa dhe sa ndërtesa banimi janë ndërtuar dhe momentalisht nuk janë të banuara?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Z. ministër.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ – Më vjen keq që duhet me dalë edhe një herë, por z. Bislimi ka drejtuar një pyetje shumë të gabueshme më së pari, sepse ne, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale dhe t'u kisha lutur herave të tjera se vërtet jemi shumë kooperativë, kërkoj falje para kryeministrit, por nuk jemi në kuiz dhe jo gjithherë ke drejtë me parashtrua pyetje kështu: Parashtroje pyetjen me shkrim do të përgjigjem.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Bajrush Xhemaili ka pyetje për ministrin Dugolli, por ai nuk gjendet këtu, është në udhëtim zyrtar. Urdhëroni z. Xhemaili.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAILI – Për me e përsëritë mos me harruar ai me u përgjigjur po e lexoj. Faleminderit z. kryetarë ju përsëritës të gjithëve. Një vit më parë në shkurt të vitit të kaluar me rastin e privatizimit të gjigantit ekonomik të Kosovës

Feroniklit u nënshkrua kontrata dhe bashkë me të edhe një aneks kontratë si thuhej në mes Agjensionit Kosovar të Mirëbesimit dhe Myral Feronit si pronar i ri i kësaj ndërmarrje. Për përmbajtjen e kësaj kontrate sidomos të aneksit u përfol shumë dhe sot e kësaj dite për pos nënshkruesve askujt nuk u lejohet ta dijë përmbajtjen e saj, taman sikur të ishte kontratë ilegale. Është e çuditshme se si pronari i ri ish- Feronikli tani një kohë Feronikel kërkon shërbime nga institucione të ndryshme të Kosovës, por nuk ua lejon askujt t'ia shikojë as kontratën as aneksin, prandaj pyes ministrin e Tregtisë dhe Industrisë z. Bujar Dugolli, i cili është edhe nënkryetar në bordin e AKM-së që tregojë se përse nuk ban transparente marrëveshja e mbivotimit apo obligimit që ka marrë në kontratë përmes Spinofit Special në bazë të tenderit të publikuar, mbi këtë bazë do të dihej se a janë në përputhje zotimet në kontratë sipas kushteve të tenderimit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Përgjigjen do ta merrni në seancën e ardhshme.

Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastrën.

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë me 31 gusht 2006. komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendi e ka propozuar raportin e rekomandimit me amendamente.

Fjalën e ka përfaqësuesi i Komisionit. Nuk e do. Ju faleminderit.

Në bazë të raportit të Komisionit kryesor dhe Komisionit për Shërbime Publike Administratë Lokale dhe Media ,si komision funksional raportues, në vijim jepet radhitja e rekomandimeve dhe e amendamenteve në tekstin e Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit nr. 2003/25 për kadastrin si vijon:

Komisioni për Çështje Gjyqësore Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2003/25 për kadastrin ka baza juridike në Kornizën Kushtetuese. Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e projektligjit në fjalë nuk kanë implikime buxhetore. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit dhe ndryshimet që bëhen në të dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat, obligimet dhe interesat e komuniteteve. Kalojmë në aprovimin e amendamenteve një nga një.

Amendamenti numër 1.

Votojmë tash: me 62 vota për dhe 2 kundër kalon amendamenti.

Amendamenti numër 2.

Votojmë tash: momentalisht në sallë kemi 69 deputetë.

Me 58 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti.

Amandamenti nr. 3.

Votojmë tash: 63 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.

Amandamenti nr. 4.

Votojmë tash: 62 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti.

Amandamenti nr. 5.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit 59 deputetë për 1 abstenim. Miratohet amendamenti nr. 5

Kalojmë në amendamentin.

DEPUTETJA SALA AHMETAJ – Për fat të keq ne në vazhdimësi po ballafaqohemi me një përbuzje që i bëhet gjuhës edhe në ligjet që na vijnë edhe në dokumentet, ne nuk po mund të paraqitemi vazhdimisht, sepse po shohim se po vazhdon ,do me thënë kjo gjë. Ta zëmë amendamenti të cilin e miratuam, unë kërkova edhe më herët po si duket nuk e pa kryesuesi. Është shkruar me shumë gabime të cilat nuk janë vetëm drejtshkrimore, por kanë edhe konotacione të tjera. Për shembull përcaktimi i kufirit është në rastet kur kufiri i parcelave të pronarëve, ju lutem këtu fqinjë, pronaret dhe pronarët janë dy kuptime të ndryshme, do me thanë ky është vetëm njëri prej gabimeve ka edhe shumë të tjera edhe në këtë amendament edhe në amendamentet e tjera. Ju lusim që të kenë kujdes në përdorimin e gjuhës, sepse këto nuk janë vetëm çështje të lekturës ose të gabimeve drejtshkrimore. Edhe teksti më poshtë ka gabime të tilla. Neni 2.7 njësoj, ose ngastër e tjera. Do me thënë ju lus që t'i korrigjoni këto gabime.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputete. Konsideroj se ne mund të marrim një vendim që sugjerojmë ose obligojmë Zyrën Ligjore që para se ligji të procedohet në nënshkrim t'i bëhet lekturë e duhur drejtshkrimore .

Kalojmë në miratimin e amendamentit numër 6.

Votojmë tash.

Për 59;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti numër 6.

Në sallë janë 67 deputetë.

Kalojmë në amendamentin 7

Votojmë tani.

Për..... 59;

Asnjë kundër.

Kalon amendamenti numër 7.

Amendamenti numër 8

Votojmë tani.

Për..... 58;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti numër 8.

Hedhim në votim amendamentin numër 9.

Votojmë tani.

Për..... 58;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti numër 9.

Kalojmë në amendamentin numër 10

E hedhim në votim.

Votojmë tani.

Për..... 56;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti numër 10.

Amendamenti numër 11

E hedhim në votim.

Votojmë tani.

Për 55;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti numër 11.

Për amendamentin numër 12.

Kërkoj edhe një herë verifikimin e prezencës në sallë. për shkak se kam reagime që janë vetëm 55 deputetë, kërkoj pra verifikimin e prezencës.

Në sallë janë 67 deputetë, kemi kuorum për votim.

Votojmë për amendamentin numër 12

Votojmë tani.

Për 62;

Asnjë kundër.

Kalon amendamenti 12.

Amendamenti numër 13

Votojmë tash.

Për 59;

Asnjë kundër.

Kalon amendamenti 13.

Kalojmë në votimin e amendamentit numër 14

Votojmë tash.

Për 56;

Kundër..... 1,

Kalon amendamenti numër 14.

Kalojmë në votimin e amendamentit numër 15

Votojmë tash.

Për 61;

Asnjë kundër.

Kalon amendamenti numër 15.

Kalojmë në votimin e amendamentit numër 16

Votojmë tash.

Për 60;

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti numër 16.

Kalojmë në votimin e amendamentit numër 17

Votojmë tash

Për 61;

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti 17.

Kalojmë në votimin e amendamentit numër 18

Votojmë tash.

Për 61;

Asnjë kundër.

Kalon amendamenti numër 18.

Kalojmë në votimin e amendamentit numër 19

Votojmë tash.

Për 58;
Kundër 1.

Kalon amendamenti numër 19.

Votojmë amendamentin numër 20.
Votojmë tash.

Për 62;
Asnjë kundër.

Kalon amendamenti numër 20.

Kalojmë në votimin e amendamentit numër 21
Votojmë tash.

Për 65;
Asnjë kundër.

Kalon amendamenti numër 21.

Kalojmë në votimin e amendamentit numër 22
Votojmë tash.

Për 64;
Asnjë kundër.

Kalon amendamenti numër 22.

Kalojmë në amendamentin numër 23
Deputeti Nazim Jashari e ka fjalën.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit z. kryesues. Të nderuar kolegë deputetë. Më lejoni fillimisht ta shpreh pakënaqësinë lidhur me mënyrën si po procedojmë. Unë po përpiqem që së paku 5 minuta të dëgjoj për cilin ligj është fjala, sepse nuk e kisha vëmendjen kur filloi shqyrtimi i këtyre amendamenteve dhe nuk po dëgjohej kërkund hiç amendamenti i filan ligjit. Pra, jemi me siguri për Ligjin për arbitrazhin, kadastrën. Prandaj z. kryesues është e udhës të përsëritet amendamenti i Ligjit. Hapet debati, mbyllet debati, nëse nuk ka për debat, për amendament, e jo kështu të shkojmë me një automatizëm sikur makinë.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Para çdo votimi për amendamentet kur është kërkuar fjala ,pra për amendamentin i cili votohet në vijim, deputetët e kanë marrë fjalën dhe kanë shprehur vërejtjet dhe reagimet.

Votojmë për amendamentin numër 23

Pika e rendit të ditës e cila është në vijim dhe për cilën po votohet.
Votojmë tash.

Për 65;
Asnjë kundër.
Miratohet amendamenti numër 23.

Lus deputetët të përgatiten për votimin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e votuara.

Vë në votim miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastrën me amendamentet e votuara, pra në këtë seancë.
Votojmë tash.

Për 69;
Kundër..... 1.

Konstatohet se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastrën.
Në sallë ishin në momentin e votimit 76 deputetë.

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës. Lus deputetët për vëmendje se çka do të shqyrtohet në pikën e 6-të të rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për arbitrazhin

Konstatime hyrëse.
Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 27 prill 2006.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, si komision funksional dhe raportues, në vijim jepet radhitja e rekomandimeve dhe e amendamenteve në tekstin e Projektligjit për arbitrazhin.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për arbitrazhin ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për arbitrazhin dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për arbitrazhin dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Për fjalë është paraqitur deputetja Nerxhivane Dauti. E keni fjalën.

DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI – Ju faleminderit z. kryesues. Në cilësinë e raportueses së Komisionit për Legjislacion kam nevojë t’i jap disa sqarime lidhur me këtë projektligj para se të votohen amendamentet e propozuara.

Pas leximit të parë të mbajtur më 27 prill 2006 Projektligji është shqyrtuar nga Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese. Pas shqyrtimit të tekstit të Projektligjit dhe pas konsultimeve të brendshme me palë të interesuara, veçanërisht me Odën Ekonomike të Kosovës ,rekomandohet që Projektligji për arbitrazhin të miratohet nga Kuvendi i Kosovës me ndryshime që do të paraqiten në vijim.

Paraprakisht konsideroj se disa aspekte të Projektligjit duhet të sqarohen, aspekte që janë të rëndësishme për Kuvendin. Projektligji për arbitrazhin inkorporon tërësisht model Ligjin **e uncitralit** për arbitrazhin.

Projektligji po ashtu inkorporon Konventën e Nju Jorkut për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazheve të huaja të vitit 1958. Duhet theksuar se një pjesë e madhe e propozimeve për ndryshim të Projektligjit që janë paraqitur nga Oda Ekonomike e Kosovës nuk janë marrë parasysh me rastin e shqyrtimit të këtij Projektligji. Arsyeja është se këto propozime janë bazuar në një keqinterpretim të materies të cilën e rregullon Projektligji për arbitrazhin.

Oda Ekonomike ka propozuar një sërë ndryshimesh qëllimi i të cilave ishte institucionalizimi i arbitrazhit rreth Odës Ekonomike. Sipas Ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës Ligji numër 2004/7 i datës 20 maj 2005, Oda Ekonomike e ka arbitrazhin e përhershëm në kuptimin e arbitrazhit institucional ,i cili është kompetent për zgjidhjen e kontesteve të biznesit mes anëtarëve të Odës dhe personave të tjerë fizikë ose juridikë.

Përbërjen, organizimin dhe kompetencat e këtij arbitrazhi, si dhe procedurat e tij në kuadër të këtij arbitrazhi institucional i rregullon vetë Oda Ekonomike me statut dhe me akte të tjera të përgjithshme të Odës. Për këtë nuk nevojitet ligj i Kuvendit. Për këtë arsye rregullimi i arbitrazhit në kuadër të Odës Ekonomike nuk është qëllimi i Projektligjit për arbitrazhin. Në shkencën juridike bëhet dallimi midis arbitrazhit ad-hok dhe arbitrazhit institucional.

Në arbitrazhin ad-hok vullneti i lirë i palëve është determinanti kryesor lidhur me përcaktimin e përbërjes së tribunalit të arbitrazhit dhe të procedurës të cilën e ndjek ky tribunal. Në anën tjetër ka raste ku ligjvënësi autorizon ndonjë institucion që të ofrojë shërbime të arbitrazhit , që quhet arbitrazh institucional. Një autorizim të tillë e ka Oda Ekonomike në bazë të Ligjit për Odën Ekonomike. Mirëpo një autorizim i tillë nuk

nënkupton që ky institucion ka monopolin në fushën e arbitrazhit dhe po ashtu nuk nënkupton që palët në kontest kanë për detyrë t'i nënshtrohen arbitrazhit të këtij institucioni.

Palët mund t'i nënshtrohen arbitrazhit institucional, konkretisht t'i drejtohen Odës Ekonomike dhe atëherë bëhet në funksion tribunali i caktuar nga Oda dhe zbatohet procedura e caktuar nga ajo. Mirëpo palët po ashtu kanë të drejtë të zgjedhin arbitrazhin ad-hok në kuadër të të cilit ata vetë e mbrojnë arbitrat dhe vetë e caktojnë procedurën e arbitrazhit. Mu rregullimi i arbitrazhit ad-hok është qëllimi i Projektligjit për arbitrazhin që po e votojmë sot. Nëse krahasohen ligje të tjera të arbitrazhit në rajon dhe në Evropë shihet qartë se objekti i rregullimit ligjor është arbitrazhi ad-hok, sepse në asnjë prej ligjeve të tjera nuk figuron referenca në oda ekonomike ose institucione të tjera.

Çështjet e arbitrazhit institucional rregullohen me ligj të veçantë dhe janë të ndara nga rregullimi ligjor i arbitrazhit ad-hok.

Siç theksova më lart Komisioni ka identifikuar disa çështje që duhet të sqarohen më mirë dhe këto i ka formuluar në formë të amendamenteve në vijim..

Kolegë të nderuar deputetë,

Ju ftoj të votoni për amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion si Komision funksional. Pra, të gjitha amendamentet në vijim janë të Komisionit funksional. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputete. Pra ,dëgjuam edhe në emër të Komisionit Funksional fjalën e z. deputete Nerxhivane Dauti. Kalojmë në procedim të amendamenteve për votim.

Amendamenti numër 1

Votojmë tash.

Për..... 52;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti numër 1.

Kalojmë në votimin e amendamentit numër 2

Më falni, Nazim Jashari e ka fjalën, Urdhëro Nazim.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit z. kryesues. E kam shumë të qartë pse nuk shikohet kah salla me rastin e trajtimit të amendamenteve se zakonisht nuk e marrin fjalën ose e marrin rrallë. Prandaj edhe ky automatizëm, po vërejtja përsëri qëndron së paku atje në **grafikë** duhet të figurojë ligji për të cilin është duke u diskutuar ose debatuar. Deputetët që vijnë me vonesë që mund të përfshihen e që nuk kanë qenë pjesë e kësaj pune ,ta dinë se për cilin ligj është fjalë. Tek amendamenti numër 2 e kam këtë vërejtje. Unë jam pjesë e Komisionit i cili ka punuar, po që vendimet në këtë komision

janë marrë me shumicë votash ose nuk kam qenë atë ditë kur është marrë vendimi definitiv.

Mendoj se propozimi në Projektligj është larg më i mirë se sa propozimin që e ka bërë Komisioni. Pra ,duhet ta përcjellim një praktikë e cila funksionon gjithkund thuaja ku ekzistojnë ligjet për arbitrazhin dhe që me procedurë kontestimore këto materie rregullohen përmes gjykatave të qarkut apo gjykatave të rregullta dhe jo Gjykatës Ekonomike, e cila mund të jetë një gjykatë e specializuar që merret me probleme ekonomike, po jo edhe që trajton lëndë të materies të cilat kanë të bëjnë me **konteste mes ...** Prandaj në këtë aspekt mendoj se përpiluesi, hartuesi i ligjit, pra propozuesi i ligjit e ka bërë zgjidhjen më të mirë sesa Komisioni që e ka miratuar dhe kisha dëshiruar që Kuvendi ta konfirmojë nenin sipas propozimit të propozuesit të ligjit. Është edhe një rast më vonë në nenin 23 të cilën prapë do të ndalem dhe do të kërkoj fjalën. Faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputet ishte një reagim i një anëtari të Komisionit Funkcional. Hedhim në votim amendamentin numër 2- propozues Komisioni Funkcional.

Votojmë tash.

Për 53

Kundër 9.

Kalon amendamenti numër 2.

Në sall janë 67 deputetë.

Amendamenti numër 3

Për fjalë është paraqitur deputetja Sala Ahmetaj. E keni fjalën.

DEPUTETJA SALA AHMETAJ – Tek amendamenti numër 3 kujtoj se Komisionit ose i ka shpëtuar ose nuk e di një fjalë që nuk është e domosdoshme, s’është e nevojshme të jetë këtu ose të zëvendësohet me ndonjë fjalë tjetër. Është fjala për nenin 5.2. Të gjitha mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me kërkesa civile juridike dhe ekonomike juridike mund t’i nënshtrohen arbitrazhit, përveç nëse shprehimisht është e ndaluar me ligj. Kujtoj se fjala shprehimisht është e panevojshme. Do me thënë përveç nëse është e ndaluar me ligj, sepse shprehimisht unë nuk e di çfarë kuptimi mund të ketë si fjalë në një ligj, nëse nuk është e saktësuar me ligj ose nuk është e ndaluar me ligj . Fjala shprehimisht ,pra ,të hiqet, mendoj s’është e nevojshme. Në gjuhë i thonë **të prinë** në informim.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Në emër të Komisionit Z. Nerxhivane Dauti, e keni fjalën.

DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI – Unë mendoj se në qoftë se gjuhësisht i pengon ajo ligjit duhet m’u fshi.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Faleminderit.

E vëmë në votim amendamentin numër 3 me vërejtjen që e dha deputetja Sala Ahmetaj. Votojmë tash.

Për 56;
Kundër 3.
Miratohet amendamenti numër 3.

Amendamenti numër 4
Komisioni FunkSIONAL -votojmë tash.

Për 59;
Kundër 2.
Miratohet amendamenti numër 4.

Amendamenti numër 5
Komisioni FunkSIONAL -votojmë tash.

Për 58;
Asnjë kundër.
Kalon amendamenti numër 5.

Amendamenti numër 6
Propozim pra i Komisionit funksional, votojmë tash.

Për 55
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti numër 6.

Amendamenti numër 7
Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për 56;
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti numër 7.

Amendamenti numër 8
Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për..... 58;
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti numër 8.

Amendamenti numër 9
Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për 58;
Asnjë kundër.
Kalon amendamenti numër 9.

Amendamenti numër 10
Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për 57;
Asnjë kundër.

Kalon amendamenti numër 10.

Amendamenti numër 11
Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për..... 61;
Kundër 1.

Kalon amendamenti numër 11.

Amendamenti numër 12
Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për 62;
Kundër 2.

Kalon amendamenti numër 12.

Amendamenti numër 13
Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për 59;
Kundër..... 1.

Kalon amendamenti numër 13.

Amendamenti numër 14
Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për 66;
Kundër..... 1.

Kalon amendamenti numër 14.

Amendamenti numër 15
Komisioni funksional, votojmë tash.

Për 61;
Asnjë kundër.

Kalon amendamenti numër 15.

Amendamenti numër 16
Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për..... 59;
Asnjë kundër.
Kalon amendamenti numër 16.

Amendamenti numër 17
Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për 64;
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti numër 17.

Amendamenti numër 18
Komisioni funksional, votojmë tash.

Për 58;
Kundër 2.
Kalon amendamenti numër 18.

Amendamenti numër 19
Komisioni funksional, votojmë tash.

Për 57;
Kundër 1.
Kalon amendamenti numër 19.
Në sall janë 69 deputetë.

Amendamenti numër 20
Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për 62;
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti numër 20.

Amendamenti numër 21
Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për 60;
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti numër 21.

Amendamenti numër 22
Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për 60;
Kundër.... 1.

Kalon amendamenti numër 22.

Amendamenti numër 23

Për fjalë është paraqitur deputeti Nazim Jashari. E keni fjalën.

DEPUTETI NAZIM JASHARI - Faleminderit z. kryesues. Të nderuar kolegë deputetë. Insistoj edhe një herë që të jemi më të vëmendshëm në punë dhe të përpiqemi ta përmirësojmë punën e Komisionit këtu në seancë se është e drejtë jona e patjetërsueshme.

Ky ligj është një ligj shumë i rëndësishëm i nevojshëm, i domosdoshëm, për çudi ka qenë një ligj shumë i mirë i punuar nga propozuesi, shumë i mirë, po habia ime këtu është që propozuesi nuk ka ndejt në seancë që ta mbrojë punën e vet dhe siç duket nuk po e merr autorsinë mbi këtë punë, sepse përndryshe do të kishe ndejt këtu dhe do ta kishte mbrojtur punën e vet. Ne si Komision pra, me dy vendime tona me dy amendamente tona e kemi dobësuar ligjin, amendamentin numër 2 dhe amendamentin numër 23. Në qoftë se është taksativisht e thënë në Propozimligj që është Gjykata Supreme ajo së cilës i drejtohen vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës, këtu me propozimin e amendamentit është paraparë të jetë Gjykata Ekonomike.

Gjykata Ekonomike nuk mund kurrë t'i ketë fuqinë dhe autoritetin e Gjykatës Supreme, ajo nuk mund të autorizojë gjykatat e tjera, Gjykata Ekonomike ,pra ,s'mund të ketë autoritetin për t'i autorizuar gjykatat e tjera në Kosovë për të zbatuar vendime, Gjykata Supreme po. Prandaj të jemi më të vëmendshëm dhe ta kthejmë amendamentin mbrapsht dhe ta votojmë ashtu siç e ka paraparë propozuesi . Është Gjykata Supreme ajo e cila mund t'i delegojë lëndën gjykatës e cila ka kompetencë lëndore në territorin e së cilës parashihet të ekzekutohet vendimi i arbitrazhit Gjykata Ekonomike këtë kompetencë nuk mund ta ketë. Prandaj edhe një herë po insistoj ta bëjmë përmirësimin, pra ta kthejmë amendamentin mbrapa.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Deputetja Nerxhivane Dauti e ka fjalën.

DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI – Ju faleminderit z. kryesues, këtu është fjala për vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës. Prandaj kompetenca është shumë e qartë. Këtu ka qenë intenca e Komisionit Funkcional që të ndërrohet kompetenca, do me thanë që të jetë Gjykata Supreme e jo gjykata e shkallës më të ulët. Fjala është për një instancë më të lartë.Pra, instancë më të lartë se Gjykata Supreme nuk ka. Prandaj, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës e bën vetëm Gjykata Supreme e Kosovës.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Deputeti Nazim Jashari e ka fjalën.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Pra, prof. Nerxhivane ka plotësisht të drejtë, pajtohet me mua edhe unë pajtohem me te, por në amendament dhe askund nuk na figuron Gjykata Supreme. Gjykata Supreme na figuron vetëm në nenin e 40 të propozuar nga

propozuesi, por Gjykatë Supreme nuk e kemi fare në amendament, këtu qëndron esenca, prandaj duhet që ta kthejmë ashtu siç e ka dhënë propozuesi dhe jo të shkojmë në formën siç ka ardhur me amendament.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Nuk ka të lajmëruar më për fjalë.

Vë në votim amendamentin numër 23 të propozuar nga Komisioni Funkcional
Votojmë tash.

Për 46;
Kundër..... 14.

Kalon amendamenti numër 23.

Amendamenti numër 24 dhe i fundit.
Komisioni Funkcional, votojmë tash.

Për..... 61;
Kundër..... 1.

Miratohet amendamenti numër 24.

Të nderuar deputetë ,vë në votim Projektligjin në tërësi për arbitrazhin me amendamentet e votuara në këtë seancë.

Votojmë tash.

Për..... 69;
Kundër..... 1.

Konstatohet se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për arbitrazhin në tërësi. Në sallë ishin 70 deputetë. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e varieteteve të bimëve

Konstatimet hyrëse. Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 31 gusht 2006. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente. Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, në vijim jepet radhitja e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për mbrojtjen e varieteteve të bimëve si vijon.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për mbrojtjen e varieteteve të bimëve ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për mbrojtjen e varieteteve të bimëve dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për mbrojtjen e varieteteve të bimëve dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Ju ftoj të merrni pjesë në votimin e amendamenteve të propozuara në këtë projektligj.

Amendamenti numër 1

Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për 59;

Kundër... 2.

Kalon amendamenti numër 1.

Amendamenti numër 2

Komisioni FunkSIONAL propozues, votojmë tash.

Për 59;

Kundër 2.

Kalon amendamenti numër 2.

Amendamenti numër 3

Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për..... 59;

Kundër... 1.

Kalon amendamenti numër 3.

Amendamenti numër 4

Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për 62;

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti numër 4.

Amendamenti numër 5

Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për 58;

Kundër 1.

Kalon amendamenti numër 5.

Amendamenti numër 6

Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash.

Për..... 54;
Kundër..... 1.

Kalon amendamenti numër 6.

Amendamenti numër 7
Komisioni funksional, votojmë tash.

Për 56;
Kundër 1.

Kalon amendamenti numër 7.

Amendamenti numër 8
Komisioni funksional, votojmë tash.

Për..... 57;
Kundër.... 3.

Kalon amendamenti numër 8.

Amendamenti numër 9 dhe i fundit
Komisioni funksional, votojmë tash.

Për 59;
Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti numër 9.

Të nderuar deputetë ,më lejoni që ta vë në votim Projektligjin për mbrojtjen e varieteteve të bimëve me amendamentet e miratuara në këtë Kuvend.
Votojmë tash.

Për 69;
Asnjë kundër.

Konstatoj se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për mbrojtjen e varieteteve të bimëve.

Në sallë në momentin e votimit ishin 72 deputetë.

Për fjalë është lajmëruar deputetja Sala Ahmetaj.E keni fjalën.

DEPUTETJA SALA AHMETAJ – U paraqita disa herë sot ,por kështu është puna. Më vjen keq po edhe këto korrigjime gjuhësore që janë bërë nuk janë bërë mirë shumica dhe ju lus të keni kujdes për gjuhën. Nuk ka, do me thënë togfjalësh se këtu është thënë fjala nejse, është çështje tjetër ajo, por qartë i ndryshëm ose qartë i dallueshëm. Ajo është ose i ndryshëm ose s'është i ndryshëm. E qartë është shumë e panevojshme si fjalë, do me thanë edhe të tjera, po nuk po shkojmë më tutje.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Besoj që duhet të kemi parasysh dhe vërejtja të shkojë atje ku edhe e ka vendin në Zyrën Ligjore që para se ligjet të vijnë në shqyrtim në Kuvend dhe këto pasi që janë miratuar para se të shpallen të bëhet korrekture gjuhësore e projektligjeve.

Pauzë deri në orën 2,30 minuta. I lus deputetët, është kërkesa që pauza deri në orën 2,00 ju lus deputetët që të vini në sallë në kohë, për shkak që i kemi dy debate. Faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Të shikojmë a kemi kuorumin për të filluar pikën me debat,
Të nderuar deputetë, vazhdojmë punën- pika e 8 e rendit të ditës,

8. Debat për gjendjen e sigurisë në Kosovë

Konstatimet hyrëse:

Në seancën plenare të Kuvendit të mbajtur më 21 dhjetor 2006, është miratuar propozimi që të debatohet për çështjen e sigurisë në Kosovë. Për të përgatitur këtë debat është kërkuar nga ministri i Punëve të Brendshme, zoti Fatmir Rexhepi, që të përgatitë dhe Kuvendit t'ia paraqes një informatë, për gjendjen e sigurisë në vend. Raporti për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në Kosovë u është shpërndarë deputetëve më 24. janar 2007. Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të PDK-së si propozues ta marrë fjalën, propozues i debatit për këtë pikë të rendit të ditës.

DEPUTETI, JAKUP KRASNIQI – I nderuari kryesues, ministër, të nderuar deputetë!
Ne patëm kërkuar që Parlamenti të debatojë për çështjen e sigurisë edhe mbi bazën e një raporti ose informacioni që do ta merrnin nga ministri i Punëve të Brendshme ose nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ne dje kemi marrë një raport, por ajo që dua të them është një raport shumë përgjysmues, ndoshta edhe për faktin se sfera më e madhe ose pjesa më e madhe e sigurisë është në kompetencat e administratës së UNMIK-ut dhe të shefit të UNMIK-ut dhe mekanizmave të tjerë, kështu që ndoshta më mirë kishte me qenë të jetë raporti më i plotë, këtu para nesh t'i kishim edhe drejtuesit ose përgjegjësit kryesorë të sigurisë në Kosovë, përndryshe neve që kemi përcjell vazhdimisht dhe me kujdes sigurinë në Kosovë, mund të themi se raporti na ofron më pak informacione sesa që kanë dhënë mjetet e informimit publik.

Prandaj unë mund të them se për grupin parlamentar, por edhe për mua si deputet i Parlamentit të Kosovës, mund të them që Qeveria dhe Ministria ose nuk e kanë kuptuar, ose nuk duanë të kuptojnë rëndësinë e sigurisë për jetën e njeriut, për procesin politik, për zhvillimin ekonomik dhe në fund të fundit për jetën dhe sigurinë e fëmijëve tanë dhe kjo pasiguri shihet në shumë segmente.

Konsideroj që në raport nuk janë përfshirë të gjitha segmentet që rrezikojnë jetën e qytetarëve të Kosovës. Këtu ndoshta nuk është dashtë të lihet anash as siguria në

komunikacion, ku përditë humbin jetë njerëzish. Këtu me pakë fjalë, ose tepër pak fjalë është folur për krimin e organizuar politik dhe ekonomik që ka ndodhur në Kosovë. Dhe cila është shkalla e ndriçimeve dhe deri ku kanë shkuar ndriçimet për krime të rënda politike dhe ekonomike, në raport vetëm përmendet, por nuk thuhet asgjë konkrete.

Nuk thuhet asgjë konkrete edhe për aksionet e shumta shpërthyesë që kanë ndodhur gjatë këtyre viteve në Kosovë, edhe gjatë këtij mandati. Fundi i fundit nëse veprat e ndryshme kriminele nuk janë zbuluar edhe në mandatin kur nuk ka ekzistuar kjo ministri. Ne si Parlament duhet të kemi informacione. A janë mbyllë ato vepra, apo vazhdon hetimi se derisa veprat nuk zbulohen aty gjithnjë njerëzit që kanë kryer ato vepra janë potencial për të vazhduar krimin., qoftë të natyrës politike, qoftë të natyrës ekonomike. Ne jemi në pritje të madhe dhe përsëri Ministria i ka kushtuar pak rëndësi sigurisë në tërë hapësirën e Kosovës. Është përmendur pak, çështja e statusit politik dhe çështja e pritjes, por mendoj se kësaj çështjeje nuk i është kushtuar rëndësi e duhur.

Ministria ndoshta është dashtë të na sqaronte, cilat janë lëvizjet edhe pse është bërë lëvizja e të burgosurve nga burgu i Mitrovicës Veriore. Pse një pjesë e administratorëve të asaj pjese tani i lëshojnë banesat e tyre dhe nuk na është thënë se cila është shkalla e rrezikshmërisë që mund të vijë nga ajo pjesë e Kosovës për Kosovën dhe për qytetarët e saj. Mendoj se për këtë pikë në raport është dashtë të thuhet diçka më tepër. Thuhet se ekzistojnë veprimet paralele ose të strukturave të MUP-it dhe të mekanizmave të tjerë të Serbisë dhe ato janë njëfarë monitorimi, nuk dimë për çfarë monitorimi është fjala dhe ato grupe që mund t'i rrezikojnë sigurinë, jetën e njerëzve në Kosovë, vërtetë vetëm duhet të monitorohen? Edhe cilat do të ishin masat që do t'i merrte Ministria? Po çka në fund të fundit, ne e dimë se Ministria ka kompetenca dhe përgjegjësi të kufizuara. A kanë marrë ndonjë masë Ministria dhe Qeveria për të kërkuar nga përgjegjësit kryesorë të sigurisë në Kosovë, të kemi informacione më shumë ne- institucionet e Kosovës. Dhe mendoj që për të gjitha çështjet që është dashtë të jepet përgjigje, nga Ministria ose që ka muajt të jepen përgjigje nga Ministria, është dashtë të jenë përgjigjet me konkrete.

Nëse për të gjitha Ministria dhe ministri kanë qenë të pamundur për të dhënë përgjigje, atëherë është dashtë të kërkohet ndihmë nga organet përgjegjëse për sigurinë në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, Fatmir Rexhepin ta marrë fjalën.

MINISTRI, FARMIR REXHEPI – I nderuari kryesues i seancës, i nderuar kryeministër, kolegë ministra, të nderuar deputetë!

Me kërkesën e Kryesisë së Parlamentit, ne u përpoqëm për një kohë të shkurtë të përgatisim një raport, një informatë sa më complete që ta keni para veti, në mënyrë që të debatojmë për gjendjen e sigurisë, faktorët dhe masat, të cilat duhet t'i ndërmarrim si institucione, por edhe si Ministri e Punëve të Brendshme në kuadër të mandatit të cilin e kemi. Gjatë kësaj paraqitjeje, unë sigurisht që do t'i keni edhe disa, do t'i hasni disa korrigjime të vogla në tekst që janë lëshuar, prandaj më lejoni që ta paraqes këtë raport para juve:

Gjendja e përgjithshme e sigurisë në Kosovë, në bazë të dhënave që ka në dispozicion Ministria e Punëve të Brendshme, vazhdon të jetë e qetë dhe stabile. Përkundër rasteve deri më tash të izoluara të prishjes së rendit dhe qetësisë publike, si dhe veprave kriminale, situata e përgjithshme e sigurisë është nën kontrollin e mekanizmave vendorë e ndërkombëtarë të sigurisë në Kosovë.

Faza e zhvillimit në të cilën ndodhet vendi karakterizohet me sfida të ndryshme të brendshme dhe të jashtme, që mund të rezultojnë me prishjen e rendit, të sigurisë publike dhe stabilitetit të Kosovës. Mirëpo, mekanizmat e sigurisë vlerësojnë se janë duke marrë masat nevojshme dhe të mjaftueshme për t'i përballuar ato. Gjatë këtij raporti do të paraqesim sfidat veç e veç dhe në tërësi, si dhe ndikimin e tyre të përgjithshëm në situatën e sigurisë në vend.

Një ndër sfidat kryesore, e cila shtjellohet në këtë raport, mbetet relacioni i qytetarëve të Kosovës me procesin e definimit të statusit të vendit dhe reagimet e tyre të mundshme pas prezantimit të propozimit mbi statusin final. Reagimet e individëve ose të grupeve të caktuara gjatë fazës së ardhshme pritet të shprehin pakënaqësitë eventuale të tyre në forma të ndryshme dhe sfiduese për sigurinë e përgjithshme në vend. Po ashtu, këtu bëjnë pjesë edhe strukturat paralele dhe funksionimi i deritashëm i tyre në vend.

Kështu që, në këtë raport jepen në mënyrë të qartë elementet sfiduese të sigurisë në Kosovë, informatat për raste të caktuara, si dhe masat të cilat janë ndërmarrë deri më tash dhe që do të ndërmerren në ndërkohë. Raporti është i bazuar në raportet e përgatitura edhe më herët nga MPB-ja për Kuvendin e Kosovës, SHPK-ja për MPB-në, deklaratimet zyrtare dhe publike të institucioneve e të mekanizmave përgjegjës të sigurisë në Kosovë.

Siguria e përgjithshme në Kosovë shoqërohet nga sfida dhe kërcënime të caktuara, të cilat përbëhen nga: procesi i përcaktimit të statusit të Kosovës; strukturat paralele; paraqitja e personave me maska; posedimi ilegal i armëve dhe vendosja e mjeteve eksplozive; mundësia e shprehjes së pakënaqësisë nga ana e qytetarëve, varësisht prej rezultatit të statusit; gjendja e vështirë ekonomike dhe sociale e disa kategorive në shoqëri; krimi i organizuar; ekstremizmi islamik dhe transferimi i kompetencave.

2.1 Procesi i përcaktimit të statusit të Kosovës

Kosova gjendet në fazën e fundit të procesit të përcaktimit të statusit të saj, i udhëhequr nga i dërguari i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, presidenti Martti Ahtisari. Fakti se tashmë gjendemi në fazën finale të këtij procesi pashmangshëm do të thotë se qytetarët e Kosovës në përgjithësi dhe grupet etnike veç e veç, në veçanti janë më të ndjeshëm në aspektin e perceptimit të sigurisë.

Në këtë kontekst propozimi që pritet të bëhet së shpejti publik, mund të zgjojë pakënaqësi të individëve apo të grupeve të caktuara të vogla në Kosovë. Sidoqoftë duhet thënë se Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me mekanizmat e sigurisë në Kosovë është e vetëdijshme për rëndësinë e kësaj faze dhe për rolin sfidues të saj në sigurinë e përgjithshme në Kosovë.

Policia dhe mekanizmat e tjerë përgjegjës janë të sensibilizuar për nevojat e tashme dhe për mbajtjen dhe ruajtjen e sundimit të ligjit, si dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të qytetarëve të Kosovës. Për këtë, bazuar në raportet zyrtare të policisë, tashmë kemi një numër më të madh të pjesëtarëve të SHPK-së dhe të policisë ndërkombëtare që janë prezentë në pjesët që mund të cilësohen si më të ndjeshme të vendit.

Gjendja e sigurisë në pjesën Veriore të Kosovës vazhdon të mbetet çështja më e ndjeshme në vend gjatë procesit të statusit final. Specifikat që e kanë karakterizuar këtë pjesë të vendit prej mbarimit të luftës në Kosovë në vitin 1999, forcojnë sfidën ndaj mekanizmave vendorë e ndërkombëtarë në ruajtjen e qetësisë publike dhe sundimin e ligjit. SHPK-ja dhe përgjegjësit e tjerë të sigurisë, sikurse KFOR-i dhe Policia e UNMIK-ut, tash për tash veprojnë normalisht dhe rregullisht në këtë pjesë të vendit.

Në aspektin politik, pjesa Veriore e regjionit të Mitrovicës, është mjaft e ndjeshme dhe vazhdon të jetë problem politik, edhe në kohën e afërt kur pritet të publikohet propozimi mbi statusin e Kosovës. Pakënaqësia e mundshme e një pjese të qytetarëve të Kosovës si individë apo si grupe mund të ndikojë në aktivizimin më të intensifikuar të strukturave paralele. sidomos në këtë rajon.

Sidoqoftë, masat e deritashme dhe ato të planifikuara janë bërë në bazë të raporteve dhe të informacioneve që kanë mekanizmat e sigurisë në Kosovë. Ekziston një qasje e përpunuar dhe e planifikuar strategjike për rajonin e Veriut të Kosovës. Njëra prej elementeve të rëndësishme të këtij plani ose qasjeje është vendosja e Komandës Rajonale të SHPK-së, nga pjesa Jugore e qytetit të Mitrovicës, në pjesën Veriore të tij .

2.2 Strukturat paralele

Në bazë të informacioneve që disponojmë në Kosovë veprojnë organizata të ndryshme ilegale, si ato të MUP-it të Serbisë, të cilat kryesisht funksionojnë nëpër vendbanimet e komunitetit serb.

Mirëpo, këto struktura janë në monitorim të SHPKsë dhe Policisë së UNMIK-ut dhe të organet e sigurisë në pajtueshmëri me autorizimet e tyre do t'i marrin masat e nevojshme në përputhshmëri me ligjin, për çka janë inkurajuar nga Qeveria dhe MPB-ja.

Njoftimet dhe raportet zyrtare të organeve të rendit dhe sigurisë, po ashtu flasin se ka edhe organizata të ndryshme, si SHIK-u, SIA, si dhe grupe të tjera ekstremiste, të quajtura si AKSH, organizata këto të cilat përmes komunikatave anonime në mediat e shkruara dhe elektronike kohë pas kohe, dërgojnë kërcënime të ndryshme në adresë të qytetarëve, si dhe të personaliteteve të ndryshme politike dhe institucioneve të Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare.

Lidhur me strukturat paralele që veprojnë në Kosovë edhe pse kjo mbetet fushë e rezervuar për policinë e UNMIK-ut, SHPK-ja do të veprojë ndaj çdo personi apo organizate e cila merret me veprimtari kriminale në Kosovë.

2.3 Paraqitja e personave me maska

Në bazë të raporteve nga SHPK-ja dhe burimeve të hapura mund të arrihet në konkluzione gjysmake se në disa rajone në Kosovë, kryesisht në rajonin e Dukagjinit (rreth Malishevës, Gjakovës, Klinës dhe Istogut) dhe atë të Drenicës (Skënderajt) veprojnë grupe të maskuara të cilësuar si kriminale dhe të armatosura, të cilat grabisin qytetarët duke u prezantuar si pjesëtarë të të ashtuquajturës AKSH. Ata gjatë këtyre akteve kriminale, po ashtu fusin frikën tek këta qytetarë në mënyrë që të mos i raportojnë rastet në Polici. Në disa raste përpos se është raportuar se janë vjedhur (grabitur) të holla, telefona mobil, janë grabitur edhe dokumente personale identifikuese. Për të gjitha këto pra posedojnë të dhëna më të detajuara nga SHPK-së.

2.4 Incidentet e fundit që mund të ndikojnë në sigurinë e përgjithshme në Kosovë

Gjatë muajve gusht-tetor 2006, siç jemi njoftuar janë evidentuar disa raste të izoluar, të shpërthimeve në disa rajone, të cilat kanë pasur një reflektim negativ në pasqyrën e sigurisë së përgjithshme në Kosovë:

- Në Gjilan kanë ndodhur tri shpërthime dhe në Ferizaj një shpërthim i ngjashëm;
- Në rastin e shpërthimit në Klinë, përveç dëmeve materiale, janë plagosur 4 persona të minoritetit serb;
- Në rastin e shpërthimit në Dragash nuk ka pasur të lënduar;
- Shpërthimi në pjesën veriore të Mitrovicës (kafiteria Dolce Vita) janë lënduar disa persona të minoritetit serb;

Hetimet nga ana e policisë në Kosovë, për këto raste janë ngritur në nivelin më të lartë dhe janë intensifikuar, duke pasur parasysh ndikimin e këtyre rasteve në situatën e përgjithshme të sigurisë dhe nevojën për të ndriçuar sa më shpejtë këto raste.

Ministria e Punëve të Brendshme -janar 2007

2.4.1 Rasti i gjetjes së armëve në fshatin Shtuticë

Në bazë të raporteve nga SHPK-ja, më 9 dhjetor 2006 rreth orës 9:30 në fshatin Shtuticë të komunës së Drenasit nga njësitë policore dhe të KFORit është zbuluar një sasi e madhe e armatimit të llojeve të ndryshme në një veturë kombi, pronë e një mashkulli shqiptar të Kosovës. Lidhur me këtë rast është bastisur edhe shtëpia e një të dyshuari tjetër në oborrin e të cilit ishte parkuar kjo veturë, me ç'rast është gjetur një sasi e konsiderueshme e armatimit dhe e municionit. Rasti është klasifikuar nga SHPK-ja si "gjetje e armëve dhe e municionet - kontrabandim me armë dhe municion".

- Gjatë këtyre bastisjeve janë gjetur armë që variojnë prej një topi pa dridhje, mbi 100 granata të kalibrit të ndryshëm, mbi 2000 fishekë të kalibrit të ndryshëm, pushkë automatike, çanta dhe pajisje të tjera ushtarake. Armatimi dhe municioni i konfiskuar nuk ka mundur të ekzaminohet nga ana e krimteknikës, pasi që granatat dhe municioni për shkaqe sigurie janë shkatërruar nga ana e KFOR-it finlandez.
- Për rastin e Shtuticës janë arrestuar tre të dyshuar, ndërsa lënda është dërguar në Prokurori. Policia ka arrestuar Mursel Bilallin, Naim Bazajn (nga komuna e Drenasit) dhe Halit Ademin (nga komuna e Vitisë). Për arsye se njëri nga të dyshuarit ka qenë zyrtar i atëhershëm i Qeverisë, e gjithë çështja është politizuar dhe rrjedhimisht ka tërhequr vëmendjen e opinionit kosovar.

Në vazhdim e sipër janë hetimet e veçanta lidhur me mbajtjen, prejardhjen, destinimin dhe involvimin që kanë të bëjnë me këtë rast.

Posedimi i armëve pa leje dhe kontrabandimi i tyre, konsiderohen sfida për sigurinë në Kosovë. Për këtë arsye MPB-ja sugjeron që gjatë vitit 2007, KFOR-i në bashkëpunim me faktorët relevantë të sigurisë të hartojë dhe të zbatojë një plan të detajuar dhe gjithëpërfshirës i cili do të mundësonte tejkalimin e suksesshëm të kësaj sfide.

2.4.2 Rasti i vrasies së policit në Babimofc

Sipas një raporti informues të SHPK-së, më 3 janar 2007 rreth orës 01:20 në rrugën magjistrale Prishtinë-Mitrovicë, në afërsi të fshatit Babimofc, është qëlluar me armë zjarri polici i SHPK-së, Avni Kasumi nga komuna e Vushtrrisë. Rasti ka ndodhur derisa viktima bashkë me dy kolegë të tij, ishte duke u kthyer nga detyra dhe në Prishtinë afër Stacionit të Autobusëve, te ura, kanë hipur në një veturë private, që ishte drejtuar nga një person civil nga fshati Dumnicë e Vushtrrisë.

Përderisa vetura ishte në lëvizje te fshati Babimofc, në rrethana të panjohura është qëlluar me një plumb, që goditi policin e SHPK-së. Avni Kasumin që vdiq.

Ai është qëlluar në kokë mbrapa në anën e djathtë, ndërsa vetura është qëlluar në xhamin e derës së prapme, në anën e djathtë.

- Për këtë rast janë marrë veprimet e domosdoshme, përfshirë këtu edhe konfiskimin e veturës dhe bastisjet e 17 shtëpive në fshatin me serb Babimovc, ku është konfiskuar një sasi e konsiderueshme e armatimit dhe municionit.
- Deri më tash janë intervistuar 22 persona, në cilësinë e dëshmitarit. Hetuesit deri më tash kanë pranuar informata të shumta intelegjente dhe janë duke i verifikuar ato. Për momentin ende nuk kemi të dyshuarin e mundshëm.

2.4.3. Masat për përmirësimin e situatës së sigurisë në regjionin e Pejës

Siç jeni të njoftuar, pra në përgjithësi, situata në Pejë prej përfundimit të luftës ka qenë e përcjellë me incidente të ndryshme. Megjithatë, vrasjet në stacionin policor në Pejë (brenda dhe afër tij) që kanë ndodhur gjatë vitit 2006, kanë zgjuar indinjatën e qytetarëve dhe kanë luhatur besimin e tyre në funksionimin e SHPK-së në Pejë. Për këtë arsye kreu i Policisë së UNMIK-ut dhe udhëheqësit e SHPK-së kanë cilësuar se është krijuar nevoja për ndryshime kadrovike në lidhshimin e Komandës Regjionale të Pejës, me qëllim të një organizimi më efikas atje, i cili me gjasë do të ndikojë edhe në kthimin e besimit të qytetarët.

Sipas pohimeve të SHPK-së këto masa për përmirësimin e situatës së sigurisë në regjionin e Pejës janë duke dhënë rezultate fillestare. Në këtë kuadër, vërehet një klimë më e favorshme e punës përbrenda SHPK-së dhe vlerësohet se kjo do të reflektojë në ngritjen e efikasitetit të punës së SHPK-së në atë regjion, si dhe në nivel më të lartë të bashkëpunimit midis qytetarëve dhe SHPK-së.

Në përgjithësi, aktualisht janë rritur masat shtesë të sigurisë në të gjitha rajonet, me theks të veçantë në vendbanimet minoritare, vendbanimet e personaliteteve etj, duke shtuar prezencën policore në pikat më të frekuentuara, në pikat e kontrollit ,në trafik dhe patrullimin e shpeshtuar në disa rajone.

Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme mbështesin SHPK-në në hetimet e mëtejshme të intensifikuara dhe profesionale, për këto dhe për raste tjera, të cilat paraqesin provokim ose sfidë për sigurinë e përgjithshme në Kosovë. MPB-ja është në bashkëpunim të vazhdueshëm dhe më të mirë me mekanizmat e sigurisë në këtë fazë.

2.5 Mundësia e shprehjes së pakënaqësisë nga ana e qytetarëve varësisht prej dinamikës së procesit të statusit

Shtyrja e mëhershme e publikimit të propozimit mbi statusin e Kosovës është përcjellë me pakënaqësi të qytetarëve të vendit. Qytetarët e Kosovës kanë pritur që publikimi i këtij propozimi të bëhet në fund të vitit të kaluar, ndërsa sipas informacioneve të deritashme, vonesa e publikimit të propozimit ka rritur pakënaqësinë e qytetarëve të vendit, sikurse edhe ka rritur dilemat e tyre në procesin e gjithmbarshëm që kanë të bëjnë me statusin.

Sfidë shtesë paraqesin edhe deklaratimet e liderëve lokalë serbë në Kosovë, si dhe pretendimet dhe ndërhyrjet e autoriteteve të Serbisë në lidhje me zhvillimet në Kosovë.

Bazuar në aktivitetet dhe veprimet e shfaqura në forma protestash, duke përfshirë edhe veprimet e dhunshme, gjatë protestave të organizuara nga "Vetëvendosja", konsiderojmë se veprimet dhe format e tilla mund të paraqesin sfidë dhe provokim për rendin dhe qetësinë në Kosovë. Një raport analitik lidhur me protestat e tilla i është dërguar Kryesisë së Kuvendit, më herët nga Ministria e Punëve të Brendshme.

2.6 Gjendja e vështirë ekonomike dhe sociale e disa kategorive në shoqëri

Gjendja e vështirësuar ekonomiko-sociale, që është evidente në Kosovë, sidomos te disa kategori të caktuara shoqërore si pensionistët, invalidët e luftës, të rinjtë jashtë sistemit arsimor (pa perspektivë punësimi), familjet me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale, familjet e të zhdukurve dhe kategoritë tjera, paraqesin rrezik permanent për situatën e sigurisë në shkallë lokale apo më gjerë.

2.7 Krimi i organizuar

Për dallim nga krimet e kategorive të tjera të përgjithshme të cilat kanë shënuar rënie të dukshme nga viti në vit, veprimtaritë që bëjnë pjesë në krimin e organizuar kanë shënuar rritje të konsiderueshme, sidomos fenomenet negative, si trafikimi i drogës, i qenieve njerëzore, prostitucion etj. Rasti i fundit i përdorimit të Kosovës si transit për transportimin e një sasive të konsiderueshme të drogës, është një lëshim i cili nuk duhet të përsëritet më.

Vlen të ceket se është themeluar më parë një njësi e SHPK-së, e cila merret me luftimin e këtyre fenomeneve, por kompetencat në këtë lëmi të hetimeve të krimit mbeten tek Policia e UNMIK-ut dhe transferi gradual të SHPK-ja.

2.8 Esktrimizmi fetar (islamik) është rrezik për shoqëri demokratike

Në Kosovë liria fetare është e garantuar si dhe tradicionalisht kultivohen tolerancë e madhe dhe mirëkuptim në mes religjioneve të ndryshme, ati islamik, katolik dhe ortodoks.

Në bazë të një raporti analitik të SHPK-së lidhur me ekstremizmin islamik në Kosovë, del se: Lëvizja WAHABBI, pra organizatë me ideologji ekstremiste islame në Kosovë, ka filluar të përhapet në përmasa më të vogla menjëherë pas përfundimit të luftës, ndërsa metodologjia të cilën e kanë aplikuar në Kosovë ka qenë përmes organizatave të ndryshme humanitare dhe joqeveritare, kinse duke i ndihmuar popullatës civile, ndërsa qëllimi i tyre kryesor ka qenë përhapja e ideve. Aktualisht vlerësohet se aktivitetet e pjesëtarëve të WAHABBI-t në Kosovë janë në fazën e krijimit të infrastrukturës së tyre.

Që të ruhen liria dhe toleranca fetare në Kosovën demokratike ne duhet luftuar këtë dukuri dhe për ta luftuar këtë dukuri, por për të pasur në kontroll lëvizjet e

ndryshme të dyshimta, duhet të ketë një bashkëpunim dhe qasje të përbashkët të institucioneve të Kosovës, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe SHPK-së, ndërsa kjo e fundit duhet të bashkëpunojë edhe me shërbimet dhe agjensionet e tjera policore të vendeve fqinje.

Për luftimin e elementeve ekstremiste fetare në Kosovë është i nevojshme krijimi i një grupi punues të përbërë nga pjesëtarë të institucioneve të ndryshme. Ministria e Punëve të Brendshme është në fazën fillestare të krijimit të grupit punues për luftimin e elementeve ekstremiste fetare në Kosovë.

2.9 Transferimi i kompetencave

Lidhur me transferin e kompetencave për mandatin politik që e ka Ministria e Punëve të Brendshme dhe në kuadër të kësaj faze, do t'i bëjmë të gjitha përgatitjet, ngritjen e kapacitetit në marrjen e kompetencave në fazat e planifikuara.

Vlen të theksohet se themelimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme gjen bazën juridike në implementimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/53, apo të ashtuquajturit 'transferim të hershëm të kompetencave'.

Në ndërkohë, si rezultat i punës së MPB-së dhe rrjedhimisht të vlerësimeve korrekte dhe të gjithmbarshme është bërë i ashtuquajturit 'transferim i vonshëm i kompetencave' me hyrjen në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/26, në shtojcën XVI. NW e rëndësisë në veçanti se me këtë fillon bartja e kompetencave në drejtim të SHPK-së: 'MPB mbikëqyr Shërbimin Policor të Kosovës, me autorizimin e PSSP-së, duke vepruar përmes komisarit të policisë dhe pa ndërhyrë në veprimet e Shërbimit Policor të Kosovës dhe në zbatimin e hetimeve penale'. Pra edhe pse mund të vërehet qartë se autorizimet ndaj SHPK-s kanë qenë shumë të kufizuara, prej themelimit të MPB-së e edhe me tutje, është krijuar një perceptim jo i saktë në opinion lidhur me përgjegjësitë e MPB-së dhe me autorizimet ndaj mekanizmave për sigurinë e brendshme në Kosovë. Sidoqoftë, MPB-ja është përkushtuar që të ndërtojë raporte të mirëfillta profesionale me SHPK-në, të mbështesë organizimin dhe ristrukturimin e planifikuar, të ndërtojë dhe të ngritë kapacitete profesionale në departamentet e themeluara dhe në ato të transferuara nga MSHP-ja, të krijojë kushtet dhe hapësirat për punë dhe të hartojë infrastrukturën ligjore në mënyrë që të përgatitet për marrjen e kompetencave në faza të ndryshme.

Për më tepër, një ndër çështjet më strategjike të MPB-së mbeten aktivitetet e ndërmarra që pritet të kulmojnë me kalimin e mëtutjeshëm të kompetencave të sektorit të sigurisë në MPB. Në planin tekniko-politik kjo mbetet të realizohet përmes takimeve të vazhdueshme me Misionin Planifikues të BE-së për Polici dhe Drejtësi dhe të Grupit Punues për Tranzicion - Sundimi i Ligjit. Por, gjatë këtij procesi insistohet që parimi bazë për këtë transferim të jetë në përputhshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/54, neni 2 që thotë se, pas bartjes së përgjegjësive në fushën e policisë, përgjegjësinë për funksionimin e SHPK-së, që aktualisht i nënshtrohet autorizimit të PSSP-së, do ta marrë MPB-ja.

3 . Masat për ruajtjen e gjendjes së sigurisë

3.1. Masat aktuale

Duke u bazuar në të gjitha sfidat dhe kërcënimet e lartpërmendura, SHPK-ja ka hartuar një "Plan operativ të detajuar", i cili është në implementim e sipër. Në kuadër të kësaj, vlen të përmendet se policia ka rritur numrin e policëve në pjesën Veriore të Kosovës. Policia e UNMIK-ut ka rritur numrin e pjesëtarëve të saj në 500, ndërsa SHPK-ja në 300. Sa i përket KFOR-it, ata disa herë kanë deklaruar publikisht se kanë ndërmarrë masa shtesë adekuate në pjesën Veriore të Kosovës.

Po ashtu, në vitin 2006 janë trajnuar 1200 policë për ballafaqimin me situatat e mundshme të trazirave. Ata janë të shpërndarë në të gjitha regjionet e Kosovës, të cilët mund të rigrupohen dhe të përqendrohen shpejt që të intervenojnë për të mbajtur nën kontroll masat e qytetarëve në rast demonstrate masive.

Sipas planit operativ dhe me qëllim të parandalimit të veprimeve kriminale, është bërë shtimi i masave dhe i veprimeve në mbrojtjen e jetës dhe në sigurinë e personave dhe të pasurisë së tyre, me theks të veçantë në vendet ku jetojnë minoritetet;

Masa shtesë në sigurimin dhe mbikëqyrjen e kufirit si dhe kontrollin e kalimit kufitar; sigurimit të personave dhe objekteve (sipërfaqeve) të caktuara; shtimi i masave operativo- taktike të policisë dhe KFOR-it në kontrollin e mjeteve, objekteve dhe të personave me qëllim të zbulimit të mjeteve dhe veprimeve diverzante dhe terroriste;

si dhe mbledhja e e të dhënave për persona e grupe që merren me këto veprimtari.

Po ashtu kontrollimi dhe menaxhimi i kufijve është dhe mbetet njëra prej preokupimeve më të mëdha të MPB-së. Në këtë rast dhe në këtë aspekt, në bashkëpunim me donatorët, është hartuar Strategjia e menaxhimit të integruar të kufijve, që pritet të fillojë të implementohet në vitin 2007. Konceptet bazike të kësaj strategjie bazohen në praktikën më të mira për kontrollimin efikas të kufijve të Bashkimit Evropian dhe konkretisht në bashkëpunimin dhe në bashkëveprimin më të ngushtë të faktorëve relevantë si Doganat, Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-së, në mënyrë që të mos përsëriten lëshime të ngjashme sikur në rastin e mëhershëm të përdorimit të Kosovës si tranzicion për trafikun e drogës. Kjo strategji pritet të ndikojë në ngritjen e bashkëpunimit më të mirë të shërbimeve që merren me menaxhim të kufijve të regjionit e më gjerë.

3.2. Masat e planifikuara

Në bazë të raporteve dhe të informatave të pranuar në MPB nga mekanizmat relevantë të sigurisë, siç janë KFOR-i, Policia e UNMIK-ut, SHPK-ja, këta mekanizma të sigurisë kanë përpiluar plane me qëllim të koordinimit të aktiviteteve dhe të veprimeve të tyre në pajtueshmëri me vlerësimin e gjendjes së tanishme të sigurisë, por edhe zhvillimeve eventuale të mundshme. Për këtë plan sidomos është marrë parasysh ndikimi që mund të ketë publikimi i Pakos së Ahtisarit dhe rrjedhimisht proceset e mëtutjeshme lidhur me të, që mund të reflektohen edhe në siguri në nivelin e përgjithshëm.

Në veçanti Plani i veprimit strategjik për Mitrovicën - 2007", si synim bazik ka ruajtjen e tërësisë dhe pacenueshmërisë territoriale të Kosovës, si dhe funksionimin kompakt të SHPK-së në tërë Kosovën.

Në përfundim, siç u tha edhe më lartë në këtë raport, situata e përgjithshme e sigurisë në Kosovë është e qetë, stabile, por e ndjeshme. Por janë disa faktorë të cilët u përmendën, në ndjeshmërinë e kësaj situatë dhe si të tillë i kemi paraqitur në raport. Institucionet dhe mekanizmat e sigurisë kanë ndërmarrë dhe po ndërmarrin masat e nevojshme për të ruajtur stabilitetin e brendshëm të Kosovës, si dhe të garantojnë integritetin dhe sovranitetin e vendit.

Për këtë arsye, Shërbimi Policor i Kosovës, policia e UNMIK-ut dhe KFOR-it , ka ngritur nivelin e masave të sigurisë në tërë territorin e Kosovës, në mënyrë që të shprehin gatishmërinë e tyre për ballafaqim me të gjitha situatat eventuale që mund të ndodhin në Kosovë. Masat e tilla janë ndërmarrë në koordinim të plotë mes këtyre mekanizmave dhe institucioneve, ndërsa ato masa do të vazhdojnë në të njëjtin nivel derisa vlerësohet se janë të nevojshme për ruajtjen e stabilitetit në Kosovë.

Në bashkëpunim me faktorët e sigurisë në Kosovë do të bëhet vlerësimi periodik dhe sipas rasteve, i gjendjes së sigurisë me ndërmarrjen e masave operative, si dhe me njoftimin e institucioneve gjegjëse lidhur me këto veprime.

Mirëpresim vlerësimet dhe plotësimet nga debati në Parlament Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit zoti ministër, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ftoj shefin e Grupit Parlamentar, deputetin Alush Gashi

DEPUTETI, ALUSH GASHI – Ju faleminderit zoti kryesues, e mirëpresim raportin e ministrit dhe inkurajojmë hartim e raporteve periodike për gjendjen e sigurisë dhe ofrim të atyre të dhënave për Kuvendin, në mënyrë të rregullt, kërkojmë që të shqyrtohet mundësia e shpërndarjes së buletineve ditore për gjendje të sigurisë për deputetë. Për ne siguria dhe stabiliteti janë parakusht për zhvillimin e institucioneve demokratike dhe janë parakusht për zhvillim të tërësishëm të vendit tonë, andaj edhe domosdoja e funksionimit dhe e kosovarizimit të organeve të zbulimit dhe kundërzbulimit, si të pjesës civile dhe ushtarake është e domosdoshme, si mënyra më e mirë nëse jo edhe e vetmja e parandalimit të veprimeve joligjore në vendin tonë.

Mendojmë se zhvillimi i këtij sektori do të ndikonte në parandalim të trafikimit si edhe të zhvillimit të aktiviteteve të krimit të organizuar qoftë në pjesën tranzitore apo edhe të ndonjë aktiviteti vendor sikur ky sektor i sigurisë të jetë i kosovarizuar. Ne e kemi mbështet si grup dhe e mbështesim zhvillimin e këtij sektori , e mbështesim edhe debatin periodik për gjendje të sigurisë në Kuvendin e Kosovës.

I ftoj deputetët e grupit tonë të japin kontributin e tyre me diskutime individuale. Ju faleminderit zotëri kryesues!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit, të nderuar deputetë më lejoni që të kufizohem nga roli i kryesuesit, do të flas në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së për këtë pikë të rendit të ditës.

DEPUTETI, NAIM MALOKU – I nderuari zoti kryeministër, të nderuar ministra, deputetë të nderuar!

Grupi Parlamentar i AAK-së, mirëpret debatin e sotëm në temën, gjendja e sigurisë në Kosovë, njëkohësisht mirëpresim raportin e ministrit të Punëve të Brendshme, zotit Fatmir Rexhepi, ne përcjellim me vëmendje dhe me përkrahje të plotë hapat që i ka ndërmarrë Ministria e Punëve të Brendshme në ngritjen e infrastrukturës organizative të Ministrisë. Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka pasur ngecje në procesin e transferimit të kompetencave, siç e dini të nderuar deputetë, me emërimin e ministrit të Punëve të Brendshme ka filluar bartja ose transferi i kompetencave në formë të pakove tremujore, Ne e përkrahim Ministrinë dhe e vlerësojmë punën e saj në procesin e bartjes së këtyre kompetencave, pra me faktin se nuk ka pasur ngecje dhe në bartjen e këtyre kompetencave.

Me interesim të shtuar përcjellim zhvillimet pozitive në fqinjësi, Maqedoni dhe në Shqipëri, sukseset që këto shtete i kanë arritur në luftën kundër krimit të organizuar atje. Bashkëpunimi i Shërbimit Policor të Kosovës të nderuar deputetë, me policinë e Maqedonisë në lirim të afaristit kosovar vjeshtën e kaluar ne e përkrahim dhe mendojmë se ky duhet të jetë një shembull pozitiv mbi të cilin duhet ndërtohet dhe të intensifikohet edhe më tej bashkëpunimi i Shërbimit Policor të Kosovës, me policinë e Maqedonisë dhe të Shqipërisë në luftën e përbashkët kundër krimit të organizuar.

Zoti ministër, Grupi Parlamentar i AAK-së, ju inkurajon që në kompetencat që i keni dhe në mundësitë që i kenim, ta intensifikoni bashkëpunimin në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikeve në rajon. Konsiderojmë se dorëzimi dhe shkatërrimi i armëve në Shtuticë, ka qenë dhe është lajm i mirë për ne, njerëzit e përfshirë në këtë veprim joligjor, sipas ligjit trajtohen nga drejtësia. U bëjmë apel qytetarëve të Kosovës t'i dorëzojnë dhe të lajmërojnë armët ilegale. Ftoj qytetarët e Kosovës, në bashkëpunim me organet e rendit dhe të drejtësisë, në zbardhjen e krimeve të kryera, si dhe në parandalimin dhe pengimin e krimeve të mundshme- kryerjen e tyre në Kosovë.

Konsiderojmë se mbajtja e armëve të paligjshme nuk është e nevojshme për qytetarët e Kosovës. Rendin e sigurinë duhet ta mbajnë dhe të jenë përgjegjës organet e rendit e të sigurisë në Kosovë të cilat i mbështesim dhe jemi të inkurajuar me faktin se dita ditës janë në forcim dhe konsolidim të mëtejshme.

Të nderuar deputetë, duke ju ftuar në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, në debat konstruktiv, ju ftoj që t'i japim mbështetje raportit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit, në emër të Grupit Parlamentar ORA, deputeti Ylber Hysa.

DEPUTETI, YLBER HYSA - Më falni që po përdor kartelë tjetër, ju faleminderit. Së pari më lejoni t'ju përshëndes dhe t'ju them që në emër të ORA-s, ne përshëndetim këtë iniciativë edhe kërkesën për të pasur debat edhe përgjigjen e ministrit të ri me një raport, konsiderojmë që kjo është shumë e rëndësishme si një pjesë e një kulture të re politike të cilën duhet ta vendosim edhe në kuadër të mbikëqyrjeve institucionale të një ministrie kaq me rëndësi së cilës presim t'i barten kompetencat.

Në këtë aspekt kjo është një gjë e mirë dhe do ta përshëndesim në të ardhmen. Konsiderojmë që raporti ka qenë mirë ta përcjellë edhe një varg statistikash të cilat janë pranë kësaj Ministrie, të cilat në fakt janë të deponuara në SHPK, në mënyrë që do të ilustronin qasjen e cila është sjellë këtu në raport, e cila nganjëherë duket që ka vënë thekse më të, me ngjyrë më shumë aty ku praktikisht nuk ka kompetenca, ndërkohë që aty ku ka kompetenca ka dhënë shpjegime më të holla, siç është konkretisht me disa pika shumë të ndjeshme, me pikën 2.7, rreth krimit të organizuar ku do të mund të pritej më shumë informatë Sa i përket pikës 2.8, që është ekstremizmi islamik ku realisht kjo ministri nuk ka shumë kompetenca i ka dhënë vetes të drejtë të bëjë kualifikime të cilat, marrë parasysh se ky dokument realisht është zyrtar, do të duhej të kihej shumë kujdes, sepse ky dokument është i citueshëm edhe në institucione sikur ato dje të Këshillit të Evropës.

Konsiderojmë se një raport i tillë para se të vijë në një seancë të tillë, do të duhej të respektonte komisionet përkatëse, në mënyrë që të filtrohej dhe në bazë të një debati pak më të thuktë, të bëheshin edhe imputet, të cilat besoj vetëm se do t'i ndihmonin ministrit dhe kësaj ministrie. Është sugjerim yni që herën tjetër këto të kihen parasysh, në mënyrë që aty të diskutohen edhe shumë aspekte të tjera të cilat do të mund të diskutonim në mënyrë shumë më të saktë edhe rreth disa kualifikimeve për veprimin e institucioneve paralele, e pse jo edhe për veprimin e këtyre strukturave në Veri. Konsiderojmë që Mitrovicës është dashur t'i kushtohet një rëndësi relevante sidomos nuk do të ishte e tepërt sikur Ministria normalisht në kuadër të kompetencave që ka, ta bënte edhe një lloj parashikimi për fazën dhe dinamikën e cila vjen sidomos pasi që është theksuar në fillim të raportit, që na pret një sfidë e konsiderueshme, për faktin se po hyjmë në definimin e statusit final.

Janë këto disa vërejtje, me rezervat tjera të cilat do t'i kishim thënë në mënyrë më të drejtpërdrejtë, posa të na jepet rasti në komision. Shfrytëzoj rastin që këtu të thërras një dëgjim në Komisionin tonë për Siguri ku të gjitha këto vërejtje do të mund t'i shqyrtojmë në mënyrë pak më të elaboruar. Ju faleminderit!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Ramë Buja, përgatitet deputeti Emin Krasniqi.

DEPUTETI, RAMË BUJA- Të nderuar kolegë deputetë, i nderuar zoti kryesues, pika për cilën po debatojmë është një pikë shumë problemore dhe çështje kulmore, secili qytet në

rajon dhe në botë dhe te ne gjithsesi, por ne sikur nuk i qasemi as seriozisht sa meriton kjo pikë, asnjëherë, por për as sa kemi qasje serioze për aq është edhe situata.

Raporti i ministrit është për t'u përshëndetur, duke pasur parasysh kohën prej kur ka marrë detyrën, për kompetencat që ka dhe përgjegjësitë që mund t'i vihen në barrë, e respektojmë raportin si të tillë, por megjithatë është tautologji e dobët e informacioneve që kemi marrë në mjete të informimit edhe të shkruara edhe tonike, edhe vizuale, por megjithatë mund të themi se si nismë për të raportuar këtë formë është e mirë. Çështjet që përmenden në raport, i quajtur raport, janë çështje për të cilat do të duhej një qasje për të dhe rreth tyre të jetë me serioze. Ato që përmenden janë tepër përciptazi, atë që përmendi kolegu im, Ylber Hysaj për pikën e 8. është diçka që për mua fletë shumë, e që nuk është thënë asgjë, sepse thuhet se kanë ardhur elementet e tilla të dyshimta përmes organizatave humanitare, që 7 vite në Kosovë, gjersa janë në fazën e nismës së veprimit të tyre, ose të organizimit fillestar, janë shumë me rezervë. Flitet për një plan të detajuar për veprimet që eventualisht mund të pasojnë në Kosovë dhe përmend vetëm një shifër 500 dhe 300 të dështuar, por nuk përendët një gjë që për mua është tepër domethënëse, shumë ndikuese, çështja e lëvizjes së papenguar të asaj sasive marramendëse shumë të drogës nëpër Kosovë, që unë e kam quajtur dhe po vazhdoj ta quaj parodi policeske në Kosovë.

E përcjell gjatë tërë territorit dhe e dhuruar për policinë maqedonase, që ata të marrin një mirënjohje nga kudo qoftë dhe për çka do qoftë. Kjo ishte për mua shumë domethënëse, me kuptimin më negativ të fjalës.

Jam mbështetës i asaj që dikush e tha para meje se do të duhej insistuar edhe nga Ministria, në fjalë që kompetencat të barten më shumë tek policia vendore, te SHPK-ja, sepse jemi dëshmitarë të gjithë se çfarë ishte roli i SHPK-së në 2004, se si u fyen e u poshtuan dhe u denigruan SHPK-ja dhe nuk u la të luajë rolin që kishte dhe që mund ta bënte shumë më efektiv dhe unë u them miqve dhe dashamirësve tanë ndërkombëtarë, që kanë ardhur këtu edhe 101 vjet mund të rrinë në Kosovë dhe po nuk ju dhanë kompetencat meritore SHPK-së dhe institucioneve vendore, mund të jenë kështu të pasuksesshëm siç ishin gjer më sot. 1000 vrasje janë në Kosovë ju lutem, ne flasim për stabilitet, për qetësi, për siguri në Kosovë, 1000 vrasje të pazbuluara në Kosovë. Kjo është më shumë se qesharake dhe më shumë se sa irituese. Andaj unë kisha bërë thirrje për ministrin dhe Ministrinë që të insistojnë me çdo kusht që kompetencat të barten dhe atëherë të kërkohen përgjegjësitë.

Vazhdimisht që vite të tëra janë kërkua përgjegjësi, por kompetencat nuk kanë qenë askund. E dimë bashkë, ju e dinë më mirë ,sepse jeni personalisht duke u marrë me te, por çështjet mund të vijnë në vend nëse kompetencat barten te vendorët dhe përgjegjësitë gjithashtu dhe pastaj kërkohet edhe llogaria. Këto punë po them unë nuk di se si mund të shkohet kështu. Ju faleminderit!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit, deputeti Emin Krasniqi, e ka fjalën, të përgatitet deputeti Sokol Bashota

DEPUTETI, EMIN KASNIQI – Të nderuar pjesëmarrës, i nderuar zoti kryesues dhe njëherit kryetar i Komisionit për Siguri, përshëndetje për kryeministrin, 5 ministrat të gjithë deputetët e deputetët, pjesëmarrës në këtë seancë dhe të gjithë ata që kanë mundësinë dhe janë pranë për të na përcjellë.

Fillimisht shtroj, duke pasur parasysh ndihmesën e të gjitha strukturave reprezentuese, institucionale e politike e të subjektëve politike në Kosovë, ne jemi ditë e më afër aderimit tonë, që edhe në sferën e sigurisë të bëhemi një segment i segmentit rajonal të sigurisë. Por kushtimisht e them nga të gjithë ne këtu dhe nga pjesa më e madhe e qytetarëve dëgjohet paraqitja ka informacione, ka informata se etj. sigurisht se ky jomenaxhim dhe kjo mungesë e plotë e koordinimit të aktiviteteve dhe e angazhimeve tona bën që ne të kemi një degëzim total të vjeljes edhe të distribuimit të informatave që secili prej nesh thotë: kam informata, kam informacion se, etj.

Përshëndetje edhe për ministrin dhe për mënyrën e komunikimit, por përkitazi me raportit dhe me aspektet e përfshira në raportin e ministrit të Punëve të Brendshme, unë paraqes këto vërejtje:

Në pikën 2,2. paragrafi 2. zoti ministër në fjalën tuaj kualifikuese se ka organizata si SHIK-u si SIA etj. vërejtja e parë është se, ju është dashur jo të kontaktoni, po të komunikoni dhe që këtë aspekt të këtij raporti t'ja kishit paraqitur shefit tuaj, kryeministrin të Qeverisë së Kosovës, zotit Agim Çeku, i cili edhe ai besoj se nuk do të ishte pajtuar me këtë kualifikim shumë kuturu dhe tejet të pabazë. Nëse mund të krahasohen strukturat paralele të inteligjencës është dashur atëherë krahas Shërbimit Informativ të Kosovës, që drejtohet nga zoti Kadri Veseli, si strukturë paralele e inteligjencës të ishte Agjencia e Inteligjencës së Kosovës, që drejtohet nga zoti Avdi Behrani e jo me iks organizata ku unë kisha për të përmendur disa prej tyre, nja 7 – 8 që ekzistojnë vetëm në një informatë në internet si USH, UTESH, USH, FKBSH, etj. ndërsa po qe se ju keni pasur guximin dhe torruan të bëni këtë krahasim është dashur të thuani pak më drejtpërdrejtë, pra cila qenka kjo SIA..

Në pikën 2,2 2,4 në fjalën tuaj për shpërthimet në Gjilan e gjetiu, është dashur që në një aspekt të fjalës suaj dhe në raport të përfshihet, a ishin vërtetë këto shpërthime që drejtoheshin për destabilizimin dhe për të kërcënuar jetën e qytetarëve, apo kualifikim interesash klanore etj?

Në pikën 2.7 një ndër rekomandimet e ministrit që në emër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, t'i sugjerojë KFOR-it etj., ne e dimë të gjithë paralajmërimi është shumë i rëndë, por duke qenë se gjetja a posedimi i një numri mbi 400 mijë armë, në duar të qytetarëve shqiptarë të Kosovës, paraqet një sfidë, një kërcënim shumë serioz, jo vetëm për KFOR-in që i është drejtuar ky, po për të gjitha institucionet dhe veprimtarët edhe subjektet e tjera politike, jo të jetë një paralajmërim që na përkujton kohët e moçme, i Ministrisë së Punëve të Brendshme, dikur që u drejtohet federatave etj. për një paralajmërim, për mbledhjen e armëve etj.

Në vërejtjet e tjera kam edhe ekstremizmin islamik. Unë dua vetëm t'i përkujtoj se lëvizja WHABBI është doktrinë filozofike, apolitike dhe sunduese në Arabinë Saudite. Kur të kihen parasysh levat e koordinimit dhe subordinimit të asaj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kontributi duke dalluar kontributin e asaj të angazhimeve edhe në këtë rajon, atëherë ky është një kualifikim, a një sintagmë shumë e rëndë që nuk përkon as me objektivat e Ministrisë, as me objektivat e institucioneve tona dhe as me vetë angazhimet tona. Për të mos e zgjatur më tepër, ndër prioritetet për të tejkaluar këtë, nisma e mbarë që ka filluar në kuadër të Komisionit Parlamentar për Siguri, që është njëri ndër objektivat kryesorë edhe paralajmërimi për ofrimin e ligjit, a projektligjit për agjencinë e inteligjencës së Kosovës, do të jetë një levë, një kohë koordinues që tejkalon apo mbulon kompetencat edhe përgjegjësitë e Ministrisë dhe të ministrit të Punëve të Brendshme, për tejkalimin e disa aspekteve të sigurisë.

2. Gjersa në kuadër ose në kontekst të objektivave të sigurisë rajonale nuk i qasemi si institucione dhe si subjekte hartimit të ligjit për ligjërinë, apo ligji i sigurisë së Kosovës, që është edhe njëri ndër objektivat kryesorë të BE-së, edhe të NATO-s, ne nuk mund të thirremi në një siguri dhe stabilitet, që për çdo ditë me vetë sjelljen dhe paraqitjen tonë, riprodhojmë josiguri. Ju faleminderit!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit, deputeti Sokol Bashota, e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Emrush Xhemajli

DEPUTETI, SOKOL BASHOTA - Ju faleminderit zoti kryesues, të nderuar deputetë, zoti ministër më vjen keq por, edhe ky raport sikur ai i mëhershmi, vërtet është një raport amator. Raportin e kaluar kam dhënë vërejtje, por siç duket ju nuk dëshironi të bashkëpunoni me profesionist, por dhe si i tillë, nuk mund t'u shpërndahet deputetëve vetëm një ditë para seancës. Ky raport ka shumë mangësi, s'ka fare apo shumë pak ide për zgjidhjen e problemeve të cekura. Pra është një raport i njëanshëm. Unë dua t'i potencoj disa çështje:

Në paragrafin 2. ju potenconi se, strukturat paralele monitorohen nga SHPK-ja, por për ndonjë veprim konkret ia hidhni topin e fajit UNMIK-ut. Kjo zoti ministër, nuk ju justifikon Juve as stafin tuaj. Në të njëjtin paragraf bëni një krahasim dhe një paragjykim jo të ndershëm dhe aspak profesional, kur thuani se, SHIK-u, është organizatë ekstremiste dhe kështu e futni në një thes, me organizatat e tjera. SHIK-u zotëri ministër, është formuar gjatë luftës, të cilin e ka krijuar Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, ka vepruar edhe pas luftës dhe vepron legalisht edhe sot dhe njihet botërisht veprimtaria e tij. Zyrtarisht me SHIK-un komunikojnë edhe institucionet më të larta të vendit, siç është edhe kryeministri i Kosovës. Kjo tregon zoti ministër, se Ju, nuk keni **denjuar** të bashkëpunoni as me SHPK-në, e as me Komisionin për Siguri, i cili parasheh përfshirjen e SHIK-ut në krijimin e Shërbimit Inteligjent të Kosovës.

Në paragrafin 2.8, folni për ekstremizmin islamik, zoti ministër, vërtet a ka ekstremizëm islamik në Kosovë?. Ju raportuat për një lëvizje të quajtur WAHABBI, e kuptoj se këtë emër mund ta keni marrë apo mund të jeni shërbyer nga "Veqernje Novosti", por është dashur të na thuani se çka është WEHABBI-zmi? Është dashur të bashkëpunonit më

shumë, po e potencoj edhe një herë, me struktura të SHPK-së, të cilat janë kompetente, dhe të mësoni për rrymën fetare **selefizmin** dhe **ifanizmin** të cilat vërtet do të jenë sfida për Kosovën nesër, të cilat në raport nuk i keni potencuar. Në raportin e mëhershëm dhe në këtë sot, folni për dukurinë e drogës. Na atë kohë ju kam thënë se, mos çuditeni se do ta gjeni nëpër raftet e barnatoreve. Ndërsa sot, mëse 400 kg. Zoti ministër transportohen para hundëve tuaja, e sa e sa të tjera që nuk dihen. Sulmet e mëhershme që kanë ndodhur si në Gjilan, Ferizaj, nuk kemi ende një raport, se sa janë zbuluar dhe çfarë motivi kanë pasur, ndërsa sulmi ndaj jush zoti ministër vërtet ishte krim i organizuar apo konflikt personal interesash. Ju zëni veprimin e maskave dhe folni për rajonin e Drenicës, do me thënë e spastroni veprimin e maskave në Drenicë, në një vend ku vërtet është vendi më i qetë në rajon. Z. ministër unë e kuptoj se posti i ministrit është post politik, por raportin për sigurinë pse e keni bërë raport politik dhe kur ministri i Punëve të Brendshme e politizon sigurinë në Kosovë, nuk e di se për çfarë sigurie mund të flasim ne pastaj. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, kurse le të përgatitet deputeti Xhevat Bislimi

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Përshëndetje, z. kryesues, të nderuar deputetë, z. kryeministër dhe ju monitorues të Kuvendit ju përshëndes të gjithëve.

E përgëzoj ministrin e Punëve të Brendshme për përparimin që ka bërë në fushën e raportimit në krahasim me raportin e mëparshëm i cili për mendimin tonë ka qenë krejt formal. Mirëpo edhe raporti i tashëm në krahasim me atë se si duhet të jetë një raport i punëve të brendshme mbetet për t'u dëshiruar, po e lëmë dhe po mendojmë se kjo ka ndodhur për shkak të kompetencave, mirëpo qysh në fillim po them gjatë përkthimit të atyre pjesëve anglisht, besoj se e dimë të gjithë **se dabëllve** nuk është në alfabetin shqip, d.m.th me pas kujdes në ato pjesë së ju vijnë të gatshme vetëm të përkthyer me pa se a janë përkthyer mirë. Kontrolloni tekstin dhe e kuptoni atë që po them. Unë si përfaqësues i një subjekti opozitar do ta kem një qasje pak më ndryshe nga pozita dhe subjektet që janë në opionencë. Edhe më herët ju keni thënë se strukturat paralele të sigurisë të dirigjuara nga Serbia i keni në vëzhgim, i monitoroni, po dihet se monitorues është OSBE-ja., janë tjerët, ju jeni ekzekutivi. Pse nuk keni qenë aspak konkret sa u përket forcave ushtarake e policore vullnetare serbe që veprojnë në Kosovë edhe kur i keni ditë detajisht disa detaje që i keni prezantuar këtu nuk keni dhënë disa detaje sa u përket forcave serbe, ku janë ato, cilat janë qendrat e vendqëndrimeve dhe vendkomandimeve dhe cila është lidhshmëria e tyre me qendrat e ushtrisë dhe policisë serbe brenda Serbisë? Pse e fshihni faktin se aktiviteti dhe lidhshmëria e tyre organizohen nëpër objekte fetare, ortodokse dhe objekte të tjera laike të destinuar për qëllime civile. Pse cekni vetëm emra të shqiptarëve të organizimeve dhe nuk i cekni fare me emër organizatat si “Odred i çetnikëve”, “Organizata serbe” për gjoja çlirimin e Kosovës” etj, etj dhe aktivitetin e tyre dhe i përmend SHIK-un, SIE-n e çka po di unë në Kosovë, struktura për të cilat u tha mirë këtu, janë të njohura për të gjithë. Pse i fshihni faktet se në Kosovë veprojnë që besoj se e dini dhe thatë se jeni duke i monitoruar të brigadës 58 serbe të këmbëorisë me armatim të lehtë në rajonin e Leposaviçit, Zveçanti, Zubinpotokut dhe në Veri të Mitrovicës. Fakti se në një brigadë ushtarake e policore vullnetare të lehtë gjithashtu janë

të organizuar në fshatrat serbe të Gjilanit, të Kamenicës, Vitisë dhe Novobërdës. Se gjithashtu pasi jeni duke i përcjell e dini dhe nuk e thoni se në njësi ushtarake janë të organizuar edhe Ranilluku dhe Shtërpca. Ndërsa fshihni faktin se në Graçanicë në fshatrat serbe të Prishtinës, Lipjanit dhe Fushë-Kosovës dhe Obiliqit vepron një njësi e batalionit të përforcuar. Ju e dini se atje po rrezohet largpërquesit dhe banorët po mbeten pa rrymë. A paraqesin rrezik për Kosovën dhe a do të thonë diçka për ju z. ministër lidhur me sigurinë në Kosovë emrat: Nastiç, Marković, Ivković, Iliç, Jokiç, Bellosheviç dhe lidhjet e disa të këtyre direkte me Koshtunicën dhe strukturat e tjera serbe në thellësi të Serbisë. Opinioni të shqetësuar për këto aktivitete , dihet mirë se ku synojnë këto struktura kriminale të orientuara kundër Kosovës. Ju jeni përgjigjur me improvizime bukur të pahijshme, se gjoja rreziku vjen jo nga armët dhe kriminelët që depërtojnë nga kufiri në Kosovë për mesin e saj në Drenicë. Në raport detajisht janë dhënë emrat , mbiemrat dhe rasti i Drenasit në orë 9,30 që ka të bëjë me disa armë të lëna të kohës së luftës të gjetura te ish -pjesëtarët e UÇK-së që njihen për juve për përkushtimin ndaj Kosovës, që e kanë mbrojtur dhe mund t'i dalin në mbrojtje prapë Kosovës, ndërsa kalimthi i kaloni strukturat e MUP-it të Serbisë dhe nuk përmend strukturat paralele serbe të Kosovës të lidhura me këto struktura në bashkëveprim me Serbinë. Këto struktura z. nuk merren me armë të vjetra, por me fjalën e fundit të teknikës, armë të reja të cilat depërtojnë vazhdimisht nga Serbia. Këtë e dini fare mirë se ju jeni duke i monitoruar këto. Mendoj se është koha e fundit kur Ministria e Brendshme ndjek politikë vetëakuzuese për Kosovën, se që na akuzojnë të tjerët e kuptojmë, por që ne ta akuzojmë vetëveten në fushën e sigurisë dhe këtë rol ta marrë pikërisht ministri i Punëve të Brendshme, kjo nuk është e pranueshme, edhe kur oponenca ndonjëherë sikur që e kërkoi këtë seancë dha vërejtje, nuk duhet të nisemi nga këto. Në raport flitet edhe për ekstremizmin fetar që u përmend këtu dhe unë inkurajoj ministrin e brendshëm për këtë qasje, kjo pjesë nuk është e plotë dhe për arsye se për ekstremizmin fetar islamik nuk flitet konkretisht, ndoshta mund të ketë çka të flitet, por në formë të përgjithësuar. E dyta kjo pjesë e raportit nuk është e plotë, krejt e njëanshme edhe për faktin se nuk është përfshirë aktiviteti shumë i njohur i ekstremizmit fetar ortodoks. A nuk jemi të gjithë dëshmitarë të aktivitetit politik të Kishës Ortodokse Serbe, gjithë veprimtarinë e saj e ka fokusuar në aktivitetin politik në atë që nuk është e thirrur në dobi të shtetit të Serbisë dhe kundër Kosovës, a nuk jemi dëshmitarë që kleriku serb Sava i ka harruar krejt punët e zotit dhe po merret hapur me politikë besa edhe me diplomaci kohëve të fundit ,duke lobuar deri në skajet më të largëta të globit për shtetin e Serbisë dhe kundër Kosovës. A e di UNMIK-u që e ka uzurpuar pjesën më të mirë të kompetencave në këtë fushë se Kosova me legjislacionin që ka insistuar shumë bukur edhe ai që të aprovohet vendi ynë është sekular, besimi është i ndarë nga punët e shtetit të shkollës dhe të institucioneve. Mos harroni zotëri se ky aktivitet u ka rënë në sy edhe forcave që quhen të moderuara në Serbi që për çdo ditë mund t'i lexoni dhe e kanë kritikuar veprimin e kishës së tyre dhe është për çudi si nuk i ka rënë në sy ministrit të Punëve të Brendshme. Nuk mund të pajtohemi me atë që thuhet në faqen 7 të raportit. Shprehja e pakënaqësisë së qytetarëve përmes protestave demokratike, siç ishin ato të vitit të kaluar, nuk është aspak e vërtetë dhe askund në botë që e sfidojnë dhe e provokojnë sigurinë në Kosovë, përkundrazi çdo kund në botë konsiderohen ventilime që i shërbejnë sigurisë. Protestat e saj ,që po i organizon lëvizja “Vetëvendosje”, besa edhe me neve që jemi në Kuvend këtu, andaj kjo pjesë e raportit më tepër do t'i shkonte ndonjë raportit të kohës së kaluar të viteve 80-të,

kur protestat demokratike konsideroheshin kercnim për sigurinë, ndërsa nga raporti i tashëm kjo pjesë duhet të hiqet ose të mos përsëritet ma se me të vërtetë nuk ka kuptim. Burimi i këtyre protestave, ju e dini mirë se nuk ka qenë planifikimi kriminal, por rrjedhim i veprimtarisë së Grupit Negociator që tashmë mund të quhet edhe grupi uzurpator që nuk pyet ma për vendin e as për Kuvendin. Ky grup është duke e provokuar situatën dhe revolta e qytetarëve ka qenë plotësisht e ligjshme. Ju faleminderit, me mendimin ma të mirë që të kontribuojmë që gjendja e sigurisë në vend të jetë ashtu si duhet.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputet, fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi, kurse le të përgatitet deputeti Sabit Rrahmani.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI - Faleminderit z. kryesues. Z. kryeministër, ju ministra. Unë nuk jam specialist i kësaj fushe, por si anëtar i Komisionit për Siguri, po mundohem të jap kontributin tim për këtë debat, për këtë çështje themeltare për një vend dhe kam veçuar 2-3 çështje që mendoj se janë më të ndjeshme. Si qytetar, por edhe si deputet ,më bëri përshtypje fakti që theksi i rrezikshmërisë, i kërcënimit ,vendoset te SHIK-u që të gjithë shqiptarët e dinë rolin e tij për organizimin e luftës, për mbarëvajtjen e luftës, fitoren e luftës. Te disa organizata të tjera që nuk e di a janë të rëndësishme apo të parëndësishme, por pothuajse kalimthi kalohet veprimtaria shumë e organizuar, shumë e fuqishme e MUP-it dhe e shërbimeve të tjera sekrete serbe në Kosovë. Z. të nderuar z. ministër, nuk po them ndonjë gjë të re por kërcënim për lirinë dhe sigurinë e Kosovës përbën Serbia dhe askush tjetër dhe jo as pakica serbe në Kosovë, absolutisht nuk paraqet ndonjë kërcënim, kërcënimi është Serbia e cila ka instrumentalizuar pakicën serbe në Kosovë, po e armatos, po e organizon për hesapet e veta që i dimë të gjithë. Nuk është folur fare për administratën, veprimin e administratës serbe në Kosovë, pastaj është veçuar çështja e armëve te shqiptarët në Kosovë. Unë z. ministër mendoj që Qeveria, partitë politike, institucionet e Kosovës janë të thirrura, janë të ndërtuara që të luftojnë shkaqet e jo të merren vetëm me pasoja, sepse armët te shqiptarët nuk mbahen për pikën e qefit, vetëm që i ka shkrepe dikujt që ta mbajë armën, por është një tregues edhe 8 vjet pas lufte se shqiptari nuk ndihet i lirë në vendin e tij. Shqiptari nuk ndihet i sigurtë në vendin e tij dhe kjo gjendje është shumë reale. Derisa Serbia kërcënon për çdo ditë me invazion dhe pjesërisht është futur edhe brenda Kosovës, derisa Serbia ndërhyr për çdo ditë në çështjet e brendshme të Kosovës, derisa Serbia organizon organizata të ndryshme të armatosura, formacione, shërbime sekrete, unë nuk mund të kuptoj se si dikush e sheh rrezikun te arma e shqiptarit. Shqiptari do të çarmatoset vetëm atëherë kur këto institucione do të krijojnë formacione të rregullta, të armatosura që do t'i dalin zot Kosovës, kufijve të saj, jetës së qytetarit, familjes shqiptare kudo në Kosovë, përndryshe ne rrahim ujë në havan zotëri, prandaj mendoj që Qeveria, të gjitha institucionet, politika e Kosovës, duhet të marrë kompetenca, jo të presë kompetenca, të marrë kompetenca se ne vdiqëm me këto budallallëqe qe 7-8 vjet, kërkojmë kompetenca, merrni zotëri kompetencat, votën për këtë punë e keni marrë që t'i garantoni liri qytetarit të Kosovës, pa dallim përkatësie kombëtare, por veçmas popullatës shqiptare e cila me të drejtë ndjehet e kërcënuar , sepse e ka provuar në lëkurën e saj, në jetën e saj me qindra mija viktima e ka paguar mungesën e armëve në Kosovë. Derisa Serbisë nuk i është marrë asnjë pushkë gjuetie, por është tërhequr edhe me pushkë të gjuetisë nga Kosova dhe

armatoset për çdo ditë me armë më moderne, koncentron armatim në kufijtë e Kosovës për çdo ditë, ne merremi me disa armë të ndryshkura që paskan mbetur prej luftës.

Po ndalemi pak te religjioni. Unë jam shumë në dakord me ata që thanë se religjioni kur keqpërdoret për qëllime të tjera politike – ideologjike vërtet përbën një kërcënim për sigurinë e vendit tonë dhe të çdo vendi tjetër, por është mirë z. ministër që fetë në Kosovë ta kenë të njëjtin trajtim, jo për dikë nënë e për dikë njerkë, jo fesë ortodokse serbe t'i garantohen të gjitha fushat , hapësirat e mundshme që të sigurojë dhe të luftojë edhe kundër interesave të Kosovës, të propagandojë, ta shfrytëzojë kishën për interesa të pastra politike dhe shoviniste, mund të them ,kurse në anën tjetër të vihet theksi vetëm te feja islame për të cilën edhe unë mendoj se duhet të vendoset brenda kornizës ligjore, të veprojë si çdo veprimtari politike, kulturore, ekonomike, shpirtërore brenda kornizës ligjore, qoftë edhe feja islame, ortodokse, katolike dhe mundësisht si çdo veprimtari tjetër edhe feja islame që është kryesisht e shqiptarëve ,ta marrë fytyrën e këtij vendi dhe të këtyre njerëzve.

Një pengesë tjetër që nuk po lejon të ndërtojmë siguri, rend dhe rregull unë e shoh edhe te sistemi i ndërtuar kryesisht mbi bazën e korrupsionit, të mitos, nepotizmit dhe shantazhit .Pra,edhe ky sistem është bërë pengesë që të ndërtohet rendi politik institucional, ekonomik, ligjor etj. Ju faleminderit dhe suksese më të mira në të ardhmen.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit, fjalën e ka Sabit Rrahmani, kurse le të përgatitet deputeti Fetah Berisha.

DEPUTETI SABIT RRAHMANI – Ju faleminderit z. kryesues, i nderuari z. kryeministër, të nderuar ministra të kabinetit qeveritar, të nderuar kolegë deputet dhe ju monitorues të Kuvendit.

Është për t'u vlerësuar kontributi i Ministrisë së Brendshme lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e rendit dhe të sigurisë, po ashtu është për t'u vlerësuar edhe kontributi i Ministrisë së Drejtësisë që të krijojë një rend dhe ligj të zbatueshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës. Meqenëse këto dy ministri janë formuar në kohën shumë të afërt, ka një vit, ndoshta është e pamundur që për një vit të evitohen të gjitha problemet që kanë ndodhur prej vitit 1999 deri në kohën kur këto dy ministri janë formuar, duke marrë parasysh se në Kosovë ka pasur shumë probleme deri në vitin 2006 kur këto dy ministri janë formuar dhe kompetencat e sigurisë, të rendit dhe të drejtësisë nuk janë kompetencë e institucioneve të Kosovës. Unë mendoj se rend dhe siguri në Kosovë mund të ketë kur të kuptohen tri gjëra, një nga shumica, një nga komunitetet joserbe dhe një nga vetë komuniteti serb, cilat janë ato: Shumica shqiptare njëherë e përgjithmonë duhet ta kuptojë se Kosova duhet të jetë demokratike, multietnike dhe se në të kanë vend të gjitha pakicat duke përfshirë edhe komunitetin serb në Kosovë. Komuniteti serb njëherë e përgjithmonë duhet ta kuptojë që sovraniteti serb mbi Kosovën ka përfunduar me luftë në vitin 1999, kurse pakicat joserbe duhet ta kuptojnë njëherë e përgjithmonë dhe t'i binden realitetit të ri të krijuar në Kosovën e pasluftës që Kosova është shtet i tyre dhe nuk ka shtet rezervë për ta. Nëse këto tri gjëra kuptohen në këto tri drejtime, atëherë unë mendoj që do të ketë rend dhe siguri të plotë në Kosovë.

Sa i përket raportit që ju z. ministër keni cekur sfidat dhe kërcënimet, përcaktimi i procesit të statusit final, kërcënimet nuk varen prej qytetarëve të Kosovës, kërcënimet varen nga bashkësia ndërkombëtare dhe kërcënimet varen nga vendimet dhe qëndrimet e

Grupit të Unitetit. Nëse nuk respektohet vullneti politik i qytetarëve të Kosovës dhe vullneti i shumicës shqiptare, me siguri që do të ketë kërcënime për destabilizim të situatës dhe për trazira, d.m.th ky është një shenj që duhet t'ua japim ashkësisë ndërkombëtare dhe Grupit të Unitetit që të mos luajnë me fatin e shumicës shqiptare, sepse nëse ndokush e ka merituar pavarësinë e Kosovës dihet që në këtë Kosovë është derdhur gjak, janë maltretuar, janë vrarë njerëzit dhe mënyra e vetme që të zhduken këto kërcënime është që Kosova dhe vullneti politik i qytetarëve të Kosovës të respektohet. Z. ministër për fat të keq nuk është ashtu siç thatë ju në fjalën tuaj që i kontrolloni strukturat paralele në Kosovë, nuk është e vërtetë dhe kjo nuk qëndron. Duke marrë parasysh që ju jeni të informuar shumë mirë me deklaratën e përfaqësuesit të listës serbe për Kosovën Oliver Ivanoviq, i cili para disa dite tha që në Veriun e Mitrovicës janë duke u përgatitur grupe paramilitare diku 1.500 anëtarë të këtyre grupeve dhe janë të gatshëm për çdo gjë, janë të armatosur, por nuk janë të kontrolluar prej askujt. Nëse kjo nuk është e vërtetë që ai e ka thënë, atëherë ju mohoni që nuk e ka thanë, plus asaj Qeveria e Kosovës dhe unë e quaj grupi i ëndrrave, grupin e unitetit i cili e ka marrë votën e këtij Kuvendi, por jo ky formacion që është tash, formacioni me kryetarin Rugova dhe formacioni me të tjerët që ka qenë se grupi i unitetit kurrë nuk ka dalë në votim, kur janë ndërruar përfaqësuesit e tjerë që unë mendoj se është shumë gabim, vetëm sa i ka ndihmuar strukturat paralele, duke u ndihmuar këto struktura i kanë dhënë sovranitet Serbisë në Kosovë. Mu për atë arsye se me dhënien e një numri të komunave në një pjesë të territorit të Kosovës, si arsyetim që ky është decentralizim, fakt që institucionet ia kanë marrë vetes të drejtën për me menaxhuar të gjithë territorin e Kosovës në një mënyrë apo në një formë i kanë dhënë hise Serbisë në Kosovë. Kjo është shumë e vërtetë, edhe kryeministri i atëhershëm, edhe kryeministri Çeku kanë thanë që decentralizimi nëse nuk shkon mirë, atëherë do të jetë vetëm provë, a do të jetë provë dhe a do të kemi kontroll armësh që hyjnë, siç tha z. Emrush Xhemajli, përmes kufirit nga Serbia në Kosovë, në Mitrovicë, Graçanicë e shumë vende të tjera që janë të populluara më popullatë serbe. Dobratini është një fshat në komunën e Lipjanit. Z. kryeministër dhe z. ministër, në Dobratin ekziston një burg ilegal i serbëve të Kosovës, pra disa ditë një pjesëtar i një komuniteti ashkali është zënë rastësisht në fshatin Radevë të komunës së Lipjanit dhe është dërguar në Dobratin dhe aty ka hasur me një person të komunitetit ashkali nga komuna e Shtimes që ne si përfaqësues legjitim të këtij komuniteti e kemi ditur se ai person është i zhdukur dhe nuk ka pasur shenja se është gjallë. Nuk dihet se kush ka ndikuar në lirim të atij personi dhe brenda 24 orëve ai person lirohet prej atij burgi ilegal që e kontrollojnë serbët e Kosovës dhe personi në fjalë është detyruar me ikë nga Kosova. Nëse ka nevojë me thanë emrin po e them, por nuk po e shoh të arsyeshme, kështu është informuar Shërbimi Policor i Kosovës, po mu për atë arsye që nuk kanë marrë hapa konkretë m'u dasht me thanë këtë në mënyrë publike.

Sa u përket këtyre rasteve nuk mund të flitet edhe shumë bardh krejt për shumicën, duhet të jemi të hapur dhe nuk duhet të frikohemi prej të vërtetës. Paraqitja e personave me maska për çdo muaj, çdo fjalë është e tepërt në këtë rast dhe a kanë mbrojtje qytetarët, nga kush kanë mbrojtje dhe kur vriten edhe policia në detyrë zyrtare, sikur që ka ndodhur rasti me dy policë në kohën e fundit, atëherë çka ka për qytetarët e lirë? Pakënaqësitë e qytetarëve janë shumë të mëdha. Në kohën e paraluftës në vitin 97-98 me qenë se shumica prej deputetëve këtu ka fëmijë dhe kanë prind, kur ju ka dalë djali apo vajza prej shtëpisë u kanë thanë ruaju se po ju zanë policia, po të rrahin, malltretojnë,

bile edhe u kanë marrë pare nëpër xhepa edhe pa i pyetur fare. Dikujt i ka shkuar i maltretuar, dikujt i ka shkuar i rrahur fëmija, tash cila është porosia e prindërve për fëmijët e tyre, kur të dalësh ruaju se mos nuk po vjen i gjallë, d.m.th nuk dihet se prej kujt me u ruajt, asi situatë e brishtë është në Kosovë, nuk mund të flasim aq bardh.

Incidentet e fundit që kanë ndikuar. z. ministër ju ndoshta nuk e dini por në Pejë është marrë një vajzë e komunitetit egjiptas në moshën 19 vjeçare është mbajtur 24 orë prej personave jo të panjohur dhe është kthyer te shtëpia, plus asaj i njëjti rast në rrafshin e Dukagjinit është mbajtur një person peng edhe deri sa nuk kanë ardhur 10.000 prej Zvicrës nuk ka guxu me u liru, këto raste as që kanë guxuar me u raportu në polici, kjo është e vërteta dhe duhet ta themi, me qenë se po flasim për siguri.

Pakënaqësitë e qytetarëve lidhur me “Vehabi” që thatë z. ministër absolut nuk jam me mendimin e juve dhe nuk dua të debatohet lidhur me këtë me qenë se vetëm krijon probleme ndëretnike.

Vrasjet pas luftës z. ministër. Është e vërtetë që siguria është kompetencë e UNMIK-ut dhe unë mendoj që me kalimin e kompetencave te Ministria e Brendshme dhe të Ministria e Drejtësisë do të kishte rast që institucionet e Kosovës t’i zbulojnë disa raste që deri tash janë të pazbuluara. Në Kosovën e pasluftës kanë ndodhur shumë vrasje, duke marrë parasysh se Xhemajl Mustafa, ish i nderuari kolegu ynë Smajl Hajdaraj, vëllai i ish- kryeministrit Haradinaj e shumë e shumë raste të tjera që janë të pazgjdhura, mirëpo ka disa raste të komunitetet pakicë e pikërisht te komuniteti ashkali që dihet se kush i ka bërë, dihen organizatorët dhe nuk kapen. Unë aspak nuk e kam ndërmend me ju frigu të vërtetës dhe ndoshta dikush e dëgjon këtë debat, por edhe me më vra dikush unë kam me thanë të vërtetën qysh ju kam thënë edhe Shërbimit Policor të Kosovës edhe administratës së UNMIK-ut, por absolutisht nuk janë marrë hapa në këtë rast. Një rast konkret: Djegia e fëmiut 11 vjeçar, Emrah Hasanit më 1 nëntor të vitit 2000, dihet personi se kush e ka kryer këtë akt, qe 6 vite është i lirë, dëshmitarët nuk janë të mbrojtur me thanë të vërtetën, por organet e dinë shumë mirë se kush është por nuk reagojnë. Pse? Pikërisht shërbimi Policor i Kosovës në Ferizaj e di këtë rast pse e la atë person me u shëtitë dhe me e bë një krim tjetër.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Fetah Berisha, kurse le të përgatitet deputeti Mark Krasniqi.

DEPUTETI FETAH BERISHA – Faleminderit z. kryesues. I nderuar kryeministër, ministra dhe kolegë deputetë.

Çështjen e sigurisë të cilën po e shtrojmë sot si debat e patëm shtruar edhe dy herë të tjera në këtë Kuvend më 20 korrik 2005 dhe më 19 dhe 20 shtator 2006, kur debatuaam dhe interpretuaam raportin statistikor të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Raporti statistikor joanalitik i Ministrisë të Punëve të Brendshme atëherë, prej vitit 2000 deri 2006 u është paraqitur deputetëve për debat dhe ishte një meritë shumë e madhe që për herë të parë për çështjen e sigurisë. Edhe raporti i sotshëm është material mjaft i thuktë, ndonëse pak i shkurtër, jo i analizuar në detaje për llojet e krimit të organizuar si korrupsioni, mospajtimet pronësore, gjendja e vështirë sociale, papunësia, shpërthimet e ndryshme etj, të cilat janë bërë sindrom që brejnë sigurinë në Kosovë, ashtu si miell. Kur debatohet për sigurinë në Kosovë sot duhet të debatohet për sigurinë në dy periudha. Periudha e parë: Siguria e Kosovës pas luftës pa Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe

siguria në Kosovë para statusit me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës. Kosova në vitet menjëherë pas lufte fatkeqësisht përjetoi çastet e frikshme, për qytetarët e Kosovës nuk kishte siguri, ata i kishte ndërhyer një ankth i frikës, traumës, shkatërrimi i luftës, vrasjet etj. Mirëpo është për t'u çuditur se sot këtu në këtë debat dhe debatet e tjera nuk përmenden vrasjet pas luftës, plagosjet, kërcënimet, pastaj edhe të atyre njerëzve që i kemi në mesin tonë. Këtu shtrohet një pyetje për Ministrinë e Punëve të Brendshme, a thua punohet në këtë drejtim edhe pse nuk i kanë kompetencat deri në fund dhe nëse punohet në këtë drejtim deri ku kanë shkuar gjërat? Dihet mirëfilli se këto plagosje, këto vrasje së pari i kanë dëmtuar familjet, kemi humbur ekspertë në fusha të ndryshme, është dëmtuar rëndë rrugëtimi i Kosovës për pavarësi, ndërsa fatkeqësisht edhe këtë herë si çdoherë tjetër fitimtar ka qenë vetëm regjimi kriminal i Beogradit. Çfarë është siguria në Kosovë në prag të statusit? Këtë fazë e karakterizojnë : transicioni, kalim i kompetencave tek vendorët, plotësimi i standardeve, sulmet me mjete shpërthyes, mungesa e rrymës, e punës, moszhvillimi ekonomik, shqetësimet e qytetarëve etj. Ajo që e shqetëson sot është moszbulimi i asnjë vrasje deri më sot, ato sidomos që kanë qenë politike. Është me rëndësi të përmendet këtu efikasiteti i gjykatave dhe i prokurorive, pastaj mungesa e shërbimit inteligjent, pastaj investimi i pakët për Ministrinë e Punëve të Brendshme, ngritja profesionale e SHPK-së etj, të gjitha këto ndikojnë jo mirë në sigurinë për Kosovën. Strukturat paralele serbe të cilat janë në Veriun e Mitrovicës dhe çdo kund tjetër, ato janë rrezik për Kosovën, ato janë kërcënim për Kosovën, ato nuk duhet të ekzistojnë, prandaj më duket se është domosdoshmëri e kohës që krahas procesit të mirëfilltë të privatizimit dhe mundësisë së punësimit, denoncimit të korrupsionit, pastaj denoncimit të krimit të organizuar politik dhe ekonomik është e ngutshme të formohet shërbimi inteligjent i shtetit të Kosovës legal, të zhbëhen strukturat paralele serbe në Kosovë, për SHPK-në të rritet investimi financiar , në mënyrë që ata të ngriten në pikëpamje profesionale.

Sa i përket rastit të Shtuticës, kur u zbulua dhe u kap tërë ai arsenal armësh mund të thuhet dhe të vlerësohet dhe të përgëzohet SHPK-ja për veprimin që e bëri, ato janë zbuluar, janë asgjësuar, njerëzit janë kapur dhe janë burgosur dhe tani lënda i është drejtuar drejtësisë e presim që drejtësia të funksionojë tash e tutje. Trimëron fakti në raport ku në një nëntitull është formuar plani operativ i detajuar i cili do t'i ndihmojë me siguri sigurisë në Kosovë dhe pastaj do t'i ndihmojë edhe zbulimit të veprave kriminale të cilat janë deri më sot të pazbuluara. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit, deputeti Mark Krasniqi, kurse le të përgatitet deputetja Myrvete Dreshaj - Baliu.

DEPUTETI MARK KRASNIQI – I nderuari kryesues, kryeministër, ministra dhe deputetë, ju përhëndes të gjithëve përzemërsisht.

Siguria është një faktor shumë i rëndësishëm për jetën normale të çdo njeriu, të çdo individi, të çdo shoqërie e sidomos çdo shteti. Atje ku nuk ka siguri, ka vetëm anarki. Këtu u cekën në këtë raport të ministrit të Punëve të Brendshme disa faktorë të cilët e rrezikojnë sigurinë në Kosovë, d.m.th është bërë një konstatim i një sëmundje që e kemi në shoqërinë tonë, për fat të mirë kjo sëmundje nuk është aq e rëndë ,të paktën si po na thonë njerëzit që janë më kompetentë ,që i përcjellin sigurinë dhe jetën shoqërore në Kosovë, po tash duhet të kërkohet edhe mjete si ta shërojmë këtë sëmundje në shoqërinë

tonë. Këtu u përmendën disa faktorë të cilët mund të ndikojnë. Ndër të gjithë këta faktorë kryesorë janë policia, ligji dhe njerëzit e jurisprudencës. Më duket se duhet të angazhohemi të gjithë në këtë drejtim që ta kemi një ambient sa më të qetë, sa më demokratik dhe sa më të frytshëm për çdo aktivitet tjetër kur ta kemi qetësinë dhe sigurinë. Janë familja, shkolla që duhet të ndikojnë dhe të edukojnë brezin më të ri, është shkolla dhe është shteti i cili e edukon popullsinë e vet me ligje, me propagandë etj, etj. Mirëpo edhe vetë qytetarët duhet të kenë një mundësi që t'i mbrojnë vetë jetën, pasurinë dhe familjen e tyre, sepse policia të cilën e kemi e duhet ta kemi sa më të mirë, mjerisht nuk ka kompetenca. Unë e kam pasur një rast të bisedoj me një epror të tyre dhe thotë se ne kemi kompetenca vetëm për ta konstatuar gjendjen, pastaj e bëjmë referatin dhe ja dorëzojmë prokurorit, e pastaj dihet se deri ku zgjidhet puna, por nga ana tjetër unë kam parë vetë në shtetet e Evropës Perëndimore, por edhe në Amerikë se disa struktura, ndoshta edhe qytetarët dhe familjet kanë të drejtë ta kenë një armë në shtëpi. Unë kamë parë edhe në Mal të Zi, vjet isha në Ulqin dhe lexova në një gazetë malazeze që ndalohet mbajtja e revolve jashtë shtëpisë, d.m.th në shtëpi është e lejuar edhe unë kisha me përkrahë këtë ligj që çdo familje ta ketë një armë për t'u mbrojtur nga maskat, nga kriminelët që vijnë me i plaçkitë, me i vra, me i dhunua ose me bë ndonjë gjë të keqe. Kur ta dinë maskat se është në çdo shtëpi një zjarr nuk do ta hapin derën aq lehtë, por thonë se po përhapen edhe vëllavrasjet e ndryshme, ai që e ka mendjen me vra ai gjithmonë e ka gjetur armën, mos asgjë tjetër pamë edhe para disa ditësh njëra e kishte përdorur edhe kazmën për ta vrarë burrin e vet. Mirëpo kjo nuk është problem. Kosova si shtet po thonë multi-etnik i cili nuk është aspak multi-etnik në kuptimin juridik që e thonë, por ka qytetarë të etniteteve të ndryshme që është normale, do të ketë probleme gjithmonë me Serbinë që këtu u cek disa herë. Serbia edhe në kohën e turkut ka pasur reparte të posaçme bashibozukësh, komitat të armatosur, të paguar mirë dhe të udhëzuar si duhet për të bërë krime në shqiptarët e Kosovës. Shpesh herë ka ngjarë dhe raste të tilla ka pasur që e kanë vrarë ndonjë serb ata vetë dhe pastaj Serbia e ka hapë propagandën e vetë siç e ka zakon që këtë e bënë shqiptarët për ta bind botën e jashtme se ne jemi një popull shkatërrimtar edhe nuk duhet të kemi përkrahje prej tij.

Mua më brengos më tepër faktori i jashtëm i cili u cek edhe këtu pak më herët, i cili mund të shkaktojë pasiguri shumë të madhe, nëse nuk zgjidhet problem i Kosovës sipas normave ndërkombëtare, sipas ligjit të përgjithshëm, mos asgjë tjetër moral që shumica të ketë të drejtën e vetëvendosjes këtu siguri nuk do të ketë. Këtë duhet ta dijë faktori ndërkombëtar patjetër. Faktori ndërkombëtar neve po na shtin edhe në telashe me Serbinë, që Serbia që ka qenë gjithmonë armik i popullit shqiptar gjatë gjithë historisë ajo e tillë është edhe sot, e tillë do të jetë edhe nesër. Tash Serbinë na impunojnë që të ulet në anën tjetër të tavolinës dhe të bisedojnë njerëzit tanë me njerëzit e Serbisë se si duhet të rregullohet Kosova. Kosova nga e cila Serbia është dëbuar nga forcat shqiptare të armatosura, nga lufta paqësore dhe demokratike dhe diplomatike, por kjo dihet se nuk duhet të jemi tepër të bindur në forcën tonë dhe t'ia bëjmë qejfin vetes se Serbinë e ndoqën nga Kosova NATO-ja, bombat e NATOS të cilat ne nuk i kemi pasur, jo që nuk do të guxonim t'i përdorim, por kur s'kemi çka të bëjmë, ku ta marrim ne që të jemi ajo forcë që ta mbrojmë gjithmonë vetveten. Serbia do të bëjë çmos për destabilizimin e Kosovës, kurrë nuk do të heqë dorë nga Kosova Serbia, për të keqën e Kosovës, aq më tepër ajo do të ketë mundësi në këtë mënyrë të "zgjidhjes" së problemit të Kosovës me decentralizimin e pushtetit, me formimin e 10-15 **serbive** të vogla nëpër Kosovë të cilat

do të jenë drejtpërsëdrejti të lidhur me Beogradin, të cilat do t'i kenë edhe kufijtë e vet dhe të cilat do të jenë në shërbim të Beogradit e jo të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Deputetja Myrvete Dreshaj – Baliu e ka fjalën, kurse le të përgatitet deputeti Xhelal Canziba.

DEPUTETJA MYRVETE DRESHAJ –BALIU – I nderuar z. kryesues, kryeministër, ministra kolegë deputetë.

Edhe pse gjendja e sigurisë në Kosovë nuk konsiderohet stabile, ky vlerësim nuk e përjashton mundësinë e nxitjes së kapaciteteve të përkeqësimit në periudhën e ardhshme. Procesi në të cilin ndodhet Kosova, sidomos tash, pas publikimit të pakos së Ahtisarit, në mundësi që ky vend të jetë shtet me kontroll të kufizuar, hap mundësinë që çështjet të mund të provokojnë situatën së paku në dy rrugë të rrezikshme. Së pari reagimet e qytetarëve serbë të mbështetura nga institucionet dhe forcat e tjera radikale serbe nga Serbia, duke përfshirë këtu edhe mbylljen brenda të ashtuquajtur edhe enklava dhe madje duke i shpallur ato edhe zona autonome si dhe reagimet e qytetarëve shqiptarë ndaj përkufizimeve të pavarësisë në pakon e Ahtisarit e të krijimit të rrethanave të tjera në zona të caktuara të Kosovës. E gjithë kjo do të mund të bartte një përkeqësim të gjendjes së sigurisë jo vetëm në Kosovë dhe jo vetëm brenda këtyre dy komuniteteve, por edhe në rajon. Meqenëse ndodhemi para rreziqeve të kësaj natyre atëherë do të ishte mirë të diskutohet çështja dhe të merrnim përgjigje se a ka kapacitete Kosova për menaxhimin e krizave të këtilla, Në të vërtetë a kemi një mekanizëm të përbashkët nga vendorët dhe ndërkombëtarët për menaxhimin e krizave nga institucionet politike dhe të sigurisë ato vendore dhe ndërkombëtare? A do të ndihemi të sigurt në një mekanizëm të tillë jo vetëm ushtarak e policor?. Periudha përmes të cilës pritet të kalojmë na bën të shqetësuar përkundër rëndësive të përditshme të KFOR-it dhe të SHPK-së që janë në gatishmëri dhe mund të realizojnë një mision të tillë. Renditja e perceptimit të rrezikut të sigurisë, ashtu siç është paraqitur në raport, duke mos i klasifikuar ato sipas dimensioneve që në hapësirë dhe kohë mund të kërcënojnë gjendjen e sigurisë në Kosovë, nuk na vijnë që janë adresuar si kërcënime reale në të cilat mund të përballemi gjatë procesit politik që po kalon Kosova. Edhe 7 vjet e sa pas luftës dëgjojmë nga institucionet më të larta vendore se në Kosovë veprojnë mekanizma paralele të pushteti që rrezikojnë sigurinë, si gjykatat dhe policia e Serbisë, që institucionet tona po i mbajnë në përcjellje dhe në kontroll të përhershëm. Ne sot e kësaj dite nuk e kemi një vlerësim të qartë të veprimit të këtyre mekanizmave të institucioneve të Serbisë dhe organizatave të ndryshme ilegale të paramilitarëve serbë të mbetura pas lufte siç thuhet se veprojnë kohë pas kohe. Pse ka mbetur qe 7 vjet e sa një organizim i tillë i forcave radikale serbe, pse është toleruar një veprim i tillë nga mekanizmat ndërkombëtarë të sigurisë të instaluar në Kosovë, përse i lejohet Serbisë që njësitë e saj të policisë të veprojnë në territorin e Kosovës kur ajo është nën protektoratin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara? Ky rrezik paraqet kërcënim serioz për sigurinë e qytetarëve të Kosovës dhe nuk mund të jetë as për se afërmi i krahasuar me rrezikun e rasteve individuale të izoluar dhe aso çfarë ndodhin në gjithë botën. Disa nga ato, kam parasysh gjetjen e armëve në Drenicë etj. Më duket se janë sforcuar më shumë për t'i arsyetuar reagimet partiake, mbajtja e armëve është e dënueshme, por nuk mund të krahasohet me rrezikun afatgjatë dhe në përmasa rajonale që paraqesin strukturat e organizuara ilegale serbe. Raporti që kemi marrë do të mund të

veçohej edhe për identifikimin e njëanshëm të disa burimeve që paraqesin rrezik në Kosovë. Pas luftës kanë vepruar dhe janë identifikuar një varg organizatash fetare islamike, të krishtera, ortodokse dhe gjatë kësaj periudhe kanë krijuar strukturat e tyre organizative. Në këtë raport lexojmë për rrezikun e vetëm të njëjës prej tyre dhe nuk thuhet asnjë shembull i veprimit të jashtëligjshëm të saj. Më duket se edhe në këtë drejtim raporti do të duhej të ishte më i qartë dhe më bindës. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Deputeti Xhelal Canziba, kurse le të përgatitet deputetja Gjylnaze Sylja.

DEPUTETI XHELAL CANZIBA – Faleminderit z. kryesues. I nderuari z. kryeministër, ministra dhe ju kolegë deputetë.

Krahas boshteve të tjera kryesore të ekzistencës së një shteti ,ku pa dyshim zhvillimet politike, ato në legjislacion, ekonomi apo në kuadrin shoqëror përbëjnë një preokupim kryesor, sërish siguria e brendshme dhe e jashtmetë qëndrueshmërisë së stabilitetit dhe profesionalizmit të institucioneve të specializuara ,mbetet shtylla kryesore e ekzistencës fizike si dhe garantimi i kushtetutshmërisë dhe i funksionimit të institucioneve demokratike në çdo vend sovran. Me rastin e Kosovës, ndonëse UNMIK-u po punon në drejtim të ngritjes së kapaciteteve vendore të drejtimit dhe administrimit të shtetit dhe të pushtetit në fushën e zhvillimit të kapaciteteve lokale të sigurisë ,nuk vërehet ndonjë zhvillim domethënës dhe perspektivë. UNMIK-u ndërmjet boshtit të sigurisë ka ngritur struktura përkatëse policore të cilat përveç komponentit ndërkombëtar përfshijnë edhe policinë vendore, e përbërë nga një personel shumetnik. Megjithatë kjo nuk është e mjaftueshme për të konsoliduar një mjedis sigurie sipas standardeve të kërkuara. Policia ndërkombëtare e cila mban edhe përgjegjësinë kryesore përbëhet nga një kontingjent i gjerë dhe përfshin kontribute që vijnë nga shumë shtete, duke filluar nga ato të konsoliduara dhe me eksperiencë efektive në këtë fushë, por njëkohësisht edhe nga mjaft përfaqësues të vendeve në zhvillim, të cilat nuk kanë mundësi reale të ofrojnë ndonjë kontribut esencial, pasi vijnë nga praktika jo shumë domethënëse. Kompozimi i kësaj force të përbërë nga më shumë se 50 vende me shumë pak njohuri dhe lidhje me rajonin, është një argument më tepër me opinionin e përgjithshëm se efektiviteti i saj mungon. Ajo nuk është një strukturë sigurie e integruar në parametra të domosdoshëm. sikurse është KFOR-i dhe nuk ka një eksperiencë të mëparshme me operacione të tilla. Ndonëse kësaj strukture nuk i mungojnë përgatitja psikologjike dhe trajnimi profesional, lidhjet e saj me komunitetin janë të dobëta për shkak të moskuptimit të saj dhe si u duhet realitetit dhe shoqërisë kosovare. Këtë argument e përforcon edhe fakti se kohëzgjatja e mandatit të qëndrimit të efektivave policore ndërkombëtare nuk krijojnë mundësi reale që stafi i këtyre strukturave të operojë me efikasitetin e nevojshëm, prandaj ndodh shpesh që ndërhyrjet e të tjerëve të dështojnë dhe të mos parandalojnë dot veprimtaritë e paligjshme.

Nga ana tjetër Kosovës i mungon struktura e një force të saj mbrojtëse të pavarur qoftë edhe embrionale, pa dyshim që siguria e saj garantohet sot edhe për një të ardhme të papërcaktuar nga KFOR-i, përndryshe nga forcat policore vendore që po vijnë duke i profesionalizuar kapacitetet e tyre operacionale. Kosova ende nuk ka një shtyllë të qëndrueshme të sigurisë dhe të mbrojtjes kombëtare. Kjo është e kuptueshme për periudhën e tranzicionit, por nuk është e justifikueshme që kjo gjendje të zgjatet

pambarim, por si mundet që Kosova të ndërtojë një të ardhme të sigurt dhe të përmbushë detyrimet e saj ndaj faktorit ndërkombëtar, si dhe standardet e kërkuara për përcaktimin e statusit përfundimtar kur kriteri themelor për ekzistencën e çdo shteti- korpusi i tij mbrojtës është inekzistent. Një Kosovë e pavarur e sigurt dhe e integruar në mënyrë absolute. nuk mund të ekzistoj[si e tillë pa strukturën e saj të pavarur të forcave të armatosura. TMK-ja e cila është kthyer më shumë në një njësi të ndërhyrjes me rastin e emergjencës civile dhe hapësirës tepër të kufizuar që i kanë lënë ndërkombëtarët, Kosova vuan gjithashtu edhe prej së njëjtës gjendje dhe në drejtim të shërbimit të specializuar të intelgjencës që është përqendruar në duar të forcave dhe strukturave ndërkombëtare në terren. Kjo është gjithashtu një fushë e rëndësishme e shtetit, mungesa e së cilës vështirëson punën e autoriteteve të vetëqeverisjes, pasi mungesa e informacionit të specializuar ndikon negativisht edhe në procesin e arritjes së standardeve. Mungesa e këtyre pushteteve krijon edhe një imazh të paplotë dhe të paqartë për aftësitë dhe kapacitetet menaxhuese të autoriteteve kosovare. që besoj se ndikon edhe në prestigjin dhe në kredibilitetin e tyre në mes popullsisë vendore, por edhe para faktorit ndërkombëtar. Prandaj procesi i transferimit të pushteteve duhet zgjeruar me kurajo dhe në fusha të tilla sensitive. Është e nevojshme që autoritetet kosovare, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, kryesisht të autoriteteve të NATO-s dhe të atyre të KFOR-it, në terren të fillojnë sa më parë përgatitjet për hedhjen e bazave për ndërtimin e një strukture të mirëfilltë ushtarake të Kosovës, si dhe një akademi ku do të përgatiten oficerët dhe nënoficerët e një force perspektive. Ngritja dhe përgatitja e një ushtrie profesionale kërkojnë kohë, buxhet dhe sakrifica, prandaj duhet filluar pa humbur kohë dhe sa më parë të punohet në këtë drejtim. Kjo përpjekje ka nevojë gjithashtu edhe përgatitjen e autoriteteve civile, politike dhe administrativo-profesionale për të realizuar kontrollin dhe drejtimin civil të kësaj force si dhe ngritjen e departamenteve të veçanta në strukturat e institucioneve të përkohshme të cilat do të monitorojnë këtë proces dhe do të hedhin themelet e strukturave të specializuara drejtuese të së ardhmes. Është gjithashtu e rëndësishme të kuptohet se një konceptim më i plotë i marrëdhënieve në mes autoriteteve civile kosovare dhe drejtuesve ushtarakë do t'i shërbente më mirë prezantimit të tyre, pasi është i njohur fakti se për shkaqe të njohura historike, por edhe si rezultat i një eksperience më të gjerë ndërkombëtare që është e lidhur me rolin e ushtarakëve në themelimin dhe ruajtjen e shtetit, përfaqësuesit e TMK-së janë ndër faktorët më të respektuar me më shumë reputacion dhe besueshmëri në popullsinë kosovare .çka do të ndikojë pozitivisht në menaxhimin e situatave dhe drejtimin e vendit. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Deputetja Gjylnaze Syla, kurse le të përgatitet deputeti Ragip Zekolli.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit. I nderuari z. kryesues, i nderuari z. kryeministër, ministra, të nderuar deputetë.

I nderuari z. ministër Rexhepi ju faleminderit për raportin tuaj gjithëpërfshirës dhe për informata të rëndësishme për gjendjen e sigurisë në vend. Debatin e sotëm për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në Kosovë e mbështes dhe shpresoj se do të përfundojë me kontributin e përbashkët për siguri në vend. Unë plotësisht pajtohem me vlerësimin tuaj se gjendja e përgjithshme e sigurisë në vend është stabile dhe e qetë, por për këtë duhet falënderuar qytetarët e Kosovës dhe mekanizmat e sigurisë vendore, SHPK-në, TMK-në

dhe mekanizmat ndërkombëtarë, KFOR-in dhe policinë e UNMIK-ut. Megjithkëtë ngjarjet dhe situatat që kërcënojnë dhe sfidojnë sigurinë e përgjithshme dhe atë personale mund të krijojnë ndjenjën e pasigurisë, prandaj s'ka dyshim, siguria është prioritet. Të nderuar deputetë siguria është rezultat i ndërveprimit të faktorëve nacionalë, rajonalë, ndërkombëtarë, socialë dhe ekonomikë, këta faktorë nuk janë të izoluar, por të ndërlidhur. Në vazhdim unë do ta trajtoj sigurinë politike, ekonomike dhe transferin e kompetencave.

Së pari dëshiroj të fokusohem në sigurinë politike, në rëndësinë e qartësimit sa më të shpejtë të statusit të Kosovës si faktor i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në sigurinë e qytetarëve. Shtyrja, vonesa dhe paqartësia për fatin e vendit kanë shkaktuar lodhjen, pakënaqësinë dhe pasigurinë e popullit të Kosovës. Përcaktimi real i fatit të vendit nga institucionet dhe populli i Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran është shumë i rëndësishëm, sepse forcon stabilitetin dhe sigurinë e brendshme, kurse kontribuon në sigurinë dhe stabilitetin në rajon. Për më tepër hap perspektivën për integrimin në Bashkësinë Evropiane. Në të vërtetë statusi i qartë për Kosovën do të përmbushë nevojën e Kosovës për zhvillim shoqëror, ekonomik dhe institucional. Në këtë kontekst është e domosdoshme që sa më shpejtë të bëhet e qartë përmbajtja e pakos së presidentit Ahtisari dhe të merret vendim unik dhe në afatin sa më të shkurtër nga bashkësia ndërkombëtare për njohjen e shtetit të Kosovës. Por sfida politike ende mbeten : Veriu i Kosovës. ekzistimi i strukturave paralele, i mekanizmave ilegalë, si ato të MUP-it të Serbisë edhe pse, siç thuhet në raport ,monitorohen nga SHPK-ja dhe policia e UNMIK-ut, krijojnë klimë të pasigurt. Meqë kjo është kompetencë e rezervuar, atëherë kërkohet angazhim i shtuar efikas dhe me rezultate konkrete i faktorëve përgjegjës ndërkombëtarë dhe i atyre vendorë, janë shqetësuese veprimet e fundit në këtë aspekt.

Sa i përket sigurisë ekonomike ajo është e ndërlidhur me atë politike, mungesa e zgjidhjes më të shpejtë, zgjatja e kohës për zgjidhjen e problemeve të papunësisë, atyre sociale dhe kualitetit të jetës, për shkak të mos zhvillimit të ekonomisë ,krijojnë ndjenja të pasigurisë për të ardhmen e vendit. Po aq sa na duhet siguria politike, po aq na duhen stabiliteti ekonomik dhe sundimi i ligjit , i cili krijon stabilitet edhe më të madh politik. Nuk mund të ketë siguri të qëndrueshme pa zhvillim ekonomik, varfëria gjendja e rëndë ekonomiko-sociale, e pensionistëve, invalidëve të luftës, papunësia e të rinjve, familjet e të zhdukurve, janë burimet potenciale për keqësimin e situatës së sigurisë.

Sa i përket transferimit të kompetencave, suksesi në bartjen e kompetencave dhe formimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme janë evidente, si dhe puna e suksesshme e Shërbimit Policor të Kosovës, me gjithë se autorizimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme janë të kufizuara dhe bartja e përgjegjësive në fushën e policisë në funksionimin e SHPK-së duhet përshpejtuar dhe funksionalizuar. Duke përgëzuar Ministrinë e Punëve të Brendshme për masat e parapara, për më shumë siguri në vend dhe me qëllim që të kontribuojnë në angazhimet e mëtejme të përbashkëta, konsideroj se janë të nevojshme edhe këto masa: vizioni i qartë për sigurinë, përpilimi i politikave të sigurimit, infrastruktura ligjore dhe procedurale ku do të veçoj Ligjin për policinë, Ligjin për grumbullimin e armëve, Ligjin për mbajtjen e armëve.

Rritja e nivelit të edukimit dhe profesionalizimit të SHPK-së, efikasiteti i sektorit të sigurisë, por edhe të mbikëqyrjes së tij demokratike dhe krijimi i shërbimit inteligjent profesional.

Të nderuar deputetë edhe pse përgjegjësia për siguri bie mbi KFOR-in, policinë e UNMIK-ut, SHPK-në dhe TMK-në ,me gjithë atë është përgjegjësi e të gjithë neve, pozitës dhe opozitës, Qeverisë, Kuvendit, shoqërisë civile, mediave dhe qytetarëve të Kosovës. I ftoj të gjitha komunitetet e sidomos komunitetin serb që të marrë pjesë në ndërtimin e institucioneve demokratike të Kosovës. Nevojitet bashkëpunim i ngushtë dhe bashkëveprimi i të gjithëve që Kosova të jetë vend i sigurt për të gjithë qytetarët e saj dhe kontribuues i paqes dhe sigurisë në rajon, Evropë dhe në botë. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Deputeti Ragip Zekolli e ka fjalën, kurse le të përgatitet deputetja Zylfije Hundozi.

DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI - Faleminderit z. kryesues. I nderuar kryeministër, ministra e në veçanti ministër i Punëve të Brendshme. Ju faleminderit që e keni paraqitur, mirëpo unë do të mundohem , të paktën, të prek dy – tri gjëra të cilat nuk janë thënë në raport . Mendoj që do t'i kontribuojnë kësaj çështjeje, e cila është tejet e ndjeshme edhe për momentin, por edhe për rrethanat në të cilat ndodhet Kosova.

Çështja e parë,në të cilën dua të fokusohem, mendoj se do të ishte mirë që në raport të ekzistonte një pasus për trafikimin e qenieve njerëzore, përkatësisht prostitucionit .Edhe pse Qeveria ka krijuar Zyrën e kryeministrit dhe në çdo ministri, por për fat të keq unë po lidhem vetëm me një sondazh në mjetet e informimit në kohët e fundit që kjo çështje në Kosovë është në rritje, ndërsa prin Prizreni. Më vjen keq që them kështu, por është një raport prej 500 m2, ku ndodhet edhe Shërbimi Policor i Kosovës dhe stacioni i autobusëve edhe një qendër dhe vërtet para syve tonë ndodhin këto gjëra që mendoj që do të ishte mirë të jemi shumë më të organizuar në këtë drejtim.

Çështja e dytë për të cilën mendoj se duhet të ekzistojë një bashkëpunim më i mirë është bashkëpunimi i policisë së komunitetit e sidomos ky bashkëpunim të jetë me shkollat, në turnet e pasdites ku bëhet mësimi i pasdites dhe ju përgëzoj z. ministër për një çështje që mendoj është tejet e rëndësishme edhe pse e keni thënë këtë rast, por dashtë e pa dashtë duhet pranuar se ekziston një ekstremizëm islamik, ndoshta edhe brenda vet faktorit islam që është apo nuk është e dhimbshme duhet të thuhet, sepse janë gjërat të cilat kanë ndodhur dhe ndoshta me një preventivë mund të kalohen këto. Më e dhimbshmja e të gjitha këtyre është edhe vetë raporti se në këtë situatë pse vërtet nuk po mund t'i gjejmë shkaktarët e krimeve, pse ata nuk po dënohen para drejtësisë apo edhe pse kur denohen. Ju lutem ato dënime janë aq të vogla sa nuk mund të zihen në gojë. Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Zylfije Hundozi për momentin nuk është këtu. Deputeti Hydajet Hyseni Kaloshi e ka fjalën.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit z. kryesues, po pres pak derisa të dalë ministri. Pse thashë këtë se e kisha ndërmend ta përshëndes, po i përshëndes përfaqësuesit e tjerë të Qeverisë, kryeministrin, dhe që në fillim duhet të them edhe unë se Raporti i prezantuar edhe mua më duket se është një raport i thekët. A ishte kështu apo jo? Megjithatë edhe si i tillë i thekët e goxha thekër, ky raport, megjithatë, përfundon se gjendja e sigurisë në Kosovë është solide, është e qetë , e kënaqshme, me

ndonjë ndjeshmëri. Unë ndihem mirë kur është kështu dhe vërtet Kosova meriton lëvdata për këtë nivel të sigurisë, duke pasur parasysh vakumin ligjor e institucional në të cilin po jetojmë që sa kohë. Ata që kanë kontribuar në këtë nivel meritojnë edhe mirënjohje. Unë i përgëzoj të gjithë ata që punojnë në ruajtjen e sigurisë dhe avancimin e saj.

Megjithatë, mendoj që gjendjen duhet ta shikojmë seriozisht dhe në gjithë kompleksitetin e saj, por edhe gjithë dimensionet e saj. Megjithatë, mendoj që vend për vetëkënaqësi nuk duhet të ketë. Gjendja e sigurisë në Kosovë shpesh është dukur e qetë dhe më vonë shumë shpejtë jemi detyruar të pranojmë se megjithatë ishim nxituar në vlerësime.

Nuk mund të themi se gjendja është e kënaqshme nëse ne kemi lajme indice se rreth Kosovës, jashtë Kosovës, shpesh edhe në Kosovë përgatiten plane përbindësh për Kosovën, ato ose duhet të demantohen ose duhet të merren seriozisht. Z. ministër dhe rreziqet të cilat janë përfshirë, mendoj duhet parë në rendin që ato përfaqësojnë vërtet. Nuk më tingëllonin bindshëm potencimi ashtu siç është bërë në Raport i ashtuquajturit ekstremizëm islamik. Është e ekzagjeruar, ka tendenca për t'ia mbathur Kosovës një sindrom të tillë. Nuk them se nuk ka pasur përpjekje për ta shartuar në Kosovë edhe një polip të tillë, por megjithatë është fakt i njohur dhe duhet afirmuar se në Kosovë nuk ka ndezur një ekstremizëm i tillë dhe nuk mund të ndezë kurrë, sepse është imuniteti i posaçëm që ka populli i Kosovës, është tradita e lashtë e bashkëjetesës, e tolerancës edhe të feve të ndryshme, bile edhe e etnive të ndryshme, të cilën ne nuk e kemi afirmuar dhe duhet ta afirmojmë këtë aspekt pozitiv që është dëshmuar dhe gjatë këtyre kohëve, por nëse duhet të flitet për ekstremizmin fetar të mos i harrojmë edhe ekstremizmat e tjerë. z. ministër, nuk janë më pak të rrezikshëm, përkundrazi edhe në të kaluarën tonë të freskët janë do fundamentalizma të tjerë fetarë që janë dëshmuar si vërtetë tepër të rrezikshëm jo vetëm për popullin shqiptar, por edhe për popujt e tjerë në Kosovë.

Nuk më duket në rregull po ashtu që kur përmenden organizatat e ndryshme inteligjente, kuaziinteligjente që të futen në një thes dhe t'u ndajmbathen të gjitha edhe instrumentet e kërcënimit. Ne nuk kemi dëgjuar asnjë, ta zëmë për njërin prej tyre se ka përdorur instrumente të tilla. Le t'i vihet secilit ajo që ka, por jo të përzihen dhe të identifikohen të gjithë. Dhe këtu mendoj se do të duhej pak më shumë të flasim për strukturat e vjetra, të cilat ne gabimisht po i quajmë struktura paralele, duke i tërhequr dofarë paralelesh në do kohë të tjera. Strukturat e vjetra janë të vjetra dhe të vjetërsuara të rrezikshme, sepse janë dëshmuar të rrezikshme. Asnjë ngjashmëri nuk mund të ketë me format e ndryshme të vetorganizimit që kanë pasur edhe efektet dhe përkrahjen e duhur. E njëjta gjë më duket se është dhe ndihem mirë që ky debat nuk u fokusua vetëm në të ashtuquajturin rast të Shtuticës e të tjera, është një nga rastet. Në Kosovë ka pasur shumë raste të tilla dhe mendoj që do të duhet parë mirë arsyet pse ndodhin fenomene të tilla dhe nuk duhet lejuar që të përdoret kjo në një funksion që ka qenë po ashtu konstant e njëfarë demonizimi i Drenicës. Ne nuk po e afirmojmë faktin që është shumë domethënës, që Drenica edhe përkundër asaj që ka përjetuar dhe e ka përjetuar veçanërisht, megjithatë është rajoni ose zona me siguri më të lartë në Kosovë, me nivel më të ulët të dhunës e kriminalitetit. U takon institucioneve profesionale që ta afirmojnë dhe vlerësojnë pse ndodh kjo. Është një konkluzion që është shumë domethënës për Kosovën dhe të ardhmëni e saj.

Për mua më shqetësuese armët jashtë Kosovës se armët që eventualisht kanë mbetur nga një luftë për fat të keq ende jo krejtësisht e përfunduar dhe e kurorëzuar me ato që edhe synon ky popull.

Edhe protestat si një nga shkaqet rrezikshme të “ Vetëvendosjes” të veçura duke harruar fenomene të tilla edhe të tjerët. Në Kosovë ka pasur edhe protesta të tjera, vazhdimisht bëhen: bllokada rrugësh e tjera. Pse harrohen ato? Ngjarjet e marsit ju e dini i kanë provokuar pikërisht ngjarjet e tilla dhe jo protestat e “Vetëvendosjes”. Qëndrime me kute të ndryshme që kanë qenë sindrom i së kaluarës kurrë nuk i kanë shërbyer vendosjes së një gjendje të dëshiruar të sigurisë në Kosovë.

Unë dëshiroj vërtet që gjendja e sigurisë të jetë ashtu siç është thënë, por megjithatë nuk mendoj se duhet ta harrojmë faktin se Kosova deri diku po kriminalizohet, bandat po bëjnë ligjin, ajo që u tha pak më parë fenomenet si prostitucioni, narkomania, alkoolizmi, e të tjera janë në rritje dhe ne duhet t’ua brejmë rrugët që në fillim. Megjithatë mendoj se nuk duhet ta nënçojmë edhe një fakt. Ne mburremi që rinia jonë është ndoshta në nivele të larta të përdorimit të internetit e tjera, por po e harrojmë një fakt se shumica e fëmijëve të Kosovës luan conterstrajk. Ku çon kjo dhe çka bëjnë institucionet tona që të pengojnë në një mënyrë intoksimin e tillë të brezave që po vijnë. Megjithatë unë pajtohem me ju z. ministër se një nga faktorët kryesorë të destabilizimit eventualë të Kosovës qëndron në zhgënjimin eventual të popullit të Kosovës. Është rrezik serioz dhe potencial, por nuk të mjaftohemi vetëm me kaq, duhet edhe të shkojmë tutje. Çka e shkaktoi këtë zhgënjim të cilin ne veç po shohim? Thotë një shkrimtar anglez: “Ruajuni shpërthimit të njerëzve të durueshëm”. Në Kosovë kjo është dëshmuar disa herë. Ky popull duron shumë, por kur zhgënjehet keq, atëherë edhe shpërthen keq. Kush e ka përgjegjësinë që ky popull është vënë në një situatë të tillë? A jemi të gjithë pjesëmarrës në të, me euforinë që kemi krijuar shpesh pa mbulesë. Pastaj, a i ka kontribuar kësaj edhe ajo që u bë me procesin negociues. Si ta kuptojnë tash atë ofertën agresive që u prezantua me shumë pompë? Ku janë këtu tash ato fitoret me runda e tjera për të cilat flisni? Çka bëmë me të ashtuquajturat decentralizime e tjera? A mos ishin detonatorë të destabilizimit të ardhshëm, po instrumentalizimi që po dëshmohet i rrezikshëm i komunitetit serb në Kosovë, a nuk u legjitimua edhe duke i ulur ata në anën përballë Kosovës në tavolinën e bisedimeve dhe nuk është vetëm përgjegjësi e përfaqësuesve të Kosovës zonja e zotërinj? Është përgjegjësi edhe e faktorëve ndërkombëtarë që kanë pasur përvojë, kanë parë se janë të informuar se ku çon kjo. Ka qenë edhe e paralajmëruar. Këtë rrezik nuk mundemi ta nënçojmë zonja dhe zotërinj. Dhe e theksoj këtë jo për të alarmuar, por që megjithatë të shikojmë ku jemi dhe të mos lejojmë të na përsëriten situatat si në të kaluarën, ta parandalojmë të keqen, t’i biem drurit e gurit tash që të mos na ndodhin raporte ose oferta që mund të jenë zhgënjyese dhe të rrezikshme për të gjithë në Kosovë. Ende ka kohë, por duke e futur kokën në zall nuk mund të japim përgjigjet e duhura.

KRYESUEISI I SEANCËS NAIM MALOKU - Ju faleminderit z. deputet, Zylfije Hondozi e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Behxhet Brajshori

DEPUTETJA ZYLFIJE HONDOZI - Z. kryesues, z. kryeministër, ministra të pranishëm, kolegë deputetë,

Debati i sotëm për gjendjen e sigurisë në Kosovë në këtë kohë kaq të ndjeshme për Kosovën është më se i qëlluar. Është e dukshme që prej se është formuar Ministria e Punëve të Brendshme dhe është bërë transferimi i disa kompetencave, situata e sigurisë është gjithnjë e më e mirë. Nga Raporti i dhënë mund të kuptohet se gjendja e sigurisë është e qetë dhe stabile dhe pse nuk është ideale, falë disa rasteve sporadike.

Rasti më i freskët ishte kontrabandimi i një sasive të madhe të drogës të fshehur në kuti të ngjyrës dhe që i ka kaluar dy pikat doganore pa u zbuluar fare dhe është bartë nëpër tërë territorin e Kosovës. Nëse merret parasysh se në Kosovë hyjnë lirisht pjesëtarët e sigurimit sekret serb, gjë që e kanë pohuar edhe ata vetë dhe që prezenca e tyre në vendin tonë paraqet një rrezik permanent të provokimeve të incidenteve të ndryshme, të cilave shpesh nuk i është gjetur autori, kur dhe destabilizimit të situatës së përgjithshme. Çka është më e keqja formojnë në imazh të keq për Kosovën në sytë e bashkësisë ndërkombëtare. Kjo na tregon se pika më e dobët janë kufijtë e Kosovës dhe angazhimi i shtuar i organeve të sigurimit duhet të jetë aty. Sa i përket sigurisë së brendshme ajo çdo ditë është duke u përmirësuar dhe një sërë aksionesh të suksesshme të organeve të sigurisë kohëve të fundit na japin shpresë dhe zgjojnë optimizëm se Kosova po bëhet vendi gjithnjë më i sigurt për të jetuar. Sfidat më të madhe për organet e rendit do të jetë koha pas shpalljes të statusit të Kosovës gjatë së cilës pritet që të ketë pakënaqësi edhe nga ana shqiptare dhe ajo serbe. Nga grupet e ndryshme njerëzish e sidomos mundësia që në Veri të Kosovës të ketë trazira nga ana e strukturave paralele ose akte të tjera të njëanshme. Është e madhe kur dihet se pala serbe asnjëherë nuk ka dashur të integrohet në institucionet e Kosovës dhe është kundër pavarësisë së saj. Përgatitjet që i kanë bërë organet e rendit, gjegjësisht plani strategjik për veprim, për këtë kohë janë për t'u lavdëruar dhe të krijojnë ndjenjën se gjendja e sigurisë edhe atëherë do të jetë në nivelin e duhur.

Pjesa në Raport për ekstremizmin islamik nuk e ka vendin në të, se në Kosovë nuk mund të thuhet se ka ekstremizëm islamik, por mund të thuhet se ka një intensifikim të veprimtarive fetare të një grupi të vogël të njerëzve në Kosovë që në krahasim me periudhën e socializmit kur nuk kishte fare aktivitete fetare te na duken si një ekstremizëm. Kësi kualifikimesh nga ana jonë kur e tërë propaganda serbe në Perëndim është e përqendruar të na barazojë me ekstremistët islamikë janë të dëmshme dhe janë shkruar pa u analizuar mirë situata faktike në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUEISI I SEANCËS NAIM MALOKU – Ju faleminderit! deputeti Behxhet Brajshori e ka fjalën, përgatitet deputetja Nekibe Kelmnedi

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI - I nderuari Z. kryesues, kryeministër, ministra dhe të nderuar kolegë deputetë

Unë e përgëzoj ministrin për Raportin që e ka sjell në Kuvend dhe natyrisht që në fillim, po ashtu e përgëzoj Shërbimin Policor të Kosovës për veprimet e suksesshme kohëve të fundi natyrisht në Kosovë në eliminimin e dukurive të caktuara negative që janë paraqitur.

Që në fillim të Raportit konstatohet se gjendja e sigurisë në Kosovë vazhdon të jetë e qetë dhe stabile dhe nuk kemi asnjë arsye ndoshta asnjëri prej nesh të mos besojmë në masë të caktuar që kështu është dhe kështu duhet të jetë. Mirëpo, natyrisht është me

atë ndjenjën se gjithmonë mund të jetë në gjendje edhe më të mirë, gjithsesi edhe më stabile. do ta komentoja raportin të nderuar kolegë, por do të bëja tri katër sugjerime të cilat mendoj se mund të ndikojnë në përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes së sigurisë në Kosovë. Sugjerimi i parë do të jetë - nevoja e investimeve në ngritjen e bazës materiale të Shërbimit Policor të Kosovës dhe të të gjitha institucioneve të tjera që merren me ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në Kosovë. Nëse do të kemi ndonjë investim më të madh në të gjitha aspektet në këto segmente, qoftë në ngritjen e bazës së drejtpërdrejtë materiale, apo të pajisjes së Shërbimit Policor të Kosovës me pajisje teknike të nevojshme për zbulimin e rasteve, gjendja e sigurisë do të jetë dukshëm më e mirë.

Sugjerimi i dytë do të jetë: investimet në ekonomi. Nëse arrijmë ta kemi një shkallë më të lartë të zhvillimit ekonomik, do të kemi një mirëqenie më të madhe shoqërore dhe në këtë drejtim natyrisht do të kemi një gjendje të sigurisë shumë më të mirë, sepse do të eliminoheshin sfidat të cilat janë thënë në raport sikur që është gjendja e rëndë ekonomike dhe sociale dhe sfidat tjera, të cilat mund ta provokojnë situatën. Duhet të jem i sigurtë se një gjë e tillë mund të ndodhe në kushtet e rënda sociale dhe ekonomike. Prandaj, këta dy faktorë janë të lidhur njëri me tjetrin, investimet në bazën materiale në Shërbimit Policor të Kosovës dhe investimet ekonomike në përgjithësi do të ndihmojnë njëri tjetrin.

Sugjerimi i tretë do të ishte: eliminimi i domosdoshëm i strukturave paralele.

Të nderuar kolegë. Asnjë shtet në botë nuk do të lejojë veprime e strukturave paralele në vendin e vet. Këtë duhet ta bëjë Shërbimi Policor i Kosovës bashkë me Policinë e UNMIK-ut dhe organet e tjera të rendit dhe të sigurisë dhe

Sugjerimi i katërt do të ishte ngritja e efektivitetit të organeve të gjyqësisë. Nëse nuk do të kemi një efektivitet sa duhet të organeve të gjyqësisë lëndët do të na mbesin edhe nëse dorëzohen nga Shërbimi Policor i Kosovës në organet e Prokurorisë dhe të gjyqësisë ato do të na mbesin të pazgjedhura dhe si të tilla do të krijohet bindja se askush nuk mund të dënohet. Ju faleminderit!

KRYESUEISI I SEANCËS NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Deputetja Nekibe Kelmendi e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Gjergj Dedaj

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – i nderuari Z. kryesues, i nderuari Z. kryeministër e ministër, te nderuar kolegë deputetë,

Unë jo vetëm që e kam dëgjuar sot drejtpërdrejt Raportin e ministrit të Punëve të Brendshme, por edhe e kam lexuar me vëmendje. Për aq kohë të shkurtër të ushtrimit të funksionit të Ministrit të Punëve të Brendshme për aq kompetenca sa ka kjo Ministri. Vlerësoj se kjo ministri ka arritur që autoritetin e institucionit të Ministrisë të Punëve të Brendshme ta ngris në një shkallë të lakmueshme si dhe e ka ngritur edhe autoritetin e Shërbimit Policor të Kosovës, i cili tani nuk është me nëpër restorante e kafe, por është në të gjitha rrugët dhe në të gjitha këndet e qyteteve të Kosovës gjithnjë në shërim të popullit dhe për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë. Nuk presim më shume të dhëna konkrete në Raportin e Ministrit të Punëve të Brendshme, sepse me të dhëna më konkrete mendoj se as që disponon për faktin se ekzistojnë shërbime të UNMIK-ut, të cilat më shumë merren me gjëra konkrete dhe nga ana tjetër të dhënat më konkrete, do ta dëmtonin angazhimin e policisë së SHPK-së, Policisë së UNMIK-ut, KFOR-it e të

tjerëve për zbulimin e kryerësve të krimeve të raportuara dhe të sfidave të raportuara në Raportin e ministrit të Punëve të Brendshme.

Nuk pajtohem me disa diskutues ,apo me disa diskutime të deputetëve, kur Raportin e shtrembërojnë dhe e nxisin popullatën në mosrespektimin e institucionit ,siç janë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Shërbimi Policor i Kosovës. Ne, sot nuk po debatojmë për krimet dhe luftimin e krimeve i cili nuk i përket vetëm Ministrisë së Punëve të Brendshme, por u përket edhe institucioneve të tjera dhe organeve të tjera të ndjekjes penale. Ne sot po diskutojmë dhe po debatojmë këtu për gjendjen e sigurisë dhe me shume realitet është thënë në Raportin e ministrit të Punëve të Brendshme se gjendja e sigurisë është e mirë, është e kënaqshme për rrethanat në të cilat ne jetojmë, punojmë dhe veprojmë këtu në Kosovë. Diskutimin tim do ta përfundoj me apelin që ta ndihmojmë SHPK-në dhe të mos nxisim me fjalimet dhe me retorikat tona të ashpëra trazira te popullata, sidomos tani kur vërtet gjendemi para sfidave të mëdha, por kemi përballuar edhe më shume, do t'i përballojmë edhe këto sfida dhe nuk do të lejojmë që angazhimin tonë shumëvjeçar të gjithë popullit dhe të gjitha strukturave e të të gjitha partive, ta humbim duke krijuar trazira mu në momentin kur pritet një raport shumë i rëndësishëm për Kosovën. Ju faleminderit!

KRYESUEISI I SEANCËS NAIM MALOKU –Ju faleminderit! Deputeti Gjergj Dedaj e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Xhezair Murati

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Ju faleminderit shumë Z. kryesues, z. Kryeministër, ministra ,deputetë

Rregullisht jam në dilemë gjatë këtij debati a me marrë fjalën a jo, por përkundër dëshirës së shumë deputetëve këtu vendosa ta marr fjalën dhe do të vazhdoj edhe në vitin 2007 të jem një deputet i mërzitshëm edhe t'u kontribuoj sa mund dhe sa di proceseve siç ishim pjesë e të gjitha lëvizjeve që kanë ndodhur në këto dy dekadat e fundit në Kosovë në të gjitha segmentet e jetës. Mund te kem edhe besoni se kam respekt për ministrin Rexhepi, por kjo nuk do të thotë që duhet me e përshëndetur këtë raport, sepse ma shumë është një raport përshkrues i ngjarjeve të cilat kanë ndodhur në Kosovë që i kemi lexuar në gazeta e kemi parë në media, i kemi parë në jetën e përditshme e po të quhej raport, do të ishte raport atëherë ka qenë dashur ndoshta që ministri i Brendshëm Rexhepi të na tregonte për rezultatet e hetimeve, rezultatet e gjetjes dhe arrestimit të kryerësve të veprave të ndryshme që kanë ndodhur në Kosovë. Është e vërtetë që prej luftës e deri më sot në Kosovë ka afër, nuk e di shifrën e saktë se ndodhin vrasje po thuajse çdo ditë rreth 1000 të vrarë në Kosovë dhe tash quhet se situata shumë stabile, shumë e qetë në një Kosovë të vogël me 11 mijë metra katrorë me një Kosovë që del pas lufte do me thënë me mjaft vuajtje dhe tragjedi. Unë mendoj se është e papranueshme bile shpeshherë mundem me thënë se është edhe mëkat. Po ashtu, “ju përgëzoj” për një rezultat spektakular që keni dashur ta bëni për marketing në Shtuticë të Drenicës, ku kam pasur nderin dhe kam nderin që ata djemë personalisht t'i njoh dhe nuk ma merr mendja dhe nuk jam asnjëherë i bindur se edhe pse mund të zhvillohet ndonjë proces i montuar për politikë ndoshta ndaj tyre më shumë është d.m.th. si një rast për marketing që dikujt iu ka dashur që edhe ta njollosë Drenicën edhe Kosovën, sepse po të hyni në çdo fshat në Kosovë edhe në çdo familje ndoshta edhe në

fshatrat serbe do të gjeni mbetje të luftës -armë të ndryshkura, të hedhura, të gjuajtura edhe tash shumë bukur i kishit rregulluar për një fotografi, për një marketing anti Kosovë . Unë mendoj se një gjë të tillë ka qenë dashur ta bëni edhe në fshatin Babimost kur është vrarë polici i SHPK-së edhe ato armë që i keni marr prej serbëve është dashur edhe ato po ashtu t'i fotografoni edhe të bëni , d.m.th. t'i bëni publike . Mendoj se nuk e kemi pasur atë kurajë dhe atë guxim dhe se është shumë keq.

Sa i përket se nuk dua me hy në detale të Raportit, unë nuk jam specialist as nuk jam marrë me këto çështje asnjëherë në jetë, por sa i përket çështjes së lëvizjes “ Vetëvendosja “shoh që e kini një ton të averizionit ndaj atyre protestave që mendoj që kanë qenë shumë dinjitoze dhe shumë të qeta. Shihni protestat që bëhen nëpër qendrat e ndryshme dhe metropolit të Evropës kur shkelet vullneti ose shkelet premtimi i qeveritarëve mund me thënë se janë pesëdhjetë herë më të vrazhdëta ose mund te thëm që ndoshta me qindra here më të vrazhda. Mund t'i shihni çdo mbrëmje e shpeshherë nëpër media se si protestojnë qytetarët e atyre vendeve kur shkelen dhe fyhen të drejtat dhe premtimet që ua japin qeveritarët për çështje të caktuara. Unë mendoj se nuk qëndron që, siç thotë populli me bo hop para se me e kërcye murin, edhe vlerësimi i kryeministrit Çeku në takim me z. Ryker që thotë se ju siguroj që nuk do të ketë protesta dhe trazira pa marrë parasysh statusin politik të Kosovës. Unë ju them këtu shumë bindshëm nuk e di se është për ju është qesharake, sepse shpeshherë po ju shoh gjatë këtij debati se po qeshni dhe kam dëshirë t'ju shoh gjithnjë të gëzueshëm dhe duke qeshur, sinqerisht po ju them, mirëpo është mirë me qeshë në fund të këtij procesi dhe kjo mua aspak nuk po më pengon, sa po më pengon se d.m.th. po jepni premtime paushall, pa e ditur se si do të silltet populli i Kosovës ose nuk keni informacione nëse shkelet vullneti politik i qytetarëve të Kosovës. siç është pavarësia e plotë e Kosovës. Unë jam plotësisht i bindur se nuk jemi duke u marrë seriozisht me këtë çështje, e kemi lënë çështje shumë periferike- çështjen e statusit. Dje Këshilli i Evropës debatoi edhe nxori një rezolutë për Kosovën, sot presidenti Ahtisari para Grupit të Kontaktit e qet, d.m.th. pakon propozimin për Kosovën, na merremi me këtë çështje, d.m.th. ose me çështje të tjera Kuvendi i Kosovës që janë krejtësisht që kanë kohë për me u marrë pak ma vonë tue iu shmangë çështjeve kruciale , substanciale që është çështja e statusit të Kosovës, çështja e Kushtetutës së Kosovë, çështja e simboleve shtetërore, çështja e zgjedhjeve, d.m.th. nuk dëshironi me hy në problemet me të cilat po ballafaqohen dhe duhet të ballafaqohen qytetarët e Kosovës. Unë nuk dua me thënë diçka tjetër më shumë ndoshta për këtë, një fjali që e keni cekë aty për një organizatë , ajo nuk është organizatë WAHABBI, por lëvizja e WEHABBI, ndoshta e keni përkthyer, nuk po dua me prejudikua prej ku e keni përkthye është çështje juaja ajo është një lëvizje ideologjike, një sekt fetar, por jo organizatë dhe unë mundem me thënë si pjesëtar i një besimi katolik që populli që është shumicë absolute i besimit mysliman asnjëherë në historinë e vet , as në të kaluarën e as në të tashmen dhe i sigurojë miqtë tanë ndërkombëtarë se asnjëherë nuk do të kemi parashenja dhe lëvizje të tilla të cilat do të pinë ujë në Kosovë, por jemi treguar shpeshherë posaçërisht besimtarët që janë shumica të besimit mysliman edhe më katolikë se katolikët sa i përket respektimit të bashkësisë ndërkombëtare dhe për këtë mendoj se është fyese. Është mirë që ajo të hiqet nga Raporti. Ju faleminderit shume.

KRYESUESI I SEANCËS NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputet! Deputeti Xhezair Murati e ka fjalën ,le të përgatitet deputetja Qibrije Hoxha e fundit

DEPUTETI XHEZAIR MURATI - G. Predsedavajući uz poštovanje prisustva premiera Qekua, g.ministara koji su danas tu i kolege poslanika. Imam jednu zamerku,da kada analiziramo ovaku ozbiljnu temu u ovakom ozbiljnom političkom trenutku, nije dovoljno prisustvo poslanika u sali da bih političke partije trebale da razmisle o disciplini prisustva poslanika kada se raspravljaju neke teme koje su, kao ova jedna od izuzetno značajnih. Ovaj i ja sam jedan od onih poslanika koji nije planirao da se javi danas za diskusiju, ali upravo ovaj odeljak o kojem je dosta kolega mojih govorilo koji je posvećen navodno Islamskom ekstremizmu. Ja prvo moram da pohvalim izveštaj koji je uradilo Mnistarstvo, sažet je obuhvatan i ja u ime Grupe koju predstavljam zahvaljujem Komisiji za bezbednost koja je dosta ozbiljno radila i pre formiranja našeg Ministarstva, ali kažem spada u one koje ću ovde argumentovani da na Kosovu medju pripadnicima muslimanske vjeroispovesti nema ekstremizma ni u onoj najmanjoj meri koji bi bio uzročnik nekakve destabilizacije ili ovaj lošeg bezbednosnog stanja o čemu su i dosta mojih kolega govorilo. Takodje, pored WEHABBIZAM koji se ovde pominje ima negde nekih članova ovog pokreta ali sigurno mnogo manje nego u drugim zemljama, nego u drugim sredinama i jest on evidentiran, ali sigurno ne spada u onu opasnost kako bih neki želeli. Zašto sam govorio ovo. Naime, ako bi smo mi posvetili veću pažnju analizi islamskog ekstremizma na Kosovu samo bi smo išli na ruku onima koji veoma često ovo toliko uveličavaju da pokušavaju da ubede međunarodnu zajednicu da je islamski fundamentalizam jedna opasnost po sve druge na Kosovu što nije istina što i dosadašnja situacija pokazala što i ovaj, nedavno čak u Savetu Evrope jedan predstavnik u jednoj delegaciji našeg severnog suseda u Savetu Evrope je govorio o islamskom ekstremizmu na Kosovu, a on predstvalja partiju koja je vodila sve ratove na prostorima bivše Jugoslavije. Dalje, predstavnici pravoslavne crkve na Kosovu daju izvore o islamskom ekstremizmu na Kosovu a uopšte ne vodeći računa da su oni uzročnici nekog verskog ekstremizma, dakle ko će o kome a neko o poštenju ako je već kontrola bezbednog stanja na Kosovu, ja ponovo kažem da Kosovska policijska služba prema svim analizama koje imamo, prema anketama gradjana koje su izvršene spada u onu državnu strukturu koja ravradjuju punu pažnju gradjana i ja se pridružujem kolegama koji su danas predložili, mislim da je to kolega Brajshori, da mi dobro razmislimo na koji način da uzvratimo materijalno makar simbolično da nagradimo ovu službu koja postaje sve više profesionalna i koja izuzetno profesionalno obavlja poslove radih kojih je iabrana. Ja bih takodje pomenuo, što se tiče sredine nedavno nakon poseate konsultataivnog saveta naše Skupštine, dakle mesto Rečane kod Prizrena, nakon poseste tog mesta, prije toga od premijera Qeukua, nakon posete od strane nekih ministara naše Vlade, nakon ocena o izuzetnom uspešnom integracijom te sredine iz nekih izvora je kao pandan takvoj uspešnosti došla informacija da je navodno Rečane i nedaleko od njega bošnjačko selo Planjane izvog WEHABIYMA i ne znam kakvog islamskog ekstremizma. Ja ovde izjavljujem, ne znam da li se satelitski prenosi ova sednicas, da nema nikakvih dokaza, niti jednog člana pokreta WEHABIZMA u selu Rečane, ja stojim iza ove izjave i pozivam našu Kosovsku policijsku službu da proverii moje navode i da me uveriu u suprotno. Prema tome, savaki pokušaj unošenja igranja

na ovu kartu, sigurno će biti osudjen na propast. Ovu vjest je objavila čak i televizija Bjelina, zamislite televizija Bjelina da govori o WHABBIZMU u Prizrenskom kraju koji se može uvek proveriti da li postoji ili ne. Hoću time da kažem da mi jesmo ovo evidentirali, ali svakako da je naša diskusija pokazala da mi ne smemo da upozoravamo na nešto što nam nije opasnost, ja podržavam Izveštaj u ime grupe koje predstavljam. Zahvaljujem kolegama koji su o svemu o ovome govorili i zahvaljujem Kosovskoj policijskoj službi još jednom koja je na visini zadatka koju obavlja u ovom periodu političkog i Kosovskog trenutka. Hvala Vam!

KRYESUEISI I SEANCËS NAIM MALOKU- Ju faleminderit! Qibrije Hoxha e ka fjalën

QIBRIJE HOXHA - Ju faleminderit i nderuar kryesues, i nderuar kryeministër, i nderuar ministër, të nderuar kolegë deputetë. Unë e pata vetëm një ndërhyrje të shkurtër dhe më tepër do të merresha me anën teknike të Raportit të prezantuar. Përndryshe ju përgëzoj për raportin i nderuar ministër dhe atë që desha, unë ndoshta do të jetë vetëm një sugjerim nga ana ime. Mendoj se do të ishte më mirë që të sistemohen d.m.th. raporti i të gjitha formave të krimit dhe dukurive negative si po e zëmë të trafikimit të drogës e qenieve njerëzore, që më duket se ishte bërë një lëshim, nuk ishte përmendë. Sa u përket ekstremizmave të ndryshëm, unë po e them se ekstremizmi, në vend që ta përmend vetëm një ekstremizëm, do ta quaja ekstremizëm fetar, kështu që brenda tij do të mund të bëhej një analizë me qenë se ne jemi dëshmitarë që ka ekstremizëm legal në Kosovë, kurse sa i përket kësaj nuk pajtohem me kolegët e mi, të cilët mendojnë se kontingjenti, i cili u zu nga doganierët maqedonas, ishte lëshim i doganierëve tanë ose i Shërbimit Policor të Kosovës. Unë konsideroj se pikërisht Shërbimi Policor i Kosovës dhe doganierët tanë janë ata të cilët e mundësuan zënien e këtij kontingjenti dhe shpjegimi për këtë u dha ato ditë kur edhe ndodhi kjo, si nga ana e doganierëve tanë dhe institucioneve tona, po ashtu edhe nga ana e institucioneve të Maqedonisë. Ju faleminderit.

KRYESUESI I SEANCËS NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Të lajmëruar për fjalë nuk ka më deputetë. Debatin e përcollën 70 deputetë. Për fjalë është paraqitur ministri Fatmir Rexhepi. E keni fjalën.

FATMIR REXHEPI, MINISTËR - Ju faleminderit z. kryesues i seancës. Rasti që u shtrua në dhjetor për të debatuar për çështjet e sigurisë ishte i veçantë, ishte kërkesa që të raportohet në një seancë të veçantë të Parlamentit lidhur me rastin në Shtutiacë, që kishte të bëjë me armë dhe në kuadër të saj ne e ofruam atë pasqyrë që e patëm si argument këtu e bazuar në informacionet zyrtare. Vendi është atje ku ka ndodhur, regjioni është atje ku ka ndodhur, prandaj nuk ka kurrëgjë politike nga ana e ministrit. Në anën tjetër, në këtë Raport që ka të bëjë me gjendjen e përgjithshme të sigurisë në Kosovë dhe tash kur jemi në prag pra të qepjes së pakos për statusin përfundimtar dhe më vonë për implementimin, pra të detyrave që dalin prej institucionet të vendit ishin edhe disa nga faktorët që unë i kam ofruar në këtë material dhe normalisht në kuadër të këtij debati kishte edhe vërejtje shumë me vend, kështu që ato pranohen, por më duhet të

them me sa vijon: u veçuan disa nga kjo pjesë në këtë raport, u përmendën edhe strukturat paralele që ashtu figurojnë në Raport. Unë nuk kam këtu të drejtë të flas si institucion legal e legjitim i zgjedhur edhe sikur ju për historikun e tyre, por ne na takon të nxjerrim qëndrimet tona politike e kur ky Parlament vlerëson se institucionet paralele në Kosovë, pavarësisht a janë shqiptare apo serbe dhe merr ndonjë qëndrim tjetër politik, ne i përgjigjemi asaj me vendimin politik që e nxjerr Parlamenti. Prandaj nuk ka nevojë për krahasime të atilla se as që është qëllimi i ministrit, pra në këtë plan nuk është detyrë imja ajo, por si institucione paralele që ndikojnë në rrjedhat e sigurisë ajo është e qëndrueshme. Jo vetëm në fushën e sigurisë, ne kemi institucione paralele edhe në fushat e tjera. Në qoftë se ne pajtohemi se ato duhet të veprojnë në Kosovë ,atëherë thoni Parlamentit okej, unë bashkë me juve, kështu që këtë prizëm duhet me e pasë vendosjen e institucioneve paralele këtu. Ndoshta është dashur të jetë edhe ndonjë emër që u përmend këtu, por unë ofecialisht i pata këto, në pamundësi të kohës, por herën tjetër do t'i sjell edhe ato që u përmendën se qëndrojnë edhe ato çka thanë disa nga deputetët. Nuk është bërë me ndonjë qëllim nga ana e ministrit.

Sa i përket pjesës tjetër që u ngrit këtu, në fjalimin tim e përmenda ekstremizmin fetar, jo ato çka janë në Raport, sepse e përmenda se do të korrigjoj në kuadër të asaj një vlerësim timin personal si ministër. Ka pasuar apo s' ka pasuar, është e vërtetë që ju e keni ashtu në Raport, por unë thashë ekstremizmi fetar, ndërsa liria fetare, vlerat e saj, ato janë të pranishme në Kosovë, ato janë të lejume, ne i respektojmë dhe vetë i përkasim edhe asaj feje, në këtë rast edhe unë i përkas fesë islame, prandaj në këtë plan nuk kemi nevojë të bëhemi më shumë patriotë në disa plane të tjera, njëri tjetrin ta hedhim atje ku nuk e ka vendin. Përndryshe, unë njësoj si ju edhe babagyshin e kam haxhi, kështu që nuk ka nevojë na me i fshehur disa gjëra që shëtitin nëpër Kosovë, janë të dëmshme edhe tash të qesim plane të tjera, të mbrojmë diçka çka nuk duhet me u mbrojtë, Duhet ta kemi guximin edhe intelektual edhe parlamentar edhe qeveritar ta themi të vërtetën. Ekstremizmi fetar pra, edhe ajo pjesë që e thatë për pjesën e ekstremizmit ortodoks dhe të tjera, por në këtë rast informatat zyrtare që unë kam poseduar, që ku i kam, e nuk qëndrojnë ato që thoni ju. Këto diku rreth dhjetë faqe që unë shumë pak kam nxjerrë në këtë material . Nëse është në interes të Komisionit Parlamentar unë ia ofroj Raportin e iinteligjencës kriminale që kanë të bëjë me ekstremizmin fetar në Kosovë. Në këtë rast, është veçuar do të thotë një grup me ideologji ekstremizmi të cilin e keni parë, prandaj duhet të jemi korrekt në këtë Raport. Po ashtu vlerësimi lidhur me protestat që po japim ngjyra, kurrkush në Kosovë aq më parë unë si ministër, në asnjë kohë , as sot as nesër, nuk do të ndodhë që protestave demokratike t'u jap ndonjë ngjyrim tjetër, por duhet veçuar diçka. Edhe në kuadër të protestave që kanë ndodhur në Kosovë nga ana e shqiptarëve, në këtë rast të” Vetëvendosjes” kemi pasur protesta me karakter të dhunës dhe në qoftë se na pajtohemi me to, urdhëroni tregoni. Prandaj, nuk kemi nevojë, ne e ndajmë vijën e kuqe në mes asaj çka është protestë e dhunshme dhe asaj çka është protestë demokratike me kërkesa çfarë i kemi dëgjuar, kështu që edhe kjo sqarohet mirë në Raport. Unë jam për atë që do të thotë liri ,por nuk jam patjetër për lirinë e protestave. Liria e demonstratave është, por kur merr karakterin e dhunës ne të gjithë duhet ta gjykojmë edhe normalisht aktorët e tyre të dalin para drejtësisë, pavarësisht kush është. Nuk qëndron konstatimi se Shërbimi Policor i Kosovës i kontrollon strukturat paralele në kuptimin e funksionimit të tyre, por edhe në Raport është edhe gjithkund tjetër ajo e

monitoron veprimtarinë e tyre dhe do të punojnë, do me thënë do të veprojnë në pajtim me rrethanat e me ligjin që ajo veprimtari të mos marrë dimensione të tjera dhe me pasoja për siguri. Për fund unë, me qenë se do të presim zhvillime politike në Kosovë, siç e dini, prandaj edhe statusi i ardhshëm edhe implementimi i tij për institucionet tona vendore edhe për neve pra ka të bëjë se si të qeverisim me pavarësinë e vendit, çfarë sigurie duhet të ofrojmë. Edhe në këtë plan unë kërkoj nga Parlamenti që edhe për Shërbimin Policor të Kosovës edhe për Ministrinë e Punëve të Brendshme, të kemi përkrahjen politike, në mënyrë që të punojmë sa më shumë në planin e sigurisë për të gjithë qytetarët edhe për pakicat edhe për të gjitha pjesët tona të vendit, sepse nuk ishte qëllim Raporti ta ndaj. Unë i veçova disa regjione me karakteristike, masat, mobilizimin, mundësitë, mekanizmat e sigurisë, prandaj kërkoj edhe përkrahjen tuaj politike. Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS NAIM MALOKU - Ju faleminderit! Kryeministri Agim Çeku e ka fjalën.

AGIM ÇEKU KRYEMINISTËR – I nderuar kryesues, të nderuar deputetë edhe unë desha t’ju falënderoj për këtë debat të cilin e vlerësoj shumë konstruktiv dhe të dobishëm. Ne i dëgjuam me vëmendje vërejtjet dhe sugjerimet tuaja dhe të gjitha do t’i marrim parasysh. Patët shumë vërejtje, por besoj që të gjithë u pajtuat se Raporti, ky i dyti, ishte shumë më i mirë se i pari. Ne në vazhdimësi jemi duke i ngritur kapacitetet tona, në vazhdimësi jemi duke marrë shumë më shumë përgjegjësi dhe jam i bindur se edhe situata në të ardhmen do të jetë shumë më e mirë edhe Raporti i ardhshëm do të jetë shumë më i mirë, shumë më gjithëpërfshirës dhe do të jetë shumë më pozitiv.

Edhe pse disa herë mu përmend emri këtu, unë nuk u provokova nga ky fakt dhe nuk dua t’i komentoj ishin do më thënë, cekja e emrit tim ishte tendencioze, nuk dua ta komentoj, dua ta përmirësoj z. Dedaj se nuk kam thënë që në Kosovë nuk do të ketë protesta. Protesta është e drejtë legjitime, është e drejtë demokratike. Jemi vend demokratik dhe protesta do të ketë tërë kohën dhe askush nuk mund t’i kundërshtojë as t’i ndalojë etj. Unë kam thënë që në Kosovë nuk do të ketë dhunë dhe nuk pres dhunë. Ka përpjekje të tilla që shumë kundërshtarë të pavarësisë së Kosovës apo kundërshtarë të Kosovës tentojnë ta portretojnë Kosovën si vend i dhunës, tentojnë ta **portretojnë** popullin tonë si popull i dhunshëm. Unë e kam thënë që nuk jemi popull i dhunshëm, nuk jemi vendi i dhunës, nuk ka arsye për dhunë, nuk ka cak për dhunë. Kundër kujt dhuna? Janë mjete demokratike, është Parlamenti se kur e humb besimin Qeveria apo Grupi i Unitetit apo kushdo ka mënyra të tjera me të cilat mund të shprehet pakënaqësia e qytetarëve, por unë u provokova nga dy gjërat të tjera. U provokova nga kërkesa juaj e vazhdueshme që ne duhet t’i ndërtojmë institucionet tona të mirëfillta të sigurisë dhe u provokova nga shtypi i sotëm kur lexova se akuzohet Qeveria se nuk ka projekte për ndërtimin e këtyre strukturave, nuk ka projekt për të ardhmen e TMK-së etj., çka nuk qëndron fare. Qeveria ka projekte. Ne do t’i kemi sistemin e Sektorit të sigurisë të ndërtuar me të gjitha institucionet si çdo shtet tjetër normal. Do ta kemi forcën ushtarake tonën, do ta kemi shërbimin inteligjentë të mirëfilltë profesional jopolitik të mbikëqyrur normalisht, të gjitha këto institucione nga Parlamenti Kosovës.

Kështu që, kemi projekte TMK-ja sa i përket forcës ushtarake të TMK-së, TMK-ja gjithmonë ka pasur vizion dhe ka projekte për ndërtimin, ngritjen dhe zhvillimin e kësaj force. Tani ka pasur projekt, ka pasur vizion. Tani janë duke u ndërmarrë hapa konkret qysh me kohë në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar, zyrën e koordinatorit, me KFOR-in është ngritur grupi i cili quhet grupi për zhvillimin e forcës dhe ky grup është në detaje duke e planifikuar që nga struktura detyrat, misionin deri te dukja e një ushtari, deri te kostoja e një ushtari, d.m.th kështu që është në shumë detale ekziston. Ky projekt i TMK-së është projekt i të gjithë neve i Qeverisë dhe është i harmonizuar me KFOR-in me NATO-n, me Zyrën e koordinatorit dhe është duke u realizuar. Gjithashtu, ne e kemi marrë një projekt në vitin e kaluar i cili quhej: Rishikimi i Sektorit të Sigurisë, i sponsoruar nga faktori ndërkombëtar por sekretariati i këtij projekti ka qenë në Zyrën për siguri publike të kryeministrit, do me thënë në zyrën e kryeministrit kanë qenë të përfshirë gjithë spektri politik dhe si komitet drejtues i këtij projekti, dhe në nëntor është prezantuar ky raport. Këto ditë do të bëhet publik dhe ky raport rekomandon, ka qenë inkluziv do me thënë gjithëpërfshirës, rekomandon që Kosova ta ketë forcën e vet ushtarake, ta ketë Ministrinë e Mbrojtjes, ta ketë Shërbimin inteligjentë e të tjerë. Të gjitha këto rekomandime i ka marrë parasysh edhe z. Ahtisari dhe nuk kam asnjë arsye të dyshoj apo besoj fuqishëm që ai në pakon me dy (2) kur vjen në Kosovë do ta shohim se do të rekomandoj që Kosova t'i ketë këto kapacitete. Gjithashtu, ne i kemi ngritur grupet për transicion. Në mesin e të gjitha grupeve është Grupi për qeverisje dhe është grupi tjetër për siguri. Grupi për qeverisje është duke hartuar skemat organizative, projektet për ministri, institucionet e reja që do t'i kemi. Ka përfunduar dhe është në debat projekti për Ministrinë e Jashtme, fillon puna në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit të TMK-së për hartimin e projektin e Ministrisë së Mbrojtjes. Grupi për siguri gjithashtu është duke bartur kompetencat në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe pritet menjëherë në këtë fazë të transicionit që komisionar i policisë të jetë vendorë dhe të jetë plotësisht nën kompetencat e ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes. Puna është duke ecur në këtë drejtim. Sa i përket Shërbimit inteligjent, ju e dini edhe më parë kemi thënë në këtë Parlament se është angazhuar një këshilltar ndërkombëtar i paguar nga Komisioni Evropian dhe cili në bashkëpunim me Zyrën ligjore, strukturat e tjera, Zyrën për siguri publike ka hartuar ligjin për këtë shërbim – Agjenci të sigurisë dhe të gjitha aktet nënligjore, duke filluar nga kriteret profesionale që duhet t'i plotësojë çdo kandidat i mundshëm, pjesëtar i mundshëm i këtij shërbimi deri te rregulloret e punës të brendshme të inspektimit e tjerë e tjerë, kështu që e gjithë kjo punë është bërë, është e kryer, projekti është gati dhe kemi premtime apo zotime, nuk pres befasi në këtë aspekt që do ta propozoj do ta rekomandoj edhe Ahtisari dhe menjëherë në status do të fillojë jetësimi i këtyre projekteve. Projektet i kemi dhe jemi duke punuar në këtë drejtim, kështu që nuk qëndron fakti apo që Qeveria nuk është kurrkund apo në fund të pusit me këto projekte. Jemi në ngjarje, kemi projekte dhe pritet realizimi i tyre i shpejtë. Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. kryeministër dhe në fund fjalën e ka propozuesi i mocionit të debatit. z. Jakup Krasiqi, e keni fjalën

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI - Z. kryesues, i nderuari kryeministër, në rend të parë duhet ta falënderoj Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike që e ka kërkuar që të debatohet për sigurinë në Kosovë. Po e falënderoj edhe Kuvendin që e ka miratuar, i falënderoj edhe deputetët që kanë marrë pjesë në debat, e falënderoj dhe ministrin që e ka bërë këtë raport.

Ajo çka duhet të them në këtë rast dhe që e tregoj në një formë debati vërtet kërkesa e Grupit parlamentar nuk ka qenë kërkesë politike, ka qenë një kërkesë që ky Parlament të merret seriozisht me siguri dhe me çështjen e sigurisë, edhe sa u përket çështjeve të brendshme të Kosovës, edhe sa i përket sigurisë në raport me pasigurinë që vjen nga jashtë Kosovës.

E di që nuk është, gjatë këtyre viteve nuk ka qenë ndonjë interes i madh për t'i mbrojtur interesat e kombit dhe të Kosovës, se njerëzit që i kanë mbrojtur interesat e kombit dhe të Kosovës jo pak herë gjatë këtyre viteve janë gjetur para gjyqeve të ndryshme politike të organizuara në Kosovë dhe jashtë Kosovës. Mendoj që këtë e dini, bile gjatë këtyre shtatë viteve nuk ka qenë ndonjë privilegj për t'u punësuar as në administratën e shtetit në Kosovë, bile as në Ministrinë e Punëve të Brendshme tani që është në themelim, përkundrazi njerëzit që kanë kontribuar janë ndjekur. Unë do t'i marrë disa segmente: u fol për sekten Vahabi, mendoj që edhe për këtë edhe aty ku përmendet SHIK-u si segment paralel janë marrë nga interneti, ndoshta ministri nuk ka faj, por hartuesit që e kanë sjellë informacionin, informatat i kanë marr nga interneti, nga faqja e internetit: **"Albanian terorizëm"** – kuptohet janë faqe serbe të internetit dhe natyrisht këto akuza kanë ardhur nga shërbimet serbe dhe dikush nga Ministria e Punëve të Brendshme i ka marrë këto informacione dhe ia ka servuar ministrit. Sa i përket sektit Vehabi unë mund të them që absolutisht Ministria nuk duhet të merret me të. Kjo është çështje e edukimit dhe e arsimit. Ne duhet t'i përforcojmë edukimin dhe arsimin në Kosovë për t'i ikur fundamentalizmave arab, përndryshe ne jemi shqiptarë, jemi në Evropë dhe jemi të besimit islam, por të islamizmit evropian jo të islamizmit arab.

Një çështje tjetër që nuk është thënë në Raport e që lidhet shumë me pasigurinë është keqqeverisja, shkelja e ligjeve nga qeveritarët, keqpërdorimi i financave publike, ngecja në zhvillimin ekonomik, papunësia. Të gjitha këto kanë bërë që Lordi Xhonsion në Këshillin e Evropës të bëjë kërkesë për një Rezolutë dhe ju e dini se me atë rezolutë nuk përmendet fjala pavarësi edhe pse ka qenë, por nuk e kam fjalën për rezolutën e kam për një fakt se edhe Lordi Xhonsion edhe pse do ta mbrojë interesin e Kosovës dhe të qytetarëve të saj ai nuk ka pasur argumente. Prej të gjitha argumenteve për pavarësinë e Kosovës ka mbetur vetëm njëri ai se nëse shqiptarët nuk e marrin pavarësinë mund të ngriten në kryengritje dhe të bëjnë tollovi. Të gjitha argumentet e tjera që janë t'i ndërtojnë institucionet e Kosovës gjatë këtyre gjashtë viteve janë harxhuar edhe këto argumente nuk na i kanë harxhuar të tjerët, i kemi harxhuar ne me keqqeverisjen, me paligjësitë dhe me keqpërdorimin e mjeteve financiare të qytetarëve të Kosovës

KRYESUESI I SEANCËS NAIM MALOKU – Ndërhyn: Kthehu në temë ju lutem.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI - Mendoj se kjo është një obligim i Qeverisë. Sa i përket armëve, ne vërtet si shkas është marrë Shtutica, por ne nuk konsiderojmë se armët në vetvete janë të sigurta a të pasigurta se njeriu mund të flenë nën armë dhe mos

me e shkaktua atë pasiguri, politika është ajo që i bën armët të jenë të pasigurta ose nganjëherë edhe armët prodhojnë siguri. Ne kemi qenë kundër politikës që bënë që arma të shkaktojë pasigurinë për qytetarët e Kosovës dhe për të ardhmen e qytetarëve të Kosovës.

Në çështjet që i përmenda mendoj që Raporti nuk ka dhënë përgjigje. Sa i përket asaj që dikush nga deputetët vlerëson, e vlerëson punën e ministrit edhe unë vërtet kisha dëshiruar ta vlerësoja, por nuk di sa varet nga vlerësimi që e bëjmë ne. Mendoj që çështja duhet të shtrohet sa të tjerët e vlerësojnë punën e Qeverisë dhe punën e Ministrisë dhe mbi bazën e atyre vlerësimeve përcaktohet në një formë edhe e ardhmja jonë. Dhe krejt në fund, edhe një herë unë dua t'i falënderoj të gjithë deputetët që morën pjesë në debat dhe dhanë kontribut për të plotësuar Raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Të nderuar deputetë me këtë përfundon debati dhe pika e tetë e rendit të ditës. Ne për të vazhduar seancën i kemi edhe tri pika të rendit të ditës. Unë kam propozim nga kryetari i Kuvendit që këto tri pika të rendit të ditës t'i bashkëngjiten seancës së ardhshme. Ky është propozim pra i kryetarit të Kuvendit pasi që pika e dhjetë do të marrë shumë debat, është kërkesa e Grupit të deputetëve për të shqyrtuar çështjen e qytetarëve tanë para Tribunalit të Hagës. Për këtë propozim ju lus që të deklarohemi a po e vazhdojmë seancën, por duhet një pauzë ju lus, se që katër orë jemi ulur këtu, apo do t'ju lus në emër të grupeve parlamentare. Deputeti Alush Gashi e ka fjalën

DEPUTETI ALUSH GASHI - Ne e mbështesim propozimin e kryetarit të Kuvendit.

KRYESUESI I SEANCËS NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Gjylnaze Sylja

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Z. kryesues i kam dy çështje: qëndrimin e Grupit Parlamentar që ne gjithashtu e mbështesim, por paraprakisht dëshiroj t'ia kujtoj z. Jakupi se çka ka thënë më 21 dhjetor dhe këtu e mbaj transkriptin dhe dëshiroj t'ia citoj fjalët.

KRYESUESI I SEANCËS NAIM MALOKU – Unë jam i detyruar t'jua ndërpres fjalën. Ka përfunduar debati për pikën e tetë të rendit të ditës. Ju lutem.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Kërkova fjalën. Ju faleminderit! Thotë askush më nuk mund të thotë se Qeveria dhe ministrinë janë pak të papërgjegjshme dhe nuk mbajnë përgjegjësi për maskat. Z. Krasniqi besoj se e keni lexuar Raportin, aty nuk janë maskat të cilat ju u referoheni, por janë maskat kundër helmimit. Ne thotë kemi qenë të bindur...

KRYESUESI I SEANCËS NAIM MALOKU – Ju lutem propozimi i kryetarit për bartjen e tri pikave të rendit të ditës për seancën e ardhshme. Ju lus, e dëgjuam propozimin në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka Teuta, emri i saj është këtu. Urdhëroni!

TEUTA SAHATQIJA – Z. kryesues Grupi ynë parlamentar pajtohet që dy pikat të shtyhen dhe të jenë pjesë e seancës së ardhshme, por ju kisha lutur që për pikën e fundit, pika 11, e cila nuk merr kohë të informohet Kuvendi për propozimin e Grupit tonë parlamentar për ndërrimin e anëtarëve të Komisionit. Nuk kërkon ndonjë kohë të gjatë. Mendojmë që mund ta kalojmë tash për disa minuta.

KRYESUESI I SEANCËS NAIM MALOKU – Mirë atëherë pika e 11-të e rendit të ditës për t'u plotësuar komisionet parlamentare, e ka fjalën ,do të thotë kërkohet një votë formale për ndërrimin e anëtarëve të Komisionit, të nga Grupi Parlamentar ORA për të njëjtit. Deputeti Gen Gorani për Shërbime Publike në vend të deputetit Ylber Hysa dhe deputeti Ylber Hysa në vend të Gencë Goranit. Votim formal ju lutem, po miratohet me shumicë votash. Dy pikat e rendit të ditës i bashkëngjiten seancës së ardhshme të Kuvendit.

Ju faleminderit për vëmendje!

Seanca përfundoi punën në orën 17,20